



- Vlerësimi i multikulturalizmit në nivel lokal në Republikën e Maqedonisë



A project implemented by the Association for Democratic Initiatives and its partners

Vlerësimi i multikulturalizmit në nivel lokal  
në Republikën e Maqedonisë

---

**Autorë:**

Development Solushns

Risto Karajkov

Marija Dimitrovska

***me:***

Florina Emini

Enis Baftijari

Elena Deskovska

Marija Sançevska

**Dizajn dhe Shtyp:**

Kontura DOO

**Tirazhi:**

900 Kopje

**Përkthim:**

Eko Trejd DOOEL

Ky publikim është përgaditur me ndihmën financiare e Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Asociacionit për Inicijativa Demokratike dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Unionit Evropian.

# Vlerësimi i multikulturalizmit në nivel lokal në Republikën e Maqedonisë

Gostivar  
2016

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

323.1:352(497.7)

ПРОЦЕНКА на мултикултурализмот на локално ниво во Република  
Македонија / [Ристо Карајков ... и др.]. - Гостивар : Асоцијација за  
Демократски Иницијативи, 2017. - 156 стр. ; 24 см

Текст на мак. и алб. јазик. - Содржи и: Vlerësimi i  
multikulturalizmit në nivel lokal në Republikën e Maqedonisë

ISBN 978-9989-133-23-7

1. Карајков, Ристо [автор]

а) Локална самоуправа - Меѓуетнички односи - Унапредување -  
Македонија б) Мултикултурализам - Македонија

COBISS.MK-ID 102806282

## *Përmbajtja*



|                                                       |        |
|-------------------------------------------------------|--------|
| Lista e shkurtesave                                   | { 6 }  |
| Rezyme ekzekutive                                     | { 7 }  |
| 1. Hyrje                                              | { 9 }  |
| 2. Analiza e praktikave dhe politikave multikulturore | { 11 } |
| 2.1 Metodologjia                                      | { 11 } |
| 2.2 Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive    | { 12 } |
| 2.2.1 Korniza ligjore                                 | { 12 } |
| 2.2.2 Funksionimi                                     | { 13 } |
| 2.3 Arsimi i integruar                                | { 15 } |
| 2.4 Sektori i shoqërisë civile                        | { 17 } |
| 3. Kushtet aktuale në komunat e synuara               | { 19 } |
| 3.1 Komuna e Bërvenicës                               | { 19 } |
| Strategjia                                            | { 20 } |
| Konstatimet e aktorëve relevantë                      | { 23 } |
| 3.2 Komuna e Vrapcishtit                              | { 27 } |
| Strategjia                                            | { 28 } |
| Këqyrja nga aktorët relevantë                         | { 30 } |
| 3.3 Komuna e Gostivarit                               | { 31 } |
| Strategjia                                            | { 32 } |
| Konstatimet e aktorëve relevantë                      | { 34 } |
| 3.4 Komuna e Jegunovcës                               | { 37 } |
| Strategjia                                            | { 38 } |
| Këqyrja nga aktorët relevantë                         | { 40 } |
| 3.5 Komuna e Kërçovës                                 | { 43 } |
| Strategjia                                            | { 45 } |
| Konstatimet e aktorëve relevantë                      | { 46 } |
| 3.6 Komuna e Tetovës                                  | { 49 } |
| Strategjia                                            | { 51 } |
| Konstatimet e aktorëve relevantë                      | { 53 } |
| 3.7 Komuna e Kumanovës                                | { 57 } |
| Konstatimet e aktorëve relevantë                      | { 58 } |
| 3.8 Komuna e Mavrovë-Rostushës                        | { 61 } |
| Konstatimet e aktorëve relevantë                      | { 61 } |
| 3.9 Komuna e Strugës                                  | { 63 } |
| 4. Konkluzione dhe rekomandime                        | { 65 } |
| Bibliografia                                          | { 69 } |
| Shtojca 1. Lista e të anketuarve të intervistuar      | { 71 } |
| Aneksi 2. Debatet e organizuara                       | { 75 } |

### *Lista e Shkurtesave*



|              |                                                              |
|--------------|--------------------------------------------------------------|
| <b>MKO</b>   | Marrëveshja Kornizë e Ohrit                                  |
| <b>KMNB</b>  | Komisioni për Marëdhëniet Ndërmjet Bashkësive                |
| <b>IZhK</b>  | Instituti për Zhvillim të Komunitetit                        |
| <b>SIOFA</b> | Sekretariat për Implementim të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit |
| <b>OSCE</b>  | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian               |
| <b>IEP</b>   | Instituti Evropian për Paqe                                  |
| <b>ARDK</b>  | Agjencia për Realizimin e të Drejtave të Komuniteteve        |
| <b>MASH</b>  | Ministria e Arsimit dhe Shkencës                             |
| <b>OQ</b>    | Organizata Qytetare                                          |
| <b>ADI</b>   | Asociacioni për Inicijativa Demokratike                      |
| <b>FN</b>    | Shoqata multietnike Florence Nightingale                     |

## *Rezyme ekzekutive*



Republika e Maqedonisë në vitet e fundit kaloi nëpër ndryshime të thella politike, sociale, kulturore dhe institucionale. Marrëveshjen Kornizë të Ohrit (MKO) e vitit 2001 dhe ndryshimet ligjore që dolën nga implementimi i saj i institucionalizoi themelet e stabilitetit ndëretnik dhe progresin në zbatimin e të drejtave të komuniteteve etnike, duke imponuar vlera të reja multikulturore në shoqëri.

Është posaçërisht e rëndësishme në përputhje me standardet ndërkombëtare, qeveritë vendore të marrin përgjegjësinë për zbatimin e politikave publike lokale, gjegjësisht të angazhohen për promovimin e kulturës demokratike të bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut dhe pakicave dhe sundimin e së drejtës, me ç'rast veçanërisht të marrin një qëndrim proaktiv për nxitjen e dialogut dhe bashkëpunimit ndëretnik.

Dokumentet strategjike lokale për avancimin e mirëkuptimit ndërkulturor (të miratuara në 6 komuna - Bërvenicë, Vrapçisht, Gostivar, Jegunovcë, Kërçovë dhe Tetovë) gjatë vitit 2014, paraqesin llojin e parë të këtillë në vendin tonë dhe janë një shembull dhe model pozitiv për përcaktimin e kuadrit strategjik dhe angazhimin e komunave për të mbështetur bashkëjetesën dhe tolerancën. Së këndejmi, qëllimi i këtij raporti është të prezantohet progresi në zbatimin e strategjive lokale në të gjitha gjashtë komunat dhe njëkohësisht të përfshihen tre komuna "të reja" - Kumanova, Mavrovë-Rostusha dhe Struga në analizën e kapaciteteve, politikave dhe praktikave lokale në lidhje me promovimin dhe integrimin e konceptit të multikulturalizmit.

Raporti vë në dukje se marrëdhëniet ndëretnike në komunat e synuara, në përgjithësi konsiderohen si të qëndrueshme. Një nga problemet kyçe në aspektin e marrëdhënieve ndëretnike është distanca sociale dhe segregacioni në mesin e të moshuarve dhe të rinjve. Edhe krahas pretendimeve për bashkëpunim dhe komunikim, komunikimi ekzistues bazohet në pragmatizëm, ndërsa kontaktet në sferën private anashkalohen.

Zbatimi i objektivave strategjike të strategjive të miratuara për përmirësimin e mirëkuptimit ndërkulturor/dialogun në komunat Bërvenicë, Vrapçisht, Gostivar, Jegunovcë, Kërçovë dhe Tetovë është në rrjedh, me dinamikë dhe efikasitet të ndryshëm. Pengesat kryesore për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara janë të lidhura me mungesën e fondeve qeverive komunale. Kjo sidomos ka të bëjë me organizimin e aktiviteteve, isç janë manifestimet e përbashkëta kulturore, festivalet, si dhe siguri i përkrahjes së organizatave locale të shoqërisë civile për zbatimin e iniciativave për promovimin e multikulturalizmit në komunat.

Komisionet për marrëdhëniet ndërmjet bashkësive, përgjithësisht veprojnë në kuadër të mandatit të parashikuar me kornizën ligjore. Megjithatë, analiza e aktiviteteve të tyre, tregon se këto organizma nuk i shfrytëzojnë plotësisht kapacitetet e tyre për ndërhyrje në sferën e marrëdhënieve ndëretnike, si dhe përfshirjen në iniciimin dhe zbatimin e aktiviteteve për zhvillim të multikulturalizmit.



Një aspekt sidomos është i mbushur me pengesa në procesin e implementimit - tejkalimi i barrierave gjuhësore ndërmjet qytetarëve me origjinë të ndryshme etnike. Edhe pse dokumentet strategjike parashikojnë aprovimin e kurseve të gjuhës dhe lëndëve zgjedhore mësimore për mësim të gjuhëve të grupeve të tjera etnike, këto aktivitete realizohen vetëm në një pjesë të vogël të komunave. Kjo çështje është me interes të veçantë, duke pasur parasysh se barrierat gjuhësore janë një nga faktorët më të rëndësishëm për mbajtjen e distancës sociale mes grupeve të ndryshme etnike. Komunikimi dhe bashkëpunimi në vendin e punës konsiderohet si shumë i kënaqshëm nga ana e sektorit të biznesit në të gjitha komunat e synuara. Vendi i punës dëshmohej si një themel i fortë për ndërtimin e marrëdhënieve pozitive midis pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike. Andaj, papunësia është faktor pengues për zhvillimin e mirëkuptimit kulturor te qytetarët.

Në shumë raste zhvillimi i multikulturalizmit konsiderohet si një çështje që i prek marrëdhëniet mes pjesëtarëve të komuniteteve më të mëdha etnike - shqiptarët dhe maqedonasit. Analiza tregon se pjesëtarët e bashkësive më të vogla etnike, shpesh lihen mbrapa proceseve të vendimmarrjes dhe se ato shpesh u nënshtrohen praktikave diskriminuese.

Raporti i vlerësimit është përgatitur në kuadër të projektit “Dallimet janë në modë – promovimi i multikulturalizmit në nivel lokal”, që e zbaton Asociacioni për Iniciativa Demokratike (ADI) Gostivar, në partneritet me Asociacionin Multietnik Florence Nightingale dhe me “Odën Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore”. Projekti mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian, i përfaqësuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shkup.

**Lulzim Haziri,**  
Drejtor ekzekutiv

**Linda Bexheti**  
Menaxhere e projektit

Asociacioni për Iniciativa Demokratike (ADI)

Gostivar

## 1. Hyrje



Ky raport i vlerësimit është përgatitur për nevojat e projektit “Dallimet janë në modë – Promovimi i multikulturalizmit në nivel lokal” , i implementuar në kuadër të Programit IPA për mbështetje të Shoqërisë Civile dhe Mediave për vitin 2014 . Projekti realizohet nga Asociacioni për Iniciativë Demokratike (ADI) nga Gostivari në bashkëpunim me “Odën Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore” dhe Shoqatën multietnike Florence Nightingale (FN). Qëllimi kryesor i këtij aksioni është “përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike dhe rritja e demokracisë multikulturore lokale”. Qëllimet specifike të projektit janë:

- Të bëhet vlerësimi i progresit në implementimin e strategjive dhe politikave specifike që lidhen me integrimin e bashkësive etnike dhe marrëdhënieve ndërmjet bashkësive.
- Të zhvillohen dhe miratohen strategjitë lokale për dialog multikulturore;
- Të përkrahet implementimi i aksioneve lokale me qëllim të përmirësimit të marrëdhënieve ndërmjet bashkësive nga ana e organizatave lokale civile.

Nëntë komuna multietnike në vend janë objektivi i aktiviteteve të projektit – komunat Bërvenicë, Vrapçisht, Gostivar, Jegunovcë, Kërçovës, Tetovë, Kumanovë, Mavrovë-Rostushë dhe Strugë.

Si rrjedhojë e objektivave të përgjithshme dhe të posaçme të veprimit të projektit, vlerësimi ka për qëllim të konstatojë gjendjen aktuale të marrëdhënieve ndëretnike në komunat e synuara dhe të sigurohen kahe për veprime të mëtutjeshëm në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike. Krahas hulumtimit të kushteve aktuale në raport me zhvillimin e multikulturalizmit, vlerësimi është bazuar mbi raportet e mëhershme “Bashkëjetesa në distancë”, një studim kërkimor i zbatuar nga FN në vitin 2014, dhe “Analizat e politikave dhe praktikave inter-kulturore në gjashtë (6) komunat multietnike në Maqedoni” përgatitura nga ADI në vitin 2013. Krahas kësaj, vlerësimi i merr parasysh rezultatet e projektit të implementuar nga ADI, me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Shkup, i fokusuar në hartimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike lokale për zhvillimin e dialogut multikulturore në gjashtë komunat e rajonit verilindor: Bërvenicë, Vrapçisht, Gostivar, Jegunovcë, Kërçovë, dhe Tetovë. Krahas vazhdimit të punës së këtyre komunave, projekti “Dallimi është në modë – promovimi i multikulturalizmit në nivel lokal” i zgjeron përpjekjet që lidhen me promovimin e konceptit të multikulturalizmit në tre komunat shtesë : Kumanovë , Mavrovë-Rostushë dhe Strugë.



Procesi i hulumtimit përbëhet nga hulumtimi i më shumë çështjeve të zhvillimit të multikulturalizmit në nivel lokal - implementimi i iniciativave dhe volumi i bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara relevante lokale (organizatat shoqërisë civile, organet e vetëqeverisjes lokale, institucionet arsimore, sektori i biznesit, sferat mediatike etj.), duke siguruar bazë për strukturimin e aktiviteteve të projektit në përputhje me kushtet dhe nevojat specifike lokale. Gjetjet nga raporti preliminar më pas u prezantuan dhe u diskutuan në debatet publike të organizuara në secilën nga komunat e synuara. Raporti final i vlerësimit, i plotësuar me rekomandime dhe konkluzione të aktorëve të interesuar relevant që morën pjesë në këto debate, ka për qëllim të sigurojë një pasqyrë bazike të situatës në komunat e synuara, si dhe të sigurojë rekomandime për veprim në të ardhmen.

## 2. *Analizimi i politikave dhe praktikave multikulturore*



### 2.1 Metodologjia

Procesi i hulumtimit përfshin disa aspekte nga zhvillimi i multikulturalizmit në nivel lokal - iniciativat e implementuara dhe shtrirjen e bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara relevante lokale (organizatat e shoqërisë civile, organet e vetëqeverisjes lokale, institucionet arsimore, sektorin afarist lokal, sferën mediatike etj.), duke siguruar bazën për strukturimin e aktiviteteve të projektit në përputhshmëri me kushtet dhe nevojat specifike lokale. Gjetjet nga vlerësimi preliminar më pas janë prezantuar dhe diskutuar në debatet publike të organizuara në secilën nga komunat e caktuara. Raporti final i vlerësimit, i plotësuar me rekomandime dhe konkluzionet të aktorëve të interesuar relevantë që morën pjesë në debatet, ka për qëllim të sigurojë pasqyrë themelore të situatës në komunat e synuara, dhe të propozojë rekomandime për aktivitetet e ardhshme.

Duke pasur parasysh temën e studimit dhe objektivat e saj, procesi i hulumtimit ishte i bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit relevant, analizave paraprake, të dhënave ekzistuese kualitative dhe kuantitative, intervista gjysëm të strukturuar me punonjësit në organizatat apo institucionet lokale me qëllim që të hulumtohen marrëdhëniet, rolet dhe funksionet e tyre, rrjedhja e informacioneve dhe alokimi i përgjegjësiave relevante për temën e hulumtimit. Desk-hulumtimi përbëhet nga shqyrtimi i politikave lokale, planeve aksionale dhe strategjive, dokumenteve për implementim të iniciativave dhe vlerësimi i kapaciteteve lokale për intervenim dhe promovim të demokracisë multikulturore dhe integritetit ndëretnik.

Krahas analizimit të kornizës legislative për promovimin e multikulturalizmit dhe bashkëjetesës ndëretnike, është rishikuar dokumentacioni i lidhur me procesin e implementimit të planeve aksionale lokale për dialog/mirëkuptim multikulturore. Analiza merr parasysh ekzistimin e dokumentacioneve tjera strategjike për iniciativat e implementuara që lidhen me promovimin e multikulturalizmit në nivel lokal. Pasi që kapacitetet për aksion të KMNB-ve lokale varen shumë nga statusi i tyre në kuadër të vetëqeverisjes lokale, analiza e merr parasysh kornizën ligjore dhe institucionale për punën e organeve. Po ashtu, bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile paraqet një pikëpamje të rëndësishme në promovimin e bashkëjetesës ndëretnike dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes në nivelin lokal. Si rezultat i kësaj, analiza bazohet në prova për bashkëpunim ndërmjet organeve të vetëqeverisjes lokale dhe organizatave qytetare lokale. Procesi i implementimit të konceptit mbi arsimin e integruar është vërejtur në sistemin shkollor; vlerësimi, gjithashtu, i merr parasysh të gjitha dokumentet tjera, dokumentet për politikën dhe analizat që kanë të bëjnë me kushtet që mbizotërojnë në sferën e marrëdhënieve ndëretnike në komunat e synuara.



Këqyrjet e kryera nga desk-hulumtimi janë plotësuar me intervista të aktorëve relevantë në komunat e synuara. Intervistat (4-6 për çdo komunë) u realizuan me përfaqësues të organeve të vetëqeverisjes lokale (nga 2-3 për çdo komunë) anëtarët e sektorit të biznesit dhe atij arsimor (nga 1-2 në çdo komunë) dhe me aktivistë për të drejtat e njeriut dhe anëtarë të organizatave qytetare që janë aktive në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut dhe promovimit të multikulturalizmit. Intervista ka për qëllim të sigurojnë kuptim të thellë të roleve, aktiviteteve dhe përfshirjen e palëve të tanguara në lehtësimin apo përmbajtjen e mundshme në zhvillimin e dialogut ndërkulturor dhe bashkëjetesën ndërmjet të bashkësive të ndryshme etnike. Këto gjetje i plotësuan informacionet e marra nga desk-hulumtimi.

Analiza e implementimit të planeve të miratuara aksionale lokale në komunat Tetovë, Gostivar, Jegunovcë, Bervenice , Vrapçishtit dhe Kërçovë ka për qëllim të gjejë praktika të mira dhe/ose probleme specifike në afrimin reciprok ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike dhe përmirësim të pjesëmarrjes së tyre të përbashkët në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. Po ashtu, vlerësimi ka për qëllim ta përkrahë procesin e integritimit ndëretnik nëpërmjet bashkëpunimit me palët e interesuara lokale për zhvillimin dhe implementimin e planeve aksionale lokal për promovimin e demokracisë multikulturore dhe bashkëjetesën ndëretnike në komunat e Kumanovës, Mavrorë-Rostushës dhe Strugës.

## **2.2 Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive**

Miratimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (MKO) paraqiste bazë për ndërtimin e bashkëjetesës ndëretnike dhe afrimin e grupeve të ndryshme etnike në Republikën e Maqedonisë. Një aspekt i rëndësishëm i MKO-së ishte procesi i decentralizimit , i cili është delegimi i autorizimeve nga pushteti qendror në atë lokal. Në përputhje me obligimet e marra me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (MKO), u soll Ligji për vetëqeverisje lokale në vitin 2002 . Ideja primare e reformave ishte siguri i pjesëmarrjes kualitative të bashkësive etnike jo shumicë në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal. Procesi i decentralizimit, gjithashtu, nënkupton reforma në funksionimin e njësive të vetëqeverisjes lokale nëpërmjet bartjes së delegimit nga niveli qendror në atë lokal, decentralizimin fiskal, si dhe riorganizimi e tyre fizik/gjeografik .

Këto reforma kishin ndikim në rikonstruktimin etnik në njësitë e vetëqeverisjes lokale, si dhe rritjen e autorizimeve dhe obligimeve të tyre. Një rezultat direkt nga këto procese ishte formimi i Komisioneve për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive (KMNB), të cilët paraqesin një kornizë unike institucionale për lehtësimin e dialogut në mes të komuniteteve lokale. Komisionet paraqisnin një mekanizëm për përfshirje institucionale të të gjitha komuniteteve etnike jo shumicë që jetojnë brenda komunës në procesin e krijimit të politikave dhe vendimmarrjes në nivel lokal, duke siguruar mundësinë për pjesëmarrje të barabartë të të gjitha komuniteteve pa dallim të statusit të tyre shumicë/pakicë në kuadër të komunës.

### **2.2.1 Korniza ligjore**

Ligji për vetëqeverisje lokale parasheh formimin e KMNB në komunat në të cilat më së paku 20% e popullatës i përket një grupi etnik që nuk është në shumicë në atë komunë. Megjithatë, disa komuna kanë krijuar komisione të atilla me vetëiniciativë, edhe pse ato nuk janë subjekt i obligimit ligjor. Të tilla janë komuna e Vrapçishtit dhe ajo e Gostivarit, të cilat marrin pjesë në projekt.

Në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale, puna e KMNB është e definuar në nenin 55, i cili përcakton se të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale ku më së paku 20% e popullatës përbëhet prej



anëtarësh të grupit etnik jo shumicë janë të obliguar të formojnë KMNB; Komisionet përbëhen prej numrit të barabartë të pjesëmarrësve nga secili komunitet në komunë; zgjedhja e anëtarëve të komisionit është e rregulluar me Statutin. Komisioni merret me çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet bashkësive etnike në komunë, i adreson këto mendime dhe rekomandime dhe ia paraqet Këshillit të Komunës (Ligji për vetëqeverisje lokale 2002). Më pastaj, neni 41 i Ligjit nënkupton respektimin e parimit për shumicë të dyfishtë lidhur me marrjen e vendimeve të cilat janë me interes për komunitetet jo shumicë në komunë ( Ligji për vetëqeverisje lokale , 2002).

Këto reforma janë miratuar me qëllim që të sigurohet promovimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal, për shkak se anëtarësia në Komision nuk është e limituar vetëm tek anëtarët e Këshillit të Komunës, siç është rasti me Komisionet tjera lokale. Po ashtu, në fillim të aprovimit të KMNB, u rekomandua se anëtarët e KMNB nuk duhet të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të Këshillit të Komunës, gjë që u adoptua si praktikë në shumicën e KMNB-ve. Sipas statutit, këshillat komunalë janë të lirë ta përcaktojnë numrin e anëtarëve të KMNB lokale, cilat komunitete do të jenë të përfaqësuara në KMNB, dhe deri në ç'masë dhe me çfarë kapaciteti KMNB-ja lokale do të jetë e hapur për përfaqësuesit e sektorit civil. Për rrjedhojë, korniza e cila rregullon funksionimin e komisioneve i bën ato më shumë organe komunale se sa organe të Këshillit të Komunës.

## 2.2.2 Funksionimi

Korniza ligjore e punës e cila rregullon funksionimin e KMNB-së lokale u siguron një shkallë fleksibiliteti në funksionimin e tyre. Megjithatë, ky fleksibilitet po ashtu do të thotë se puna e tyre është e lehtësuar/limituar me mundësitë dhe interesin e komunave, respektivisht funksionimi i tyre dhe realizimi i rolit të tyre dallon prej një komune në tjetrën.

Sipas analizave të Institutit për Zhvillim të Komunitetit (IZhK), fleksibiliteti i parashikuar nga korniza ligjore e KMNB-së nënkupton një situatë në të cilën njësitë e vetëqeverisjes lokale u përmbahen interpretimeve të ndryshme të Ligjit për vetëqeverisje lokale, i cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në punën e KMNB-ve dhe shkakton vështirësi në funksionimin e tyre (BONA MENTE: Përkrahje Komisioneve për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, 2011). Kjo gjithashtu do të thotë se përveç ekzistimit të mekanizmit të shumicës së dyfishtë në proceset e vendimmarrjes që ndikojnë në interesin vital të komuniteteve jo shumicë në komunë, kjo jo gjithmonë do të thotë se Këshilli i Komunës i merr parasysh rekomandimet, mendimet dhe punën e KMNB-së lokale. Për krahasim, Komiteti për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive në Kuvend jep mendim dhe rekomandime në lidhje me marrëdhëniet etnike në nivel të shtetit. Megjithatë, dallimi qëndron në atë se Kuvendi është i obliguar t'i merr parasysh mendimet dhe rekomandimet e Komitetit gjatë marrjes së vendimeve.

Gjithashtu, analiza tregoi se në disa komuna në tërë vendin ka pasur iniciativa për riemërtimin e rrugëve . Në shumicën e rasteve, procedurat me të cilat kërkohen rekomandime të KMNB-së lokale nuk respektojnë plotësisht: kishte mungesë të dhënash për takimet e KMNB-së, si dhe rekomandime të shkruara deri te Këshilli i Komunës nëpër arkive. Krahas kësaj, vendimet e marra nga ana e këshillave komunale për financimin e aktiviteteve në sferën e kulturës, duhet gjithashtu t'i marrin parasysh rekomandimet e dhëna nga ana e KMNB-ve lokale . Procedurat shpeshherë janë shpërfillur, veçanërisht në komunat e mëdha me buxhet të madh komunal, ndërsa analiza konkludon se në zonat rurale ka më shumë shembuj për funksionim më të mirë të KMNB-ve (BONA MENTE: Përkrahje Komisioneve për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, 2011).

Në vitin 2015, Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (SIOFA), në bash-

këpunim me OSBE-në dhe Institutin Evropian për Paqe (IEP), përgatiti një analizë për implementimin e MKO-së. Konkluzionet e përgjithshme për procesin e decentralizimit, vënë në dukje se decentralizimi fiskal mbetet kritik, shpërndarja transparente dhe e drejtë e mjeteve për njësitë e vetëqeverisjes lokale mbetet një sfidë e rëndësishme. Analiza e përfaqësimit adekuat të bashkësive etnike ve në dukje se të gjithë pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, duke përfshirë edhe komunitetin shqiptar, mbeten pamjaftueshëm të përfaqësuar, sidomos në postet udhëheqëse. Krahas kësaj, autorizimet e përdorimit të gjuhës së komuniteteve jo shumicë akoma nuk vlerësohen në procesin e punësimit dhe kanë qenë të limituara përpjekjet për rritjen e kompetencës gjuhësore të administratës sa i përket kohezionit social në vendin e punës dhe komunikimit me qytetarët (Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, 2015).

Për sa i përket sferës së arsimit, në raport konkludohet se arsimi në gjuhën amtare në arsimin fillor dhe atë të mesëm për pjesëtarët e bashkësisë etnike shqiptare dhe turke zbatohet në masë të madhe; janë të nevojshme përpjekje shtesë për të përmirësuar situatën e kësaj çështjeje për nxënësit e komuniteteve etnike më të vogla. Edhe krahas kësaj, në raport theksohet se ekzistojnë mundësi të limituara për arsimin parashkollor dhe përfaqësimin e pamjaftueshëm të anëtarëve që u përkaasin komuniteteve etnike jo shumicë. Segregacioni këmbëngulës nëpër shkolla konsiderohet si një ndër problemet më të mëdha me të cilin rrezikohet kohezioni social në sferën e arsimit (Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, 2015).

Analiza, gjithashtu eksploron punën e institucioneve të caktuara të cilat kanë mandat për të punuar në përmirësimin e pozicionit shoqëror të komuniteteve jo shumicë në vend, duke përfshirë edhe KMNB-në. Në raport konkludohet se ekzistojnë probleme serioze për sa i përket punëtorëve të këtyre institucioneve. Gjegjësisht, Agjencia për Realizimin e të Drejtave të Komuniteteve (ARDK), e cila është e fokusuar kryesisht në mbrojtjen e komuniteteve jo shumicë të cilët paraqesin më pak se 20% të popullatës, akoma mbetet me mandat joadekuat, me buxhet të pamjaftueshëm dhe me mungesë të përkrahjes nga institucionet relevante. Ngjashëm me këtë, Sektori i arsimit në gjuhën e komuniteteve jo shumicë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Agjencisë për avancimin e kulturës së pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë janë të financuara pamjaftueshëm dhe dobët të ekipuara me kuadro. Po ashtu, është konstatuar se këto institucione nuk përfshihen rregullisht në proceset e krijimit të politikave (Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, 2015).

Sa i përket punës së KMNB-së, vihet në dukje se “shumica e komisioneve janë jofunksionale dhe përballen me mungesë të mjeteve dhe përkrahje për implementim të suksesshëm të mandatit të tyre. Ky model nuk siguron mekanizma formal të koordinimit horizontal dhe vertikal me institucione relevante: SIOFA, Komisioni për parandalim të diskriminimit, si dhe zyra e Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve” (Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, 2015, f. 87). Disa rekomandime të dala u ndërlidhën me punën e KMNB-ve lokale:

- ☞ Zgjerim i mundshëm i përbërjes së Komitetit për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive (KMNB) me qëllim që të sigurohet përfaqësim i komuniteteve më të vogla etnike (Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, 2015, fq. 11);
- ☞ Të përcaktohet kompetenca e KMNB-së lidhur me zbatimin e parimit të Badinterit (njëlloj, fq. 13);
- ☞ Ndryshimi i kornizës ligjore për koordinim formale vertikal me Komitetin në nivel qendror, si dhe institucionet tjera. SIOFA do të jetë trup përgjegjës për analizën e kornizës ligjore për rregullimin e statusit, kompetencave, organizimin dhe financimin e KMNB-



së, ndjekjen e implementimin të kornizës ligjore (njëlloj, fq. 87);

- ☞ Ndryshimi i kornizës ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të KMNB-së, mandati i tyre dhe përgjegjësitë e këshillave komunalë për të kërkuar mendim nga KMNB, si dhe për zgjidhjen e çështjeve për financimin e punës së komisioneve (% nga buxhetet lokale dhe buxheti qendror) (njëlloj, fq. 87);
- ☞ Përfshirja e KMNB-ve lokale në vendimet që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve të komuniteteve më të vogla etnike në nivel lokal (njëlloj, fq. 160);
- ☞ Shfuqizimi apo reduktimi i pragut ligjor prej 20% nga numri i përgjithshëm i qytetarëve që i përkasin komunitetit jo shumicë sipas regjistrimit të fundit, si kusht për formimin e Komisionit për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive në komunat (njëlloj, fq. 248);
- ☞ Aprovimi i obligimit për KMNB të paraqesë raport vjetor për punën e këshillave komunalë dhe qytetarëve të komunës dhe të Komitetit për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive për revizion. Për të siguruar kontinuitet në punën e KMNB-së lokale pas ndryshimit të pushtetit lokal, është propozuar zgjerim i mandatit të KMNB-së deri në pesë vite, ndër-sa mandati i anëtarëve të këshillit komunal do të mbetet 4 vite (njëlloj, fq. 248);
- ☞ Ndryshime ligjore në drejtim të forcimit të rolit të KMNB-së kërkojnë mendime dhe propozime të tyre paraprake mbi çështje që kanë të bëjnë me arsimim, buxheti komunal dhe shpërndarjen e tij, pasi që kanë ndikim kyç në realizimin e të drejtave të komuniteteve lokale (njëlloj, fq. 248);
- ☞ Fuqizimi i resurseve institucionale, materiale dhe njerëzore të KMNB, si përfaqësues dhe zëdhënës të komuniteteve të tyre etnike dhe bashkëjetesës së tyre në nivel lokal (njëlloj, fq. 249).

### 2.3 Arsimimi i integruar

Në Republikën e Maqedonisë, arsimi shkollor fillor realizohet varësisht nga gjuha amtare e nxënësve (maqedonisht, shqip, turqisht, serbisht), dhe pjesëtarëve të komuniteteve më të vogla etnike (romë, vlleh, boshnjakë) kanë lëndë zgjedhore për të mësuar gjuhën amtare dhe kulturën. Ndërkaq, në dy dekadat e fundit ka rritje të vazhdueshme të segregacionit etnike në shkollat në bashkësitë multietnike (Qendra Maqedonase për Arsim Qytetar, 2011). Nxënësit ndjekin mësimin në turne të ndara, segregacioni intensifikohet gjatë dhe pas konfliktit etnik të vitit 2001, si rezultat i tensioneve në rritje dhe konflikteve në mes të nxënësve, gjë që rezultoi me ndarje të nxënësve në hapësira të ndryshme. Megjithatë, këto praktika nuk e zgjidhën problemin, gjë që çoi deri në distancë më të madhe sociale ndërmjet nxënësve. Konfliktet në mes të nxënësve u zhvendosën nga ambientet shkollorë në transportin publik dhe nëpër rrugë, dhe ndarja është vetëm rritje e tensioneve. Edhe pse në nivel makro marrëdhëniet ndëretnike janë më të mira si rezultat i qasjes institucionale për implementimin e MKO, “integrimi jo i mjaftueshëm në nivel individual, u rrit në një kërcënim afatgjatë për kohezion social” (Georgieva, Vellkovski, & Damovska, 2014, fq. 128). Segregacioni në sistemin arsimor u manifestua dhe në mënyrë latente u përkrah shumë vite, me qëllim që të shmangen konfliktet ndërmjet nxënësve të grupeve të ndryshme etnike. Megjithatë, pasojat nga ky segregacion në lidhje me përforcimin e stereotipeve dhe paragjykimëve tek nxënësit edhe pas gati një dekade pas miratimit të MKO, mossauesi i sistemit arsimor në drejtim

të zhvillimit të kohezionit social ndërmjet grupeve të llojllojshme kulturore më në fund u pranua. (Bakiu, Dimitrovska & Brava, 2016).

Duke pasur parasysh këtë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) vendosi që të marrë masa dhe të ndërpret praktikën e segregacionit dhe të nxisë reforma arsimore të cilat do të kontribuojnë në afrimin e nxënësve. Obligimet u bartën në dokumente strategjike dhe dispozita. U adoptuan aktivitete të përbashkëta jashtëmësimore, sidomos në shkollat ku mësimi është i organizuar turne “të pastra” etnike.

Bazuar në të dhënat e MASH-it, vetëm 19% e shkollave fillore në vend kanë status të shkollës ku mësimi është në dy gjuhë, ndërsa 4,75% në tri gjuhë. Mirëpo, në rastin kur 6,53% e shkollave fillore të cilat kanë statusin e shkollave në të cilat mësimi mbahet në dy gjuhë, ekziston një dallim i rëndësishëm në numrin e nxënësve të regjistruar. Domethënë, mësimi në njërën nga gjuhët e ofruara është shoqëruar nga një numër dukshëm më të vogël të nxënësve, krahasuar me dhjetëfish më shumë nxënësve që ndjekin mësim në një gjuhë tjetër (Kërsteska-Papiq, etj., 2015). Gjithashtu, duhet theksuar se shumica e shkollave që kanë mësim në dy ose më tepër gjuhë janë vetëm deklarativisht multietnike, pasi që një pjesë e madhe e tyre punojnë në disa shkolla më të vogla periferike ku mësimi është në një gjuhë.

Shkollat me strukturë heterogjene të nxënësve dhe të punësuarve zakonisht punojnë në hapësira të ndara (në objekte të ndryshme shkollore), me orë mësimore të organizuara në turne të pastra etnike, si dhe organizim paralel dhe zbatim të aktiviteteve të njëjta ose të ngjashme mësimore dhe jashtëmësimore në gjuhë të ndryshme. Këto kushte ndikojnë negativisht në realizimin e kontakteve permanente ditore ndërmjet pjesëmarrësve në procesin arsimor, mirëkuptimin e tyre të ndërsjellë dhe bashkëpunimin.

Në vitin 2011, MASH në bashkëpunim me USAID, filloi me realizimin e projektit për arsim të integruar në shkollat fillore dhe të mesme në gjithë vendin. Projekti përbëhej prej aktiviteteve në drejtim të forcimit të kapaciteteve të kuadrit arsimor dhe administrativ në shkollat për orë mësimore në grupet multietnike, teknika për ndërmjetësim, etj.; aktivitete të përbashkëta mësimore dhe jashtëmësimore për nxënësit e grupeve të ndryshme etnike; pjesëmarrje të përbashkët në këshillat e shkollave, këshillat e arsimtarëve dhe prindërve, futjen e lëndëve zgjedhore për mësim në gjuhëve të komuniteteve të tjera etnike, etj. Të gjitha shkollat kanë marrë udhëzime konkrete dhe obligime që lidhen me arritjen e rezultateve konkrete nga aktiviteti.

Arsimi i integruar është fuqizuar në mënyrë plotësuese përmes përcaktimeve strategjike në emër të MASH-it. Me ndihmën e Komisarit të lartë për pakica nacionale në janar të vitit 2010, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe OSBE hartuan dokument strategjik “Hapat drejt arsimit të integruar në sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë” (Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë, 2010), me qëllim të sjelljes së ndryshime të qarta dhe drastike në qasjen e përgjithshme në sistemin arsimor në aspekt të realitetit multietnik në shoqëri. Megjithatë, për shkak të presioneve të mëdha politik në lidhje me implementimin e reformave të caktuara në arsimin fillor (që kanë të bëjnë me mësimin e gjuhëve të komuniteteve tjera etnike) proceset reformuese janë vendosur në prapavijë dhe nuk janë paraparë iniciativa të reja në këtë sferë të Planit të ri Strategjik 2015-2017 të MASH-it (Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2014).

Raporti për progresin e zbatimit të konceptit për arsim të integruar të përpiluar si pjesë e projektit “Dialogë për Vizion”, tregon se mungesa e mjeteve financiare në komuna paraqet një nga pengesat më të mëdha për implementimin e konceptit të arsimit të integruar. Shumë nga aktivitetet e nxitura si rezultat i pjesëmarrjes në projekt, pa dallim nëse implementohen nga MASH-i apo sektori civil, ndërpriten pas përfundimit të projektit (Bakiu, Dimitrovska & Brava, 2016).



Një mungesë tjetër e cekur në këtë studim është mungesa e sektorit për arsim të integruar në kuadër të bartësit kryesor të politikës arsimore - Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Komunitet, sidomos ato që janë me strukturë heterogjene etnike, kanë kapacitet të vogël për të menaxhuar me aktivitetet lidhur me zbatimin e konceptit të arsimit të integruar (Bakiu, Dimitrovska & Brava, 2016). Analizat për implementimin e modelit të edukimit të integruar tregojnë se pjesa më e madhe e aktiviteteve zbatohen vetëm për të përmbushur kërkesat minimale - aktivitetet jashtëmësimore janë të limituara në ngjarje sportive dhe kremtime dhe manifestime kulturore. Doemos të përmendet se shkollat, pjesa dërmuese, janë të lëna vetëm për të për rritjen e mjeteve financiare për zbatimin e këtyre aktiviteteve. Në shumë raste, me bllok doacionet të cilat i marrin vështirë mund t'i zgjidhin nevojat e veta themelore. Në shumë raste, aktivitetet janë zbatuar në atë mënyrë që nxënësit të ndjehen se u është imponuar, kështu që iniciativat zakonisht hasin në rezistencë (të zbuluar ose latente), gjë që rezulton me ndikim të dyshimtë. Kjo situatë nuk siguron garanci se përpjekjet për të siguruar integrim ndëretnik në shkolla do të vazhdojë edhe pas ndërprerjes së obligimeve formale.

## 2.4 Sektori civil

Një pjesë e madhe e iniciativave për përmirësimin e bashkëjetesës ndëretnike dhe mirëkuptimit multikulturor janë implementuar nga organizatat e shoqërisë civile. Në vitet pas MKO, këto aktivitete u intensifikuan. Projektet e realizuara janë hulumtuese dhe të orientuara me ndikim, të lidhura me aspekte të ndryshme të implementimit të MKO-së dhe përmirësim të mirëkuptimit multikulturor: integrimi etnik në administratën shtetërore dhe komunale, trajnime për forcimin e kapaciteteve të administratës për mbështetje të kohezionit social ndëretnik, promovim të parimit të arsimit të integruar që nga mosha më e re, promovim të mekanizmave për përmirësimin e përfshirjes të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal, avancim i integritimit ndëretnik mes të rinjve, etj. Analiza e detajuar e ndikimit të siguruar nga ana e secilës prej këtyre iniciativave është, megjithatë, jashtë diapazonit të këtij raporti.

Një aspekt i rëndësishëm që duhet të merret parasysh është fakti se këto iniciativa paraqesin një përkrahje të veçantë të autoriteteve lokale, të cilat në masë të madhe kanë mungesë të kapaciteteve (kryesisht financiare, resurseve njerëzore) për inicim dhe zbatim të aktiviteteve në këtë segment. Për këtë qëllim, implementimi i aktiviteteve në nivel lokal në masë të madhe varet nga qasja deri te përkrahja donatore.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me kapacitetet e organizatave lokale qytetare (OQ) të inicijonë dhe të zbatojnë iniciativat të cilat do të kontribuojnë në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në nivel lokal. Për qëllimet e hulumtimit të kapaciteteve të OQ-ve lokale për të vepruar në sferën e integritimit multi-etnik, intervistat u realizuan me përfaqësues të sektorit civil. U veçuan disa probleme: mungesa e mjeteve stabile financiare, mungesa e përkrahjes financiare nga ana e autoriteteve lokale për implementimin e iniciativave të këtij lloji (edhe pse bashkëpunimi u vlerësua pozitivisht), mungesa e bashkëpunimit me KMNB-të lokale.

Ky konkluzion është i rëndësishëm në aspekt të faktit se pjesa dërmuese e iniciativave që realizohen në nivel lokal janë implementuar nga ana e organizatave jashtë komunës, ndërsa organizatat lokale kanë përkrahje të vogël për implementimin e iniciativave të veta të tyre. Situata e këtillë është mëse evidente në komunitetet rurale, ku sektori lokal civil, shpesh është pamjaftueshëm i zhvilluar.



### 3. Kushtet aktuale në komunat e synuara

#### 3.1 Komuna e Bërvenicës



Komuna e Bërvenicës gjendet në jug të qytetit të Tetovës, në pjesën qendrore të luginës së Pollogut, duke mbuluar një territor prej 158 km<sup>2</sup>, kufizohet me komunat: Tetovë, Bogovinë, Zhelinë, Gostivar, Vrapçisht dhe Makedonski Brod. Komuna u themelua me Ligjin për organizimin territorial të Republikës së Maqedonisë në vitin 1996. Para vitit 1996, territori i komunës së Bërvenicës paraqet një pjesë të komunës së Tetovës. Bërvenica është komunë rurale dhe përfshin 10 vendbanime, të organizuara në 11 bashkësi lokale.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2002, komuna e Bërvenicës ka 15.855 banorë me prejardhje të ndryshme etnike: shqiptarë (61.62%), maqedonas (37.53%) dhe 0.85 % të tjerë (boshnjakë, serbë, etj.) (Enti Shtetëror i Statistikave, 2005).

Analiza e dokumentacione përkatës, si dhe hulumtimet e mëparshme mbi zhvillimin e multikulturalizmit në Bërvenicë, vënë në dukje atë se para vitit 2013 ka pasur relativisht pak përpjekje në emër të organeve të vetëqeverisjes lokale për sa i përket përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike në nivel komunal. Përpjekjet kryesisht janë të lidhura me bashkëpunimin sporadik në projektet për arsimin e integruar, të implementuara dhe të mbështetura nga organizatat donatore. Si rezultat i kësaj, organet e vetëqeverisjes lokale dhe aktorë të tjerë relevantë janë fuqimisht të varur nga mbështetja donatore për implementimin e iniciativave të këtilla, gjendje e cila vazhdon edhe sot. Kjo, ndërkaq, disi i gërmon kapacitetet e tyre për të vepruar mbi çështjen e promovimit të mirëkuptimit multikulturor dhe të bashkëjetesës.

Një iniciativë e rëndësishme e ndërmarrë nga autoritetet lokale në lidhje me këtë ishte miratimi i Strategjisë për zhvillim të dialogut multikulturor (2014-2017) në vitin 2014. Përpara kësaj Strategjie kishte disa përpjekje sporadike nga organizatat civile dhe institucionet arsimore për mbështetjen e dialogut ndëretnik dhe mirëkuptimin ndërkulturor. Edhe krahas sektorit civil relativisht të pazhvilluar, institucionet e vetëqeverisjes lokale mbajnë komunikime me organizatat qytetare, përmes takimeve të drejtpërdrejta. Seancat e Këshillit të Komunës janë gjithashtu të hapura për të gjithë qytetarët e interesuar. Bashkësitë lokale në komunën e Bërvenicës, shprehën gjithashtu interes për të kontribuar drejt afrimit të anëtarëve të komuniteteve të ndryshme etnike, megjithatë nuk është ndërmarrë asnjë aksion konkret deri më tani. Prapëseprapë, mjetet e pakta të buxheti komunal për manifestime kulturore dhe ngjarje sportive të cilat do t'i afronin qytetarët që u përkasin grupeve të ndryshme etnike tregojnë se në komunën e Bërvenicës këto ngjarje nuk janë shumë të shpeshta.

Komisioni për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive (KMNB) të komunës së Bërvenicës është themeluar në seancën e Këshillit të Komunës më datë 19.09.2013. Komisioni përbëhet prej gjashtë anëtarësh, tre prej të cilëve janë anëtarë të Këshillit të Komunës, ndërsa tre anëtarët tjerë janë persona nga jashtë. Kryetari i Komisionit, po ashtu, është person i jashtëm. KMNB Bërvenicë ka Rregullore për punë, por jo edhe program për punë. KMNB Bërvenicë kryesisht u referohet çështjeve në sferën e arsimit, kulturës, sportit dhe infrastrukturës. Konkluzionet e KMNB komunikohen përmes tabelës së shpalljeve (Komuna e Bërvenicës, 2014).

Në vitet e kaluara, anëtarët e KMNB Bërvenicë kanë marrë pjesë në trajnime për rritjen e kapaciteteve të tyre në fushën e marrëdhënieve ndëretnike. Megjithatë, raportet paraprake mbi punën e KMNB Bërvenicë kanë identifikuar mungesën e komunikimit me shkollat lokale: stafi mësimdhënës dhe administrativ nuk janë të informuar mirë për sa i përket funksionit të KMNB dhe mundësitë për bashkëpunim. Gjetjet nga hulumtimet në terren vënë në dukje se këto probleme përsëriten vazhdimisht, dhe se ka mungesë të vetëdijes për aktivitetet e këtij trupi, madje edhe tek administrata komunale. Krahas ndryshimeve në punë në lidhje me formimin dhe funksionimin e KMNB nga viti 2013, është evidente se nevojiten përpjekje plotësuese që KMNB Bërvenicë ta shfrytëzojë kapacitetin e vet të plotë.

Për sa i përket sferës arsimore, ekzistojnë tre shkolla fillore të cilat punojnë në komunën e Bërvenicës: “Kosta Racin” në fshatin Bërvenicë; “7 Marsi” në fshatin Çellopek (orët mbahen në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe), dhe “Goce Dellçev” në fshatin Stençe (orët mbahen në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe). Të gjitha shkollat kanë staf multietnik mësimdhënës dhe administrativ.

Të tria shkollat fillore janë pjesë e iniciativës për arsimim të integruar, zbatuar në emër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, me mbështetje financiare të USAID-it. Shkolla fillore “Kosta Racin” ka vendosur bashkëpunim me një shkollë tjetër fillore nga fshati Pirok (komuna e Bogovinës), ku aktivitetet jashtëmësimore mbahen në gjuhën shqipe. Shkolla fillore “7 Marsi” ka një traditë të gjatë në arsimimin e fëmijë nga grupe të ndryshme etnike, fëmijë maqedonas dhe shqiptarë ndjekin mësimin në turnin e njëjtë, ka takime të përbashkëta të këshillave të shkollës, manifestime dhe ekskursione të përbashkëta. Fakti që të tri shkollat marrin pjesë në iniciativën për arsim të integruar tregon se nxënës nga të gjitha etnitë kanë orë të përbashkëta në gjuhën angleze, art dhe edukatë fizike (Komuna e Bërvenicës, 2014). Të gjithë mësimdhënësit që punojnë në shkollën “7 Marsi” morën certifikatë për kompetencë ndërkulturore të ndarë nga USAID-i.

Aktivitetet kryesore jashtëmësimore për nxënësit e të gjitha grupeve etnike janë të lidhura me manifestime sportive, vazhdimi i të cilave është vënë në pikëpyetje për shkak të mungesës së mjeteve. Sipas përfaqësuesve nga sfera arsimore, ekskursionet e përbashkëta, të cilat janë aktivitete tradicionale në shkolla, gjithashtu janë vënë në pikëpyetje për shkak të mungesës së mjeteve.

## **Strategjia për zhvillimin e dialogut multikulturor**

Me qëllim të lehtësimit të bashkëjetesës ndëretnike dhe zhvillimit të demokracisë multikulturore, në vitin 2013 komuna e Bërvenicës ka marrë pjesë në projektin për “Përmirësimin e Mirëkuptimit Ndërkulturor në komunat Multi-etnike në Maqedoni” të implementuar nga ADI, dhe me mbështetje financiare të Ambasadës britanike në Shkup. Si rezultat i aktiviteteve të projektit, në vitin 2014, Këshilli Komunal i komunës së Bërvenicës miratoi Strategjinë për Zhvillimin e Dialogut Multikulturor (2014-2017). Qëllimi kryesor i strategjisë ishte “përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike, dialogu ndërkulturor dhe toleranca fetare që do të kontribuojë për një komunitet të prosperuar bazuar në vlerat e rrënjësore lokale” (Komuna e Bërvenicës, 2014, fq.5).



## Qëllimet specifike të Strategjisë kanë të bëjnë me:

1. “Forcimin e kapaciteteve të administratës komunale dhe Komisioni për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive për kreativitetin, transparencën dhe llogaridhënien e tyre;
2. Mbështetjen për sistemin të integruar arsimor që i përfshin të gjithë nxënësit në procesin e ngritjes së vetëdijes për bashkëjetesë dhe tolerancë;
3. Qasje e organizuar për ngritjen e vetëdijes të të gjithë komunitetit për rëndësinë dhe nevojën për dialog ndërkulturor” (Komuna e Bërvenicës, 2014, fq. 6)

Korniza kohore për implementimin e Strategjisë është tre vjet, në periudhën prej 1 Korrikut 2014 deri më 30 Qershor 2017.

Komuna, KMNB-ja dhe aktorët tjerë relevante janë përgjegjës për monitorimin e procesit të implementimit të Strategjisë, si dhe të efektshmërisë së saj, dhe t’i bëjnë intervenimet e duhura. U ra dakord që komuna, KMNB-ja, OQ lokale dhe shkollat, si aktorë kyç të sigurojnë një plan për monitorimin e implementimit të Strategjisë (Komuna e Bërvenicës, 2014).

Në këtë kontekst, KMNB lokal dhe sektori i arsimit kanë përgjegjësinë kryesore për implementimin e Planit aksional. Implementimi i Strategjisë duhet të monitorohet përmes sigurimit të raporteve vjetore në emër të KMNB, si dhe të sektorit përgjegjës komunal, të cilët janë të obliguar të dorëzojnë raport në fund të çdo viti, të miratohet nga Këshilli i Komunës. Ky raport duhet të sigurojë pasqyrë të të arriturve të indikatorëve të përcaktuar në Planin aksional të strategjisë, si dhe hartimin e rekomandimeve për aksion të mëtutjeshëm (Komuna e Bërvenicës, 2014).

Strategjia parasheh që pas vitit të dytë të implementimit, KMNB Bërvenicë dhe personi përgjegjës, në bashkëpunim me OQ lokale, përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisje lokale, si dhe sektorit të arsimit dhe aktorëve tjerë relevantë, të përgatisin një plan për evaluimin e procesit të implementimit të Strategjisë. Evaluimi duhet të bëhet nga ekspertë të pavarur. Rezultatet e vlerësimit janë paraparë të përfshijnë një analizë për zbatimin, informacione për qëllimet e arritura dhe rekomandimet për ndryshim dhe përshtatjen e Strategjisë dhe Planit aksional të gjendjeve dhe nevojave (Komuna e Bërvenicës, 2014).

Aktivitetet që janë paraparë për t’u realizuar në periudhën e paraparë kanë të bëjnë me:

- ☞ Ndryshimin e Statutit të Komunës së Bërvenicës, si dhe zgjerimin e përbërjes së KMNB të Bërvenicës;
- ☞ Takime të rregullta mes Kryetarit të Këshillit të Komunës dhe anëtarëve të KMNB;
- ☞ Përgatitja dhe miratimi i programit operativ të KMNB;
- ☞ Organizimi i trajnimeve për dialog multikulturor për anëtarët e KMNB dhe administratën komunale;
- ☞ Vizita dhe shkëmbime të praktikave me komuna tjera ;
- ☞ Përmirësimin e ueb-faqes së komunës, për të lehtësuar dhe përmirësuar komunikim më të mirë midis qytetarëve dhe komunës;
- ☞ Mbledhje të rregullta mes anëtarëve të KMNB dhe qytetarëve (Komuna e Bërvenicës, 2014).

Në sferën e arsimit, Plani aksional i parasheh aktivitetet në vijim:

- ☞ Futja e gjuhëve të bashkësive tjera etnike;
- ☞ Futja e elementeve multikulturore në disa lëndë mësimore: art, histori dhe letërsi;
- ☞ Orë të përbashkëta në art, histori dhe letërsi;
- ☞ Pjesëmarrje e përbashkët në projekte në sferën e multikulturalizmit;
- ☞ Formimi i ekipeve sportive të përziera dhe organizimi i ngjarjeve sportive;
- ☞ Formimi i klubeve kulturore të përziera dhe organizimi i ngjarjeve kulturore;
- ☞ Organizimi i punësorëve për bashkëpunim ndërkulturor mes nxënësve;
- ☞ Ekskursionet të përbashkëta;
- ☞ Gara të përbashkëta;
- ☞ Përgatitja dhe publikimi i revistave elektronike shkollore;
- ☞ Mbledhje të përbashkëta të këshillave të shkollave, këshillave të prindërve dhe kuadrit mësimdhënës;
- ☞ Organizimi i ngjarjeve të përbashkëta, sidomos në mjediset rurale;
- ☞ Organizimi i kurseve të gjuhës për të rritur, për mësim të gjuhës së bashkësisë tjetër etnike;
- ☞ Formimi i klubeve të përziera sportive;
- ☞ Formimi i klubeve të përziera kulturore;
- ☞ Organizimi i ngjarjeve sportive (Komuna e Bërvenicës, 2014).

Obligimet tjera kanë të bëjnë me:

- ☞ Organizimin e panairove dhe festivaleve vjetore për promovim të karakterit multikulturor të komunës;
- ☞ Sigurimin e mbështetjes për OQ lokale për projektet lidhur me multikulturalizmin;
- ☞ Organizimi i ngjarjeve sportive;
- ☞ Formimi i një klubi etnikisht të përzier për kulturë;
- ☞ Organizimi i kurseve gjuhësore për mësim të gjuhës së bashkësive tjera etnike (Komuna e Bërvenicës, 2014).

Pasqyra e dokumentacionit përkatës si dhe intervistat me aktorët relevantë, bëjnë me dije se ekziston një shkallë progresi në implementimin e Strategjisë. Përbërja e KMN Bërvenicë u zgjerua në 7-9 anëtarë. Është cekur se Komisioni ka përbërje të llojllojshme, me anëtarë nga të gjitha sferat e jetës shoqërore: sektori i biznesit, Këshilli i Komunës, bashkësitë lokale, shkollat, organizatat fetare, etj. Të anketuarit vënë në dukje se anëtarët e Komisionit mbajnë mbledhje të rregullta, edhe pse nuk ka informacione të qasshme për atë nëse ekzistojnë mbledhje tremujore të rregullta siç është paraparë në Strategji.



Aktivitetet dhe përgjegjësitë kryesore të KMNB Bërvenicë ishin zvogëlimi i distancës sociale tek qytetarët, ndërmjetësim në situatat e mundshme konfliktuale, edhe pse u nënvizua se nuk ekzistojnë konflikte në këtë komunë. Anëtarët e KMNB lokale, si dhe aktorët tjerë relevante (anëtarë të Këshillit të Komunës, përfaqësues të bashkësive lokale, komunitete fetare, sektorit të biznesit, sektorit të arsimit dhe institucioneve tjera) kanë marrë pjesë në trajnim për multikulturalizmin dhe afrimin ndëretnik të organizuar nga ADI.

Autoritetet lokale, po ashtu, bëjnë përpjekje që të organizohen aktivitete të përbashkëta për qytetarët me prejardhje të ndryshme etnike: manifestime kulturore dhe ngjarje sportive, ku pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme etike marrin pjesë bashkërisht. Megjithatë, qasja e limituar deri tek mjetet kufizon mundësitë për më shumë ngjarje dhe iniciativa për afim reciprok. Konstatimet e aktorëve relevantë

Konstatimet e palëve të tanguara lokale tregojnë se në përgjithësi marrëdhëniet ndëretnike në komunë janë stabile, dhe nuk kanë ndodhur konflikte, madje edhe në periudhat e krizës. Përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale vënë në dukje se punësimet në administratën komunale janë bërë sipas dispozitave të MKO, duke respektuar të drejtën e të gjitha bashkësive etnike që jetojnë në këtë komunë, me respektim të të drejtave të qytetarëve. Këshilli komunal u përmbahet parimeve për vendimmarrje të përbashkët, si dhe të gjitha vendimet merren me dakrodim nga ana e 15 anëtarëve, prej të cilëve 8 janë shqiptarë dhe 7 janë maqedonas.

Edhe krahas observimit të përgjithshëm të marrëdhënieve stabile ndëretnike në komunë, disa të anketuar ngritën një shqetësim të caktuar se përpjekja për bashkëjetesë ndëretnike mund të jetë në masë të madhe deklarative, dhe nevojiten më shumë iniciativa që të sigurohet afim i qytetarëve të grupeve të ndryshme etnike. Ekziston një pakënaqësi e caktuar në lidhje me investimet komunale në bashkësi të ndryshme, me ç'rast secili grup etnik perceptohet si i përçmuar sa i përket shpërndarjes së resurseve. Megjithatë, komuna bën përpjekje që të balancohet shpërndarja e fondeve lokale për OQ-të që punojnë në përfaqësimin e interesave të bashkësive të ndryshme etnike. Disa të anketuar, gjithashtu, e ngritën çështjen e mungesës së mirëbesimit ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike, gjë që mbetet edhe me tutje problem që duhet të zgjidhet.

Edhe pse ka një bashkëpunim mes administratës komunale me prejardhje të ndryshme etnike, ky bashkëpunim më shpesh shprehet kur të gjithë aktorët relevantë kanë interes të përbashkët. Në raste tjera, bashkëpunimi është kryesisht deklarativ dhe bazohet në parimin e reciprocitetit. Palët e targetuara relevante gjithashtu bëjnë me dije për faktin se reflektimi i problemeve nga niveli qendror në atë lokal, nuk kontribuon në përmirësimin e marrëdhënieve mes bashkësive të ndryshme etnike.

Edhe përkrah faktit se KMNB lokal mban mbledhje të rregullta dhe merr pjesë në çështje me rendësi për pjesëtarët e bashkësive të ndryshme etnike, u cek shqetësimi në lidhje me angazhimet e përgjithshme për përmirësim të bashkëjetesës ndëretnike në komunitet. Disa të anketuar janë të mendimit se duhet të implementohen më shumë projekte dhe iniciativa tjera në këtë sferë. Për sa i përket situatës në sferën e arsimit, të anketuarit nga ky sektor theksuan se situata nuk dallon në mënyrë radikale nga komunat tjera nëpër gjithë vendin, në lidhje me problemet me shpërndarjen e bllok dotacioneve, dhe zvogëlimin e numrit të nxënësve, si rezultat i proceseve intensive të migrimit. Vetëm dy nga njëmbëdhjetë bashkësi lokale nuk janë heterogjene etnikisht, të gjitha bashkësitë tjera janë multi-etnike, me fëmijë nga të gjithë grupet etnike që ndjekin mësimin në të njëjtën shkollë.

Të anketuarit kanë vënë në dukje se shkalla e bashkëjetesa ndëretnike në arsim është vlerësuar

lartë nga kordinatorët e projektit. Në vitin 2011 shkollat e kësaj komune u ranguan në vendin e tretë në mesin e 84 komunave në vend në lidhje me implementimin e arsimit të integruar nga UNDP, dhe në vendin e pestë nga USAID në vitin 2013. Për më tepër, futbollistë të të gjitha bashkësive etnike luajnë së bashku në klubin lokal të futbollit "Besa".

Përfaqësuesit e komunës bëjnë me dije nevojën për më shumë projekte që do të ndihmojnë në bashkëpunimin midis pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike dhe se janë të nevojshme mjete shtesë për të siguruar realizimin e iniciativave të parapara.

Të anketuarit nga sektori arsimor bëjnë me dije se ata i përmbahen planit aksional për sa i përket arsimit. Nxënësit e bashkësive të ndryshme etnike ndjekin orë të përbashkëta mësimore; mbahen mbledhje të përbashkëta të këshillit të shkollës; udhëheqje e përbashkët e shkollës, dhe mbledhje të përbashkëta me mësimdhënësit gjatë orarit të punës. Shumë probleme të rëndësishme janë të lidhura me mungesën e mjeteve për punën bazë, gjë që reflektohet në mundësinë për organizim të aktiviteteve shtesë jashtëmësimore ( gara, ekskursione, manifestime, ngjarje sportive, etj.).

Megjithatë, disa të anketuar bëjnë me dije se ka një mungesë të komunikimit permanent në mesin e të rinjve nga komunitetet e ndryshme etnike gjatë aktiviteteve jashtëmësimore. Komunikimi mes të rriturve në masë më të madhe prihet nga pragmatizmi. Përveç tolerancës dhe vetëm bashkëjetesës, u nënvizua se kontaktet e ndërsjella kanë qenë të rralla, dhe martesat ndëretnike inekzistente. Një pengesë e rëndësishme për qasjen e komuniteteve është mungesa e interesimit tek qytetarët për të mësuar gjuhët e grupeve tjera etnike.

Të anketuarit dhe pjesëmarrësit në debatet publike veçojnë përzierjen e partive politike në çështje të cilat e çrrënjisin bashkëjetesën ndëretnike në këtë komunë. Situata është disi paradoksale - nga njëra anë, mbizotëron opinioni se partitë politike kontribuojnë shumë në prishjen e marrëdhënieve ndëretnike. Nga ana tjetër, qytetarët janë të prirë që të kthehen kah partitë e grupit të tyre etnik për zgjidhjet që kanë të bëjnë me problemet e përditshme dhe interesat e tyre. Qytetarët potencojnë se në sferat ku ata kanë interesa personale (në vendin e punës, për shembull), barrierat etnike lehtë kapërcehen, dhe përveç kësaj, ato nuk janë barrierat për mësim të gjuhëve të grupeve tjera etnike. Në rastet ku nuk ka interesa personale, njerëzit kthehen kah patriotizmi për të mbrojtur ngurrimin e tyre për të komunikuar dhe të tregojnë respekt dhe mirëkuptim ndaj fqinjëve të tyre të grupeve tjera etnike. Patriotizmi ceket si arsye për refuzimin e të mësuarit të gjuhës së grupit tjetër etnik.

Disa aktivitete jashtëmësimore dhe komunale, siç janë garat ndërmjet shkollave dhe lojërave sportive janë organizuar, por shpeshësia e tyre nuk lejon vendosjen e një interaksioni të mirëfilltë midis të rinjve me përkatësi etnike të ndryshme. Këto aktivitete gjithashtu vihen në pyetje për shkak të mungesës së fondeve komunale. Sa i përket kësaj çështjeje, shumica e të intervistuarve dhe pjesëmarrësve në debatin e theksojnë nevojën për ndarjen e mjeteve të veçanta nga buxheti qendror. Një pjesë e madhe e aktiviteteve realizohen vetëm për të përmbushur obligimin ligjor, sepse shkollat janë vënë nën presion të madh për t'i plotësuar këto kërkesa, dhe janë lënë të vetëm në procesin e implementimit, pa mbështetje (financiare, kryesisht) nga qeverisja qendrore.

Një pjesë e rëndësishme e suksesit të përgjithshëm dhe ndikimi i iniciativave të realizuara për afërmim e të rinjve të përkatësive të ndryshme etnike është ndikimi i familjes. Pjesëmarrësit theksuan se asnjë iniciativë nuk do të arrijë sukses pa mbështetjen e prindërve, për këtë shkak ata duhet të jenë më shumë të kyçur në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve. Të gjitha aktivitetet e iniciuara nga jashtë, shpesh konsiderohen si të imponuara dhe përmbushen me rezistencë. Disa nga të anketuarit e deklaruan faktin se ata ndjejnë se janë të "ndëshkuar" me projekte multikulturore, kur të gjitha mjetet u shpërndahen bashkësive etnikisht të pastra.

Pavarësisht faktit se nuk ekzistojnë situata konfliktuoze ndërmjet komuniteteve etnike viteve



të fundit, marrëdhëniet ndëretnike në këtë komunë nuk ishin liruar nga tensionet e kohëpas-kohshme. I tillë është rasti sidomos tek të rinjtë. Ndërkaq të rriturit kanë ndërtuar njëfarë forme të bashkëjetesës paqësore, me komunikim dhe bashkëpunim të kufizuar dhe tolerancë pragmatike, të rinjtë gjithnjë e më pak janë të gatshëm të ruajnë madje edhe kontaktet bazike midis njëri tjetrit. Përfaqësuesit e sektorit të biznesit janë prononcuar se nuk kanë hasur në barriera lidhur me bashkëpunimin me pjesëtarët e komunitete të ndryshme etnike në komunën e Bërvenicës. Ata potencojnë se kur bëhet fjalë për sferën e veprimit, ekziston komunikimi i udhëhequr nga interesi i përbashkëta. Megjithatë, njëlloj u potencua se qytetarët, veçanërisht të rinjtë, ende preferojnë të komunikojnë dhe të jenë me njerëz të grupit të tyre etnik.

Të anketuarit, gjithashtu, konsiderojnë se ndikimi i sektorit të biznesit në situatën e përgjithshme me marrëdhëniet ndëretnike në komunë është i vogël, dhe më shumë lidhet me kohën dhe hapësirën e përbashkët që e ndajnë punëtorët e komuniteteve të ndryshme etnike. Njëlloj, është veçuar rëndësia e marrëdhënieve të favorshme ndëretnike për zhvillimin ekonomik të komunës. Kontributi më i madh në këtë segment ka qenë mbështetja financiare nga sektori i biznesit për promovim të iniciativave për afrim multikulturor dhe ndëretnik, të implementuar nga autoritetet lokale dhe OQ-të.





### 3.2 Komuna e Vrapçishtit



Komuna e Vrapçishtit gjendet në pjesën veriperëndimore të vendit, në rajonin e Pollogut. Sipas regjistrimit të popullsisë të viti 2002, komuna ka 28.210 banorë, prej të cilëve 83% janë shqiptarë, 12% janë turq, 4% janë maqedonas dhe 1% të tjerë (Enti Shtetëror i Statistikave, 2005).

Komuna e Vrapçishtit përbëhet prej 16 bashkësive lokale, me 13 shkolla, 12 prej të cilave janë fillore dhe një shkollë e mesme në fshatin Negotinë.

Një ndër karakteristikat kryesore të komunës është tradita e gjatë e multikulturalizmit autentik të pjesëtarëve të bashkësisë etnike shqiptarë, turke dhe maqedonase (Komuna e Vrapçishtit, 2014).

Edhe krahas faktit se nuk ekziston obligimi ligjor për formimin e KMNB, Komuna e Vrapçishtit e ka formuar këtë Komision në vitin 2006. Komisioni përbëhet prej gjashtë anëtarësh (nga dy prej secilit grup etnik), të cilët nuk kanë qenë anëtarë të Këshillit të Komunës. Një ndër arritjet më të rëndësishme të Komisionit ishte miratimi i gjuhës turke si gjuhë e tretë zyrtare në komunë (Komuna e Vrapçishtit, 2014).

Megjithatë, raporti i përgatitur nga ADI identifikon disa të meta në punën e KMNB Vrapçisht, kryesisht të lidhura me mungesën e vetëdijes së qytetarëve për rolin dhe aktivitetet e tij, duke çrënjosur pozicionin e vet si forum për dialog multietnik dhe multikulturor (Komuna e Vrapçishtit, 2014).

Në lidhje me sferën arsimore, mësimi në gjuhën shqipe mbahet në SHF "Mehmet Derralla" në fshatin Gradec, SHF "Naim Frashëri" në fshatin Negotinë dhe SHF "Sali Lisi" në Dobërdoll, si dhe në shkollën e mesme "Negotina". Shkolla e mesme "Negotina" ka vendosur bashkëpunim me shkollën e mesme "Ljupço Stanov" nga komuna e Koçanit dhe nxënësit kanë marrë pjesë në disa ngjarje të përbashkëta jashtëmësimore. Nxënësit e përkatësisë etnike maqedonase dhe turke shkollimin e tyre të mesëm e vazhdojnë në shkollat e mesme në komunën fqinje të Gostivarit. Futja e mësimi në gjuhën maqedonase nuk është e realizueshme për shkak të numrit të vogël të nxënësve të përkatësi etnike maqedonase (Komuna e Vrapçishtit, 2014).

Një shembull pozitiv i arsimit të integruar në komunën e Vrapçishtit është SH "Vrapçisht", ku mësimi zhvillohet në tri gjuhë - maqedonisht, shqip dhe turqisht. Nxënësit marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta mësimore dhe jashtëmësimore - udhëtime, ngjarje sportive, manifestime kulturore, kremtime etj. Organizohen trajnime të përbashkëta të kuadrit mësimor, ndërsa shkolla merr pjesë në projekte të ndryshme për përmirësimin e bashkëpunimit ndëretnik dhe ndërkulturore.

Megjithatë, akoma ka sfida të caktuara në sferën e bashkëjetesës ndëretnike, që duhet të tejkalohen. Do të thotë, sipas analizës së gjendjes të realizuar nga ADI, marrëdhëniet ndëretnike në nivel lokal janë nën influencë të madhe të vendimeve të marra në nivel qendror. Domethënë, komunat nuk kanë të drejtë vote për çështjet që kanë të bëjnë me qytetarët e tyre, për shembull zgjedhjen e teksteve shkollore, madje edhe në raste kur duket qartë se përmbajtja nuk është etnikisht e balancuar dhe mund të ketë ndikim negativ mbi marrëdhëniet ndëretnike në nivel lokal. Ndonëse njësitë e vetëqeverisjes lokale nuk kanë mandat të drejtpërdrejtë në këtë sferë, ato në mënyrë indirekte ndikojnë në diskursin publik dhe proceset politike të cilat mund të çojnë deri në zgjidhje pozitive të këtyre çështjeve (Naskova, Mehmeti & Imeri, 2013).

## Strategjia për zhvillimin e dialogut multikulturor

Procesi i zhvillimit të bashkëjetesës ndëretnike dhe demokracisë multikulturore vazhdoi me pjesëmarrjen e Komunës së Vrapçishtit në projektin “Përmirësimi i mirëkuptimit ndërkulturor në komunat multi-etnike në Maqedoni” i implementuar nga ADI, me mbështetje financiare të Ambasadës britanike në Shkup. Pjesëmarrja në këtë projekt rezultoi me miratimin e Strategjisë për zhvillim të mirëkuptimit multikulturor (2014-2017) në vitin 2014. Qëllimi kryesor i Strategjisë është “përf forcimi i komunikimit multikulturor në Komunën e Vrapçishtit bazuar në mirëkuptimin e përmirësuar multikulturor të qytetarëve të bashkësive të ndryshme etnike” (Komuna Vrapçisht, 2014, fq.8).

## Qëllimet specifike të Strategjisë kanë të bëjnë me:

1. “Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta kulturore të cilat përfshijnë një numër të madh të qytetarëve nga të gjitha komunitetet në komunë;
2. Mësimin e gjuhëve të komuniteteve të ndryshme;
3. Përmirësimin e komunikimit në sferën arsimore, me pjesëmarrje aktive të nxënësve dhe prindërve të tyre;
4. Rritjen e bashkëpunimit multikulturor në sferën sportive;
5. Rritjen e efikasitetit të institucioneve lokale në sferën e marrëdhënieve ndëretnike” (Komuna e Vrapçishtit, 2014, fq.9).

Periudha për implementimin e Strategjisë është tre vjet, nga viti 2015 deri në vitin 2018. Komuna e Vrapçishtit ka përgjegjësinë primare për implementimin e dhe monitorimin e Strategjisë dhe Planit aksional. Komuna, gjithashtu, ka përgjegjësinë për vlerësimin periodik të progresit në implementimin e Strategjisë, në formë të raporteve nga monitorimi. Këto raporte i dorëzohen Këshillit të Komunës.

Në këtë kontekst, Strategjia pike së pari merret me forcimin e kapaciteteve ekzistuese si dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja për pjesëmarrje aktive dhe të drejtpërdrejtë të qytetarëve në zhvillimin e bashkëpunimit multikulturor në Komunë.

Një nga prioritetet strategjike ishte përmirësimi i kapaciteteve të KMNB Vrapçisht. Planit aksional i Strategjisë parashikon disa aktivitete për zgjidhjen e këtij aspekti:

☞ Zhvillimi i kapaciteteve të KMNB Vrapçisht nëpërmjet sigurimit të trajnimeve, përkrah-



jes profesionale, mbështetjes financiare dhe mbështetjes plotësuese organizative (hapësira, pajisje, etj.);

- ☞ Formimi i një komisioni komunal multietnik, për ndjekjen dhe koordinimin e implementimit të Strategjisë;
- ☞ Trajnimi i administratës komunale për promovimin e mirëkuptimit multikulturor (Komuna e Vrapçishtit, 2014).

Strategjia, gjithashtu, siguron një varg ngjarjesh të përbashkëta kulturore dhe sportive, që do t'i afrojnë qytetarët me prapavije të ndryshme etnike:

- ☞ Organizimi i një festivali vjetor kulturave të ndryshme etnike, me pjesëmarrje aktive të qytetarëve nga të gjitha bashkësitë lokale, si dhe me pjesëmarrës dhe artiste nga komunitetet tjera ;
- ☞ Aprovimi i programit të rregullt vjetor për vizitë të institucioneve kulturore dhe historike për të rinjtë, me qëllim mësimin e yakoneve të kulturave të ndryshme;
- ☞ Organizim i ngjarjeve të rregullta humanitare (1-2 në vit ), në baza multietnike;
- ☞ Mbajtja e një festivali vjetor për prezantim të kuzhinës tradicionale të bashkësive të ndryshme etnike (Komuna e Vrapçishtit, 2014).

Barrierat gjuhësore më së shpeshti nënvizohen si një nga arsyet për interaskionin e ulët të anëtarëve të përkatësive të ndryshme etnike. Si rezultat i kësaj, Plani aksional i Strategjisë parashikon aktivitete për tejkalimin e kësaj çështjeje:

- ☞ Zhvillimi i një gazete komunale në tre gjuhë (maqedonisht, shqip, turqisht) në version të shtypur dhe online ;
- ☞ Organizimi i kurseve të rregullta në gjuhën shqipe, gjuhën turke dhe gjuhën maqedonase, për fëmijë;
- ☞ Futja e lëndëve zgjedhore për mësim të gjuhëve të bashkësive etnike në shkollë (Komuna e Vrapçishtit, 2014).
- ☞ Aktivitetet vijuese në sferën e arsimit, u plotësuan me disa iniciativa plotësuese në Planin aksional:
- ☞ Organizimi i më së paku tre (në vit) garave komunale ndërmjet shkollave dhe nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike;
- ☞ Organizimi i ekskursioneve të rregullta multietnike;
- ☞ Organizimi i së paku katër (në vit) ekskursioneve njëditore multietnike;
- ☞ Organizimi i të paktën dy (në vit) aktivitete ekologjike multietnike (Komuna e Vrapçishtit, 2014).

Me qëllim të krijimit të kushteve më të volitshme dhe mundësive për lidhjen e të rinjve me përkatësi të ndryshme etnike, Plani aksional parasheh disa aktivitete sportive:

- ☞ Zhvillimi i një turniri vjetor multietnik në futboll;

- ☞ Organizimi i një gare vjetore në çiklizëm;
- ☞ Organizimi i turnireve sportive ndërmjet shkollave (Komuna e Vrapçishtit, 2014).

Implementimi i iniciativave të parapara në Strategjinë është në vijim.

Duke pasur parasysh faktin se një pjesë e madhe e përcaktimeve strategjike në sferën e arsimit janë harmonizuar me aksionet dhe projektet paralele, aktivitetet e parashikuara realizohen pa ndonjë problem të madh në shkollat e komunës së Vrapçishtit.

Megjithatë, aktivitetet lidhur me zhvillimin e kapaciteteve të KMNB Vrapçisht vihet në pikëpyetje, për shkak të mungesës së mjeteve. Kjo gjithashtu ka të bëjë me disa segmente në Strategji. Një pjesë e aktiviteteve implementohen, siç janë ngjarjet sportive të përbashkëta dhe festivalet, megjithatë, implementimi i aktiviteteve tjera (sigurimi i kurseve falas për mësim të gjuhëve lokale, ekskursioneve) është i penguar.

### **Konstatimet e aktorëve relevantë**

Konstatimet e sigurara nga intervistat përkatëse dhe pjesëmarrësit në debate vënë në dukje se, parimisht, marrëdhëniet ndëretnike në komunë konsiderohen si të volitshme, pa tensione apo incidente etnike viteve të fundit. Të gjithë të anketuarit përmendën shembuj pozitiv të komunikimit dhe bashkëpunimit në mes të qytetarëve në sfera të ndryshme të jetës shoqërore (në vendin e punës, kremtim i përbashkëta i festave sekulare dhe fetare, shënimi i përbashkëta i ngjarjeve të rëndësishme jetësore - lindje, dasma, etj). Megjithatë, ashtu si në rastin me të anketuarit tjerë nga komunat tjera, kishte një prirje të konsiderueshme për tu theksuar rëndësia e përpjekjeve të grupeve të veta etnike për ruajtjen e marrëdhënieve të qeta ndëretnike, ndërsa bartet përgjegjësia për segregacion të bashkësive tjera etnike.

SHF “Vrapçisht” u veçua si një shembull pozitiv për zbatimin e konceptit të arsimit të integruar, në të cilën mësimi zhvillohet në tri gjuhë - maqedonisht, shqip dhe turqisht. Nxënësit ndjekin mësimin në të njëjtat hapësira dhe në turne të përziera. Të gjitha shkollat në këtë komunë janë pjesë e projektit të MASH-it për arsim të integruar. Aktivitetet jashtëmësimore, siç janë ngjarjet sportive dhe kremtimi i festave të rëndësishme, manifestimet kulturore organizohen me pjesëmarrje të nxënësve të të gjitha grupeve etnike. Megjithatë, të anketuarit kanë bërë me dije se ka mungesë të mjeteve financiare për realizimin e aktiviteteve tjera të parapara në projektin për arsim të integruar.

KMNB Vrapçisht i mban aktivitetet e veta, edhe pse janë të penguar nga mungesa e mjeteve komunale për realizimin e të gjitha iniciativave të parapara në Strategji. KMNB miraton programe operative vjetore, megjithatë, nga komuna nuk janë ndarë mjete të posaçme për realizimin e aktiviteteve të parapara në Strategji dhe në Planin aksional për mirëkuptim multikulturor. Të gjitha aktivitetet në nivel komunal realizohen nga ana e shkollave.

Të anketuarit e ngritën çështjen e mungesës së mjeteve për një përkushtim më radikal të autoriteteve komunale në lidhje me realizimin e qëllimeve të Strategjisë për mirëkuptim multikulturor. Një nga konkluzionet kryesore të të anketuarve dhe debateve është se patjetër të ndërtohen mekanizma të reja për mbështetje financiare të realizimit të qëllimeve të Strategjisë, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe sektorit civil.

### 3.3 Komuna e Gostivarit



Komuna e Gostivarit gjendet në pjesën perëndimore të vendit, në pjesën e epërme të Fushës së Pollogut. Gostivari është komunë urbane që kap një territor prej 518.79 km<sup>2</sup>, ose 2.9% të territorit të vendit. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2002, komuna e Gostivarit ka 81.041 banorë me përkatësi të ndryshme etnike: 66.6% janë shqiptarë, 19.5% janë maqedonas, 9.8% janë turq, 3.8% janë romë dhe të tjerë (Enti Shtetëror i Statistikave, 2005).

Përveç disa përjashtimeve, marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Gostivarit vlerësohen si stabile. Ekziston një shkallë e kënaqshme e tolerancës dhe e bashkëjetesës. Para vitit 2013, komuna nuk kishte aktivitete konkrete në drejtim të forcimit të dialogut ndëretnik dhe mirëkuptimit ndërkulturor. Megjithatë, bashkëpunimi ndërmjet organeve të vetëqeverisjes lokale dhe shoqërisë civile dhe sektorit të arsimit është në një nivel të kënaqshëm. Organet e pushtetit lokal gjithashtu mbajnë bashkëpunim të rregullt me komunitetet fetare dhe partitë politike që janë aktive në këtë komunë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në nivel lokal është formimi i Këshillit Rinor të Komunës në korrik të vitit 2013. Këshilli Rinor punon në disa sfera: kulturë, sportit, shëndet publik, marrëdhënie me publikun, projekte, etj. (Komuna e Gostivarit, 2014).

Komisioni për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive në komunën e Gostivarit është themeluar në vitin 2008. Komisioni përbëhet prej shtatë anëtarëve. Statuti i Komunës së Gostivarit pengon që anëtarët e Këshillit të Komunës të jenë edhe anëtarë të KMNB-ve njëkohësisht. Në të kaluarën, KMNB lokal ka vendosur kryesisht mbi çështje lidhur me riemërtimin e rrugëve dhe bashkëpunimin me komuna tjera.

Nuk ka informacione nëse anëtarët e Komisionit kanë marrë pjesë në trajnime për forcimin e kapaciteteve të tyre në sferën e dialogut ndëretnik dhe mirëkuptimit, përveç në trajnime të organizuara nga ADI.

Një nga mangësitë në funksionimin e KMNB-ve lokale sipas analizave paraprake lidhet me faktin se qytetarët, si dhe përfaqësuesit e institucioneve relevante lokale, aspak nuk janë të vetëdijshëm për rolin dhe mandatin e KMNB, dhe në këtë mënyrë kapacitetet e tij nuk janë tërësisht të shfrytëzuara.

Ekzistojnë dhjetë shkolla fillore dhe tre shkolla të mesme në komunën e Gostivarit Orët mësimore mbahen në gjuhën shqipe, maqedonase dhe turke, por nxënësit ndjekin mësimin në turne të ndryshme. Gati se në të gjitha shkollat stafi mësimdhënës dhe administrativ përbëhet prej pjesëtarësh të komuniteteve të ndryshme etnike. Sfera e arsimit shihet si një ndër faktorët kyç për ndërtimin e marrëdhënieve pozitive ndëretnike në komunitet.

Shumica e shkollave fillore dhe të mesme në komunë marrin pjesë në projekte për arsim të integruar, duke përfshirë edhe projektet e implementuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe USAID (Komuna e Gostivarit, 2014). Aktivitetet e projekteve mundësojnë aktivitete të përbashkëta mësimore dhe jashtëmësimore për nxënësit e të gjitha grupeve etnike. Prej viti 2014, në shkollën fillore “Goce Dellçev” është pjesë e rrjetit të shkollave të Qendrës për Dialog Nansen, e cila implementon Modelin Nansen për arsim të integruar. Në periudhën tetor-nëntor 2015, prindërit e nxënësve të regjistruar në këtë shkollë morën pjesë në aktivitetet të përbashkëta, si pjesë e modelit Nansen për arsim të integruar (Realizimi i programit për bashkëpunim me prindërit, 2015). Shkolla e mesme komunale, gjithashtu merr pjesë në Projektin për arsim paqësor, të mbështetur nga Megjashi.

Organizatrat qytetare përfaqësojnë një fuqi motorike për përkrahjen e zhvillimit të marrëdhënieve ndëretnike dhe për zhvillimin e dialogut ndërkulturor në komunë. Megjithatë, duke marrë parasysh resurset e limituara në dispozicion të OQ-ve lokale, përpjekjet e tyre në këtë sferë janë prishur dukshëm. Aktivitetet për afrimin e grupeve të ndryshme etnike organizohen në mënyrë periodike dhe nuk ekzistojnë programe që parashikojnë aktivitete të planifikuara sistematike në këtë sferë (Komuna e Gostivarit, 2014).

OQ-të lokale kanë vendosur bashkëpunim të mirë me KMNB Gostivarit, si dhe me Këshillin e Komunës. Aktivitetet e tyre rregullisht publikohen në mediat lokale. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është se përfaqësuesit e OQ-ve lokale kanë qenë në trajnime për çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndëretnike.

## Strategjia për zhvillimin e dialogut multikulturor

Me qëllim të lehtësimit të bashkëjetesës ndëretnike dhe zhvillimit të demokracisë multikulturore, në vitin 2013 Komuna e Gostivarit ka marrë pjesë në projektin “Përmirësimi i mirëkuptimit ndërkulturor në komunat ndëretnike në Maqedoni”, i implementuar nga ADI, me mbështetje financiare të Ambasadës britanike në Shkup. Si rezultat i aktiviteteve të projektit, në vitin 2014, Këshilli i Komunës së Gostivarit miratoi Strategjinë për zhvillimin e dialogut multikulturor (2014-2017). Qëllim i përgjithshëm i Strategjisë është “kontribut drejt vlerave të rrënjësura lokale për tolerancën dhe bashkëjetesën bazuar në respektin e ndërsjellë të diversiteteve etnike, kulturore dhe religjioze në komunën e Gostivarit” (Komuna e Gostivarit, 2014, fq. 6).

## Qëllimet specifike të Strategjisë kanë të bëjnë me:

1. “Sinqeritet dhe transparencë të administratës komunale për publikun, para së gjithash nëpërmjet një Komisioni për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, funksional dhe proaktiv;
2. Sistem i integruar arsimor përmes të cilit do të promovohet toleranca dhe bashkëjetesa;
3. Qasje e organizuar për ngritjen e vetëdijes tek i gjithë komuniteti për rëndësinë dhe nevojën për dialog ndërkulturor” (Komuna e Gostivarit, 2014, fq. 7-8).
4. Korniza kohore për implementimin e Strategjisë është tre vite, në periudhën 1 korrik



2014 deri më 30 qershor 2017.

KMNB lokal dhe sektori i arsimit, pikësëpari janë përgjegjës për implementimin e Planit aksional. Implementimi i Strategjisë duhet të monitorohet përmes sigurimit të raporteve periodike vjetore në emër të KMNB-së dhe nëpunësit përgjegjës komunal. Raportet parashtrohen deri te këshilli lokal komunal. Raportet janë të dedikuara që të mundësojnë këqyrje në procesin e implementimit të Strategjisë, probleme të mundshme që mund ta pengojnë implementimin e saj, si dhe dhënien e rekomandimeve për zgjidhjen e tyre (Komuna e Gostivarit, 2014).

Pas vitit të dytë të implementimit të Strategjisë, KMNB si dhe nëpunësi përgjegjës komunal, së bashku me palët tjera të interesuara relevante (përfaqësuesit e OQ-ve lokale, administrata komunale, sektorin arsimor dhe atë të biznesit, etj.) janë përgjegjës për hartimin e një plani për evaluimin e implementimit të Strategjisë. Evaluimi duhet të realizohet nga ekspertë të pavarur. Rezultatet nga vlerësimi duhet të përmbajnë një analizë të implementimit, informacione për qëllimet e arritura dhe rekomandimet për ndryshime dhe adaptime të Strategjisë dhe Planit aksional me situatën dhe nevojat (Komuna e Gostivarit, 2014).

Komuna e Gostivarit dhe KMNB e kanë përgjegjësi kryesore për koordinimin dhe implementim të Strategjisë. Këto institucione, po ashtu janë përgjegjëse për evaluimin dhe monitorimin vjetor të procesit të implementimit (Komuna e Gostivarit, 2014).

Procesi i ndërtimit të një vetëqeverisjeje lokale transparente, e cila promovon bashkëjetesë dhe duhet të kontribuojë për bashkëpunim interkulturor duhet të arrihet përmes këtyre aktiviteteve:

- ☞ Ndryshimi i Statutit të Komunës së Gostivarit, si dhe zgjerimi i përbërjes së KMNB Gostivar ;
- ☞ Takime të rregullta ndërmjet kryetarit të Këshillit të Komunës dhe anëtarëve të KMNB-së;
- ☞ Hartimi dhe miratimi i programit operativ të KMNB-së;
- ☞ Organizimi i trajnimeve për dialog multikulturor për anëtarët e KMNB dhe administratën komunale;
- ☞ Vizita dhe shkëmbim të përvojave me komunat tjera;
- ☞ Përmirësimi i ueb-faqes së komunës, që të lehtësohet dhe përmirësohet komunikimi ndërmjet qytetarëve dhe komunës;
- ☞ Takime të rregullta ndërmjet anëtarëve të KMNB dhe qytetarëve (Komuna e Gostivarit, 2014).

Zhvillimi i një sistemi të integruar arsimor duhet të lehtësohet me:

- ☞ Futja e gjuhëve të bashkësive tjera etnike;
- ☞ Futja e elementeve multikulturore në disa lëndë shkollore: art, histori dhe letërsi;
- ☞ Orë të përbashkëta të artit, historisë dhe letërsisë;
- ☞ Pjesëmarrje e përbashkët në projekte nga sfera e multikulturalizmit;
- ☞ Formimi i ekipeve të përziera sportive dhe organizimi i ngjarjeve sportive;
- ☞ Formimi i klubeve të përziera kulturore dhe organizimi i manifestimeve kulturore;

- ☞ Organizimi i punëtorive për bashkëpunim ndërkulturor mes nxënësve;
- ☞ Ekskursionë të përbashkëta;
- ☞ Gara të përbashkëta;
- ☞ Përgatitja dhe publikimi i revistave elektronike shkollore;
- ☞ Mbledhje të përbashkëta të këshillave të shkollës, këshillave të prindërve dhe kuadrit arsimor;
- ☞ Organizimi i ngjarjeve të përbashkëta, sidomos në mjediset rurale;
- ☞ Organizimi i kurseve të gjuhës për të rritur, për mësim të gjuhës së komunitetit tjetër etnik;
- ☞ Formimi i klubeve të përziera sportive;
- ☞ Formimi i klubi të përzier kulturor;
- ☞ Organizimi i ngjarjeve sportive
- ☞ Organizimi i mbrëmjeve të përbashkëta letrare “Ardhmëria”;
- ☞ Krijimi i platformës së OQ-ve për zhvillimin e kohabitacionit multikulturor në komunë;
- ☞ Sigurimi i mbështetjes financiare për OQ-të lokale të cilat punojnë në promovimin e multikulturalizmit;
- ☞ Përkrahje për mediat lokale multikulturore;
- ☞ Përgatitja e video materialeve për avancimin e tolerancës ndëretnike (Komuna e Gostivarit, 2014).

Autoritetet komunale janë në proces të realizimit të qëllimeve të strategjike, sidomos në sferën e arsimit. Edhe krahas disa reformave në lidhje me punën e KMNB Gostivarit, mbetet të zbatohen disa përcaktime strategjike. Pjesa dërmuese e aktiviteteve që janë implementuar deri më tani, janë të lidhura me organizimin manifestimeve sportive dhe kulturore. Në këtë kontekst, resurset e limituara financiare në njëfarë mënyre e pengojnë realizimin e aktiviteteve me dinamikën e paraparë.

### Konstatimet e aktorëve relevantë

Në përgjithësi, të gjithë të anketuarit i vlerësojnë marrëdhëniet ndëretnike si stabile, me disa incidente të vogla të izoluara. Edhe krahas faktit se marrëdhëniet ndëretnike në komunë janë dukshëm stabile, pjesëmarrësit theksuan se ka hapësirë për përmirësimin e tyre, duke pasur parasysh se anomiziteti ndërmjet grupeve të ndryshme etnike perceptohet se është në rritje në periudhën e shkuar. Numri i shqiptarëve të rinj që nuk e flasin gjuhën maqedonase rritet me secilën gjeneratë dhe nuk ka interes të maqedonasit për mundësinë e mësimin të gjuhës të ndonjë grupi tjetër etnik. Po ashtu, kur të rinjtë ndjejnë se aktivitetet e përbashkëta dhe iniciativat tjera u janë imponuar, këto iniciativa ballafaqohen me një rezistencë të madhe .

Një nga çështjet për të cilat të gjithë të anketuarit pajtohen është nevoja për t'i motivuar qytetarët që ta mësojnë gjuhën e grupit tjetër etnik. U theksua nevoja për projekte me të cilat do organizoheshin orë falas për gjuhë. Një aspekt pozitiv është se të anketuarit e kanë kuptuar rëndësinë e krijimit të bashkëjetesës ndëretnike që nga moshën e re. Në këtë kontekst, shkolla e mesme medicinale u veçua si një shembull pozitiv, si dhe kopshti i fëmijëve që punon si pjesë e programit Mozaik.



Megjithatë, për sa i përket reformave rrjedhëse në sferën e arsimit vlen të theksohet se është e rëndësishme marrja e vendimeve me konsensus të komunitetit, pasi që jo të gjithë prindërit pajtohen me masat e ndërmarra si pjesë e udhëzimeve për arsimin e integruar (integrimi në kopshtet e fëmijëve, për shembull). Shprehja e rezervës tek prindërit mund të jetë një faktor pengese për arritjen e qëllimeve.

Shkolla fillore “Goce Dellçev” është pjesë programit të Qendrës për Dialog Nansen dhe tregon rezultate pozitive në fushën e integrimit ndëretnik. Shkollat tjera, edhe pse formalisht multietnike, kanë turne të ndara etnikisht, me nxënës, pa mundësi për komunikim. Vetëm shkollat e mesme kanë turne të përziera etnikisht.

Edhe krahas disa aktiviteteve të përbashkëta (kremtimeve, manifestimeve kulturore) palët e targetuara u pajtuan se ndarja është e pranishme, e cila po bëhet gjithnjë më e evidente me kalimin e viteve. Ndonëse të gjitha shkollat në komunë kanë marrë pjesë në projektin për arsim të integruar, aktivitetet e ndërmarra, nuk kanë pasur ndikim të madh mbi zvogëlimin e segregacionit dhe distancës sociale ndërmjet nxënësve. Me përjashtim të shkollës fillore “Goce Dellçev” dhe disa të tjerave, shkollat ose janë njëgjuhësore, ose kanë orë për nxënësit e grupeve të ndryshme etnike në turne dhe hapësira të ndryshme.

Organizohen aktivitete jashtëmësimore, por komunikimi në mes të nxënësve nuk vazhdon jashtë mureve të shkollës. Organizohen orë të përbashkëta, por komunikimi është problematik për shkak të mungesës së njohjes së gjuhës së komuniteteve tjera etnike. Ashtu si në rastin e komunave tjera pjesëmarrëse në këtë projekt, komunikimi dhe bashkëpunimi në sferën publike më prezente janë në mesin e të rriturve, ndërsa të rinjtë mbeten në distancë. Kontaktet ekzistuese, përsëri, janë të limituara në sferën publike, ndërsa në sferën private qytetarët edhe më tutje lidhen me grupet etnike respektive.

Shkollat në komunë morën ndihë nga vetëqeverisja lokale për implementimin e aktiviteteve nga projekti arsimit të integruar, por resurset e tyre mbeten të limituara. Ekziston bashkëpunim ndërmjet shkollave, dhe ata kanë marrë pjesë në disa aktivitete me qëllim të përmirësimit të mirëkuptimit multikulturor ndërmjet nxënësve (projekte që implementohen nga Qendra për Dialog Nansen; USAID-i, Avokati i popullit për fëmijët, etj.). Aktivitetet jashtëmësimore janë të limituara vetëm në organizimin e ngjarjeve sportive dhe kulturore. Shkolla fillore “Goce Dellçev”, si pjesë e programit Nansen, organizon orë mësimore të përbashkëta për nxënësit me përkatësi të ndryshme etnike për arsim qytetar, art, etj. Megjithatë, shumë prej të anketuarve theksuan nevojën për gjetjen e mekanizmave për një përfshirje më të madhe të prindërve në këto aktivitete, me qëllim të sigurimit të përkrahjes së nevojshme të aktiviteteve.

KMNB e Gostivarit është përfshirë në implementimin e Planit aksional për mirëkuptim multikulturor, i miratuar nga Këshilli i Komunës. Deri tani KMNB është kyçur në organizimin e turneut në futboll dhe manifestimit kulturor Gostfest. Anëtarët e Komisionit, së bashku me pjesëtarët e administratës komunale, kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga ADI. Në lidhje me çështjet tjera të mandatit të vet, KMNB nuk është shumë aktiv.

Marrë në përgjithësi, palët e interesuara vënë në dukje ndikimin e partive politike në përqesimin e marrëdhënieve ndëretnike në komunë. Tensionet ndëretnike konsiderohen si më të theksuara gjatë periudhës zgjedhore, gjë që vë në dukje se vija kryesore e ndarjes politike ndërmjet qytetarëve - në parti politike të ndara në vijë etnike, krijon një situatë ku interesat dhe kërkesat e tyre të shpeshta të përbashkëta/të ndara janë në anët e kundërta të betejës politike. Në parim, të gjithë pjesëmarrësit kanë tendencë që të theksohet kontributi i grupit të tyre etnik për ruajtjen e marrëdhënieve të qeta ndëretnike në komunitet, dhe qëndrimi se ndarja mbështetet dhe forcohet nga anëtarët e grupeve tjera etnike.



### 3.4 Komuna e Jagunovcës



Komuna e Jegunovcës gjendet në pjesën verilindore të luginës së Pollogut, kap një territor prej 174 km<sup>2</sup>. Komuna e Jegunovcës përbëhet prej 17 bashkësive. Jegunovca është komunë rurale me 10.790 banorë sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2002, prej të cilëve 55.26% janë maqedonas, 43.11% janë shqiptarë, 1% serbë dhe 0.31% janë romë.

Në periudhën deri më 2013 Komuna e Jagunovcës nuk ka miratuar qasje strategjike për promovimin e dialogut ndëretnik dhe mirëkuptimit ndërkulturor. Ka pasur disa përpjekje sporadike, nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike në sistemin arsimor, si dhe organizimin e ngjarjeve sportive dhe kulturore për përmirësimin e bashkëjetesës ndëretnike në mes të qytetarëve të komunës. Këshilli i Komunës përbëhet prej 15 anëtarësh, të cilët bashkëpunojnë me qytetarët në çështjet me interes publik përmes takimeve direkte (Komuna e Jegunovcës, 2014). Parimi i vendimmarrjes së përbashkët njëlloj është respektuar, pjesërisht në lidhje me çështjet që janë me interes të anëtarëve të grupeve të ndryshme etnike që jetojnë në këtë komunë.

Komisioni për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive (KMNB) i komunës së Jegunovcës është themeluar në vitin 2013. KMNB lokal përbëhet prej pesë anëtarësh, prej të cilëve të gjithë janë anëtarë të Këshillit të Komunës, dhe kryetari i Komisionit i përket grupit etnik shqiptar. KMNB Jegunovcë deri më tani nuk ka zhvilluar Plan operativ, megjithatë, anëtarët janë konsultuar për çështje që lidhen me bashkëjetesën ndëretnike dhe mirëkuptimin ndërkulturor, dhe rekomandimet dhe mendimet e tyre janë marrë parasysh në procesin e vendimmarrjes (Komuna e Jegunovcës, 2014). Doemos të theksohet se shpenzimet operative të KMNB Jagunovcë sigurohen prej buxhetit komunal, duke i përfshirë edhe shpenzimet për pjesëmarrje në trajnime. Megjithatë, mundësitë e limituara financiare të komunës nuk lejojnë zhvillim të plotë të kapaciteteve të këtij trupi (Komuna e Jegunovcës, 2014).

Ekzistojnë tri shkolla fillore dhe një shkollë e mesme e disperzuar (si pjesë e shkollës së mesme “Mosha Pijade” në Tetovë), me një numër të madh të nxënësve që vazhdojnë shkollimin e tyre në shkollat e komunave fqinje. Në fakt, pas konfliktit të armatosur të vitit 2001, fëmijët maqedonas nga fshati Shemshovë janë transferuar në shkollat e fshatit Zhilçe.

Një shembull pozitiv i arsimit të integruar është shkolla fillore “Fridtjof Nansen” në fshatin Prelubishtë, që është mbështetur nga Qendra e Dialogut Nansen dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Gjenerata e parë e nxënësve ka përfunduar arsimin në vitin shkollor 2012/2013. Në këtë shkollë, nxënësit maqedonas dhe shqiptarë kanë aktivitete jashtëmësimore: art, të mësuarit e kulturave tjera, ekskursione shkollore dhe të ngjashme, ndërsa ka dhe aktivitete për prindërit dhe arsimtarët, sipas modelit Nansen për arsim të integruar (Komuna e Jegunovcës, 2014).

KMNB Jegunovcës është trupi kryesor lokal që duhet të kontribuojë në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe dialogut në komunë. Ka pasur rekomandime për zgjerimin e përbërjes së këshillit me anëtarë të jashtëm. Përfshirja e anëtarëve të komunitetit në punën e KMNB lokal pritet të kontribuojë në zgjerimin e perspektivave dhe sigurimit të informacioneve direkte për nevojat aktuale dhe urgjente të qytetarëve në komunë. Për tu përmbushur këto qëllime nevojiten ndryshimet statutare, në pjesën që ka të bëjë me përbërjen dhe mandatin e KMNB (Komuna e Jegunovcës, 2014).

Një rekomandim tjetër lidhet me forcimin e rolit të KMNB Jegunovcë me miratimin e Programit Operativ, që do të definojë aktivitetet minimale dhe dinamikën operative të Komisionit. Për këtë qëllim, siguri i mjeteve financiare për realizimin e Programit operativ të KMNB është theksuar si domosdoshmëri për pavarësisë dhe proaktivitetit të tij për çështje me rëndësi për dialogun ndërkulturor dhe bashkëpunimin në mes të komuniteteve të ndryshme etnike në Komunë (Komuna e Jegunovcës, 2014).

Një nga sfidat kryesore për zhvillimin e bashkëjetesës ndëretnike në komunë, tolerancën dhe multikulturalizmin është zhvillimi i zgjidhjeve për orët mësimore të përbashkëta në të njëjtat hapësira apo turne shkollore. Këshilli i Komunës ka marrë iniciativë të bisedojë mbi tema që lidhen me zgjidhjen e kësaj çështjeje, së bashku me këshillat e shkollave dhe këshillat e prindërve. Një sërë punëtorish janë paraparë për të kuptuar përparësitë dhe risqet nga reformat e këtyra, ndërsa konform kësaj të merren vendimet e mëtejshme.

## **Strategjia për zhvillimin e dialogut multikulturor**

Procesi i zhvillimit të bashkëjetesës ndëretnike dhe demokracisë multikulturore vazhdoi me pjesëmarrjen e Komunës së Jegunovcës në Projektin për përmirësimin e mirëkuptimit ndërkulturor në komunat multi-etnike në Maqedoni, i implementuar nga ADI, me mbështetje financiare të Ambasadës britanike në Shkup. Pjesëmarrja në projekt rezultoi me miratimin e Strategjisë për zhvillimin e dialogut multikulturof (2014-2017) në vitin 2014. Qëllimi kryesor i Strategjisë është “kontributi për shoqëri tolerante bazuar në respektimin e ndërsjellë të diversiteteve etnike, kulturore dhe fetare në Jegunovcë (Komuna e Jegunovcës, 2014, fq. 6).

## **Qëllimet specifike të Strategjisë kanë të bëjnë me:**

1. “Sinqeritetin dhe transparencën e administratës komunale ndaj publikut, nëpërmjet Komisionit funksionale dhe proaktiv për marrëdhënie ndërmjet bashkësive;
2. Sistemin e integruar arsimor që promovon bashkëjetesë dhe tolerancë;
3. Qasjen e organizuar për ngritjen e vetëdijes publike të gjithë komuniteti mbi rëndësinë dhe nevojën për dialog ndërkulturor” (Komuna e Jegunovcës, 2014, fq. 7).

Korniza kohore për implementimin e Strategjisë është tre vite, në periudhën prej 1 korrikut 2014 deri më 30 qershor 2017 (Komuna e Jegunovcës, 2014).

KMNB Jegunovcë dhe Sektori për punë juridike të përgjithshme kanë përgjegjësi primare për implementimin e Planit aksional të Strategjisë. Implementimi i Strategjisë duhet të përcillet përmes raporteve vjetore periodike, të dorëzuara nga ana e KMNB-së dhe sektorit përgjegjës komunal



deri te Këshilli i Komunës. Raportet duhet të sigurojnë informacione për rrjedhën e implementimit të Strategjisë dhe Planit, si dhe identifikimin e çështjeve të cilat do të mund ta çrrënjisin ndikimin e Strategjisë, si dhe rekomandime për tejkalimin e tyre (Komuna e Jegunovcës, 2014).

Pas vitit të dytë të implementimit të Strategjisë, KMNB Jegunovcë dhe sektori përgjegjës komunal, në konsultim me përfaqësues të sektorit civile, sektorit të arsimit dhe biznesit, si dhe përfaqësues të organeve komunale, duhet të sigurojë plan për evaluimin e procesit të implementimit të Strategjisë dhe Planit Aksional. Evaluimi do të duhet të bëhet nga ana e ekspertëve të pavarur. Rezultatet e vlerësimit duhet të përmbajnë një analizë të implementimit, informacione mbi qëllimet e arritura dhe rekomandimet për ndryshime dhe adaptime të Strategjisë dhe Planit aksional me situatatën dhe nevojat aktuale (Komuna e Jegunovcës, 2014).

Procesi i ndërtimit të një vetëqeverisjeje lokale transparente, me çka do promovohet bashkëjetesa dhe kontributi për bashkëpunimin ndërkulturor duhet të zbatohet përmes aktiviteteve në vijim:

- ☞ Ndryshime statutores dhe zgjerimi i numrit të anëtarëve të KMNB Jegunovcë me anëtarë të jashtëm;
- ☞ Mbledhje të rregullta ndërmjet kryetarit të Këshillit të Komunës dhe anëtarëve të KMNB;
- ☞ Përgatitja e Programit operativit të KMNB;
- ☞ Organizimi i trajnimeve për dialog multikulturor për anëtarët e KMNB dhe administratës komunale;
- ☞ Vizita dhe shkëmbime të përvojave me komunat tjera;
- ☞ Përgatitja dhe miratimi i programit operativ të KMNB;
- ☞ Përmirësimi i ueb faqes së komunës, për të lehtësuar komunikim më të mirë në mes të qytetarëve dhe komunës;
- ☞ Takime të rregullta në mes të anëtarëve të KMNB dhe qytetarëve (Komuna e Jegunovcës, 2014).

Zhvillimi i një sistemi të integruar arsimor duhet të lehtësohet me:

- ☞ Futjen e gjuhëve të bashkësive tjera etnike;
- ☞ Futja e elementeve multikulturore në disa lëndë shkollore: art, histori dhe letërsi;
- ☞ Orë të përbashkëta të artit, historisë dhe letërsisë;
- ☞ Mbajtja e orëve në hapësira dhe turne të njëjta;
- ☞ Formimi i ekipeve të përziera sportive dhe organizimi i ngjarjeve sportive;
- ☞ Formimi i klubeve të përziera kulturore dhe organizimi i ngjarjeve kulturore;
- ☞ Organizimi i punëtorive për bashkëpunim ndërkulturor mes nxënësve;
- ☞ Ekskursione të përbashkëta;
- ☞ Gara të përbashkëta;
- ☞ Mbledhje të përbashkëta të këshillave të shkollës, këshillave të prindërve dhe kuadrit mësimdhënës;

- ☞ Organizimi i ngjarjeve të përbashkëta për anëtarët e këshillave të shkollës, këshillave të prindërve dhe arsimitarëve;
- ☞ Organizimi i ngjarjeve të përbashkëta, panairove tradicionale;
- ☞ Organizimi i kurseve gjuhësore për të rritur, për mësimin e gjuhës të bashkësisë tjetër etnike;
- ☞ Formimi i klubeve të përziera sportive;
- ☞ Forimi i klubeve të përziera kulturore;
- ☞ Organizimi i ngjarjeve sportive;
- ☞ Sigurimi i mbështetjes financiare të OQ lokale të cilat punojnë në promovimin e multi-kulturalizmit (Komuna e Jegunovcës, 2014).

Për dallim nga iniciativat për aktivitete të përbashkëta arsimore, Strategjia parashikon organizimin e aktiviteteve të përbashkëta mësimore dhe jashtëmësimore në shkolla. Vëmendje e veçantë fokusohet tek aktivitetet e përbashkëta jashtëmësimore sportive dhe kulturore. Një nga rezultatet e parapara ishte themelimi i klubeve të përbashkëta sportive dhe ansambleve të përbashkëta kulturore, të përbëra prej nxënësish maqedonas dhe shqiptarë. Përmes trajnimeve dhe praktikave pritet të lehtësohet dhe përmirësohet interaksioni ndërmjet nxënësve të grupeve të ndryshme etnike. Faqja e internetit të Komunës gjithashtu pësoi disa ndryshime. Funksionet e reja u mundësojnë vizitorëve që të vendosin kontakt me organe të ndryshme komunale. Por, prapëseprapë, ky funksion nuk mundëson kontakt me KMNB komunal. Pjesëmarrja e të rinjve në proceset e vendimmarrjes në nivel komunal u lehtësua nëpërmjet formimit të Këshillit rinor.

### **Konstatimet e aktorëve relevantë**

Konstatimet e palëve të interesuara relevante tregojnë se marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Jegunovcës janë stabile dhe se ekziston një traditë e respektit ndërmjet anëtarëve të komuniteteve të ndryshme etnike. Ekziston një bashkëpunim, megjithatë, ky bashkëpunim është i limituar vetëm për çështje të interesit direkt të qytetarëve. Të anketuarit theksojnë se, megjithatë, një ndër problemet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndëretnike është i lidhur me transferimin e tensioneve ndëretnike nga politika në jetën e përditshme të qytetarëve. Potencialet e pazhvilluara ekonomike, po ashtu u theksuan nga ana e përfaqësuesve të sektorit të biznesit. Gjegjësisht, u vu në dukje se përqindja e madhe e papunësisë tek të rinjtë, nuk kontribuon në përmirësimin e bashkëjetesës ndëretnike. Gjithashtu, u përmend se rritja e standardit jetësor të qytetarëve do të kontribuojë në përmirësimin e këtyre marrëdhënieve. Përfaqësuesit e sektorit të biznesit theksuan se njëra nga mënyrat më të mira për tejkalimin e këtyre barrierave kulturore është në vendin e punës, ku këto dallime kanë pak ose aspak nuk kanë vlerë. Të anketuarit cekin disa shembuj pozitiv në Komunën e Jegunovcës, ku maqedonasit dhe shqiptarët punojnë së bashku dhe kanë bashkëpunim produktiv.

Gjithashtu u vu në dukje se ekziston një shkallë e distancës sociale në mes të anëtarëve të grupeve të ndryshme etnike në këtë komunë. Bashkëpunimi në mes të qytetarëve ekziston, por prapëseprapë duhet të zhvillohet edhe më tej. Një doze skepticizmi ndaj realizimit të projekteve që kanë të bëjnë me përkrahjen e multikulturalizmit, po ashtu u theksua, në lidhje me shqetësimet se iniciativat e këtilla ballafaqohen me barriera të pakapërcyeshme në tejkalimin e influencës politike mbi marrëdhëniet e përditshme në mes të qytetarëve. Krahës kësaj, disa probleme u ngritën në lidhje me kontaktet e rralla në mes të të rinjve. Disa të anketuar kanë vënë në dukje se aktivitetet për afrim të ndërsjellë të nxënësve në organizimin e komunës dhe sektorit civil, nuk i japin rezultatet dëshiruara, sepse të rinjtë i përjetojnë si të imponuara.



Të anketuarit pretendojnë se nevoja për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta (ngjarje sportive, ngjarje kulturore) ku qytetarët prejardhje të ndryshme etnike mund të njoftohen me njëri tjetrin, të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë. Këto ngjarje janë të rralla, edhe krahas përpjekjeve të organeve të komunës që të tejkalohen kufizimet financiare. Si edhe në rastet me komunat tjera të cilat marrin pjesë në këtë projekt, mjetet e disponueshme të kufizuara financiare për afrim të ndërsjellë të nxënësve për organizim të ngjarjeve të këtilla, implikon se këto aktivitete dhe mbajtja e tyre janë të varura në masë të madhe nga mbështetja e donatorëve.

Megjithatë, komuna e përkrahu organizatën në disa aktivitete, siç janë sigurimi i mbështetjes financiare të klubeve lokale të futbollit, ku lojtarët janë të komuniteteve të ndryshme etnike. Këto klube, fatkeqësisht, i shkurtojnë aktivitetet e tyre. Gjithashtu ka iniciativë edhe për formimin e Këshillit rinor, me qëllim të një përfshirje më të madhe të të rinjve në komunë në proceset e vendimmarrjes në komunitetet e tyre. Edhe përkaj faktit që MNB Jegunovcë dhe Komuna e Jegunovcës implementuan reforma të parapara në Strategjinë dhe Planin aksional, janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme për të promovuar dukshmërinë e tyre, si një partner i qytetarëve në komunë. Buxheti i vogël komunal kontribuon për këtë situatë, duke i limituar mundësitë e KMN B Jegunovcë për realizimin e aktiviteteve. Gjithashtu, ekziston nevoja për më shumë takime direkte me qytetarët dhe anëtarët e KMN B. Anëtarët e KMN B Jegunovcë kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara nga ADI dhe QMBN. Komuna bën përpjekje që të balancohet shpërndarja e mjeteve komunale për të gjitha komunitetet.

Segregacioni nëpër shkolla vazhdon. Shkollat multietnike punojnë në objekte të ndara edhe nëpër shkollat lokale. Përfaqësuesit e sferës së arsimit nënvizojnë se ekzistojnë mundësi të shumta për klasë të integruara, dhe se arsimtarët janë të përgatitur dhe të interesuar për pjesëmarrje në klasë të këtilla, por ka mungesë të përkrahjes financiare për të realizuar këto aktiviteteve.

Në sferën e arsimit, të anketuarit theksuan se implementimi i konceptit për arsim të integruar ballafaqohet me disa sfida. Domethënë, edhe pse stafi arsimor ka bashkëpunim të mirë, ka pak komunikim në mes të nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike. Ndarja vazhdon në disa nga shkollat në Komunë, e cila është e reflektuar në një distancë të madhe sociale në mes të rinjve. Edhe pse nominalisht, disa shkolla u përmbahen parimeve të arsimit të integruar, situata është ndryshe në praktikë. Për shembull, në shkollën fillore "Simçe Nastovski" orët mësimore mbahen në dy gjuhë - maqedonisht dhe shqip, megjithatë, hapësirat janë të disperzuara në gjashtë lokacione të ndryshme me nxënës të grupeve të ndryshme etnike, në këtë mënyrë ata edhe më tutje rrinë të ndarë. Edhe pse ka aktivitete të përbashkëta ndërmjet nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike, komunikimi i tyre është i limituar vetëm në këto aktivitete dhe shqetësimi ishte se kjo mund të ketë pasojë negative mbi marrëdhëniet ndërmjet bashkësive në nivel lokal edhe në të ardhmen. Nxënësit komunikojnë deri në shkallën e ngjarjeve të përbashkëta që organizohen për ta. Aktualisht, kjo kryesisht është e limituar në ngjarje sportive dhe të anketuarit kanë shprehur nevojën për më shumë ngjarje të tilla në të ardhmen. Një shembull pozitiv është ngritja e një gazete shkollore multietnike në Shkollën fillore "Simçe Nasteovski".

Integrimi në sferën e arsimit solli disa rezultate pozitive, të cilat prapëseprapë, nuk janë plotësisht të kënaqshme, pasi që mosnjohja e gjuhës së etnikumeve tjera dëshmon se është faktori kryesor për pengimin e integrimit ndëretnik. Nxënësit maqedonas, kanë vetëm lëndë mësimore zgjedhore si një mundësi për të mësuar gjuhën e grupeve tjera etnike (nuk ekziston obligimi ligjor), dhe një numër i vogël i nxënësve morën pjesë në ato orë.

Futja e lëndëve për mësimin e gjuhës të grupit tjetër etnik ballafaqohet me pengesa, sidomos tek nxënësit maqedonas. Përfaqësuesit e sektorit arsimor theksuan se ka një bashkëpunim në mes të shkollave, por ky bashkëpunim është i limituar dhe periodik dhe se duhet të zhvillohet më tutje.



Mbledhjet e arsimtarëve, si dhe të këshillave të shkollës dhe këshillave të prindërve organizohen dhe mbahen bashkërisht; nxënësit kanë disa orë të përbashkëta, marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta jashtëmësimore, kremtime të përbashkëta dhe ngjarje tjera. Megjithatë këto ngjarje organizohen vetëm here pas here, dhe pak kontribuojnë në thellimin e marrëdhënieve ndërmjet nxënësve. Mungesa e mjeteve financiare për organizimin e ngjarje të këtilla, gjithashtu janë cekur si faktorë për pengim.

Nuk ka vullnet politik për përparimin e integritetit ndëretnik. Komuna nuk ka kurse të gjuhëve për të rriturit. Ekzistojnë disa aktivitete jashtëmësimore të organizuara për nxënësit, por ato bëhen gjithnjë më të rralla shkaku i mungesës së mjeteve në emër të shkollave dhe autoriteteve komunale. Pushteti qendror nuk përcakton mjete adekuate për implementimin e aktiviteteve të integruara.

Shumë të anketuar kanë bërë me dije se edhe krahas që dalin nga MKO, ato akoma nuk e marrin parasysh se gjuha shqipe është gjuhë për përdorim zyrtar. Shumë projekte të filluara janë sjellë nga jashtë dhe qytetarët i konsiderojnë si të imponuara.

### 3.4 Komuna e Kërçovës



Komuna e Kërçovës gjendet në pjesën perëndimore të vendit, në luginën e Kërçovës. Komuna përbëhet prej vendbanimeve urbane dhe rurale me 30.138 banorë, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2002. Komuna është multietnike, me 53% maqedonas, 30% shqiptarë, 8% turq, 5% romë dhe rreth 4% serbë, vllëh dhe të tjerë (Enti Shtetëror i Statistikave, 2005). Megjithatë, në vitin 2013 territori komunal u ndryshua, dhe vendbanimet Zajaz, Drugovë, Vraneshticë dhe Oslomej u inkorporuan në Komunën e Kërçovës. Kjo e ndryshoi përbërjen etnike të komunës, e cila pas reformave ka 56.739 banorë, 54% prej të cilëve janë shqiptarë, 35% janë maqedonas, 5% janë turq, 2% janë romë dhe 2% janë serbë, vllëh, boshnjakë etj. Një veçori tjetër e komunës së Kërçovës është segregacioni hapësinor mes komuniteteve të ndryshme etnike, gjë që çon deri në rritjen e distancës sociale.

Deri në vitin 2013, komuna nuk kishte qasje sistematike për avancimin e bashkëjetesës ndëretnike dhe mirëkuptimit ndëretnik, për dallim nga bashkëpunimi i iniciativave të ngjashme në emër të sektorit joqeveritar. Komuna ka takime të rregullta të drejtpërdrejta me qytetarët dhe organizon hulumtime të herëpashershme të opinionit publik. Është vërejtur se përfaqësuesit e sektorit civil rregullisht konsultohen në mbledhjet e Këshillit të Komunës dhe komisioneve. Edhe krahas ndarjes hapësinore, u vu në dukje se qytetarët kanë traditë të bashkëpunimit dhe bashkëjetesës ndëretnike (Komuna e Kërçovës, 2014).

Komisioni për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive në Kërçovë u formua në vitin 2006. KMNB përbëhet prej 6 anëtarëve, nga një prej secilit komunitet etnik në komunë, të cilët më shpesh janë anëtarë të jashtëm, ndërsa pjesa tjetër e Komisionit përbëhet nga anëtarë të Këshillit të Komunës. U vërejt se KMNB Kërçovë mban komunikim të rregullt me qytetarët. Anëtarët e KMNB marrin pjesë në trajnime të ndryshme të organizuara në kuadër të disa projekteve, me qëllim të forcimit të kapaciteteve të KMNB (Komuna e Kërçovës, 2014).

Disa OQ kanë realizuar aktivitete për forcimin e kapaciteteve të organeve të komunës, duke përfshirë edhe KMNB të Kërçovës, për përparimin e dialogut ndëretnik, si dhe përmirësimin e bashkëpunimit të tyre me qytetarët dhe institucionet tjera. Aktivitetet kryesore të KMNB të Kërçovës lidhen me problemet në sistemin arsimor, si dhe konfliktet e të rinjve në shkolla. (Komuna e Kërçovës, 2014).

Megjithatë, duke pasur parasysh kornizën aktuale ligjore e cila e rregullon punën dhe funksionimin e KMNB në një definicion të gjerë, është fakt i cili e pengon në një masë të konsiderueshme funksionimin efikas të KMNB në ballafaqimin me çështje nga mandate i tyre. Raporti mbi situatën me marrëdhëniet ndëretnike në gjashtë komunat (përfshirë edhe Kërçovën) gjithashtu e thekson nevojën për një përfshirje më të madhe të anëtarëve të jashtëm në KMNB, anëtarë të cilët respektohen nga të gjitha bashkësitë etnike në komunë, si dhe persona të cilët në asnjë mënyrë nuk janë të kyçur në punën e organeve të komunës, me çka do të sigurohet KMNB-ja me pavarësinë e nevojshme dhe rezistencën ndaj presioneve politike. Gjithashtu, ekziston nevoja për hartimin dhe miratimin e Planit Aksional të KMNB, i cili do t'i definojë qëllimet dhe aktivitetet e KMNB-së, me fokus të përfshirjes më të madhe dhe bashkëpunimit me përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë që jetojnë në këtë komunë, si dhe përfshirja aktive e tyre në procesin e punës dhe vendimmarrjes në nivel të komunës (Komuna e Kërçovës, 2014).

Raporti, gjithashtu, thekson nevojën për rritjen e bashkëpunimit të KMNB dhe sektorit civil në sferën e përmirësimit të dialogut ndëretnik dhe ndërkulturor, si dhe planifikimin dhe veprimin në bashkëpunim më të ngushtë me organizatat fetare dhe subjekte politike. Përfundimisht, në raport nënvizohet nevoja për trajnim të specializuar për anëtarët e KMNB-së, me qëllim të rritjes së kapaciteteve të tyre për të punuar në përmirësimin dhe rritjen e kualitetit të punës së Komisionit. Për këtë qëllim, nevojitet mbështetje nga ekspertë, sidomos nga sektori civil, të cilët do të bashkëpunojnë me KMNB, përmes trajnimeve, seminareve dhe punëtorive për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të anëtarëve të Komisionit (Naskova, Mehmeti & Imeri, 2013).

Një shembull pozitiv për implementim të suksesshëm të iniciativave për integrim ndëretnik është arsimi: Për shembull, në shkollën fillore "Sande Shterjovski" orët mbahen në tri gjuhë (maqedonisht, shqip dhe turqisht) në hapësira të përbashkëta dhe turne të njejtë. Kjo shkollë është pjesë e projektit për arsim të integruar që e implementon Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe USAID. Kuadri arsimor i shkollës në mënyrë aktive merr pjesë dhe organizon aktivitete të ndryshme mësimore dhe jashtëmësimore për nxënësit me përkatësi të ndryshme etnike. Ata, gjithashtu, marrin pjesë rregullisht në trajnime, me qëllim që t'i zhvillojnë shkathtësitë e tyre. Këto aktivitete sigurojnë mbështetje për avancimin e tyre profesional, që është një motiv shtesë për përfshirjen e tyre (Komuna e Kërçovës, 2014). Edhe një shembull tjetër pozitiv paraqet kopshti i fëmijëve „Ollga Micevska“, ku që nga viti 2013 fëmijët kanë mundësi të jenë pjesë e grupit parashkollor dygjuhësor (maqedonisht dhe shqip), që jep mundësinë për arsim të integruar që nga mosha e hershme. Megjithatë, raporti i ADI-t tregon që akoma ekzistojnë sfida në bashkëjetesën multikulturore në komunën e Kërçovës. Një nga sfidat kryesore që është i lidhur me sferën arsimore, respektivisht me nevojën për arsim më kualitativ të integruar, i merr parasysh dallimet kulturore dhe etnike dhe promovon mirëkuptimin multikulturor dhe mendimin kritik, si dhe kualitetin e aktiviteteve multikulturore për nxënësit. Për këtë qëllim, është e nevojshme që të institucionalizohen këto aktivitete të integruara, që të bëhen pjesë e rregullt e procesit arsimor, me qëllim që të lehtësohet një efikasitet më i mirë në implementimin e tyre dhe përfshirje më aktive e stafit mësimor. (Komuna e Kërçovës, 2014).

Një praktikë pozitive lidhet me Programin për trashëgimi botërore të UNESCO-s në duart e të rinjve, i implementuar në emër të Qendrës për arsim profesional dhe trajnim, si orë të lira për nxënësit/mësimdhënësit në shkollat profesionale. Kjo praktikë mund të sigurojë aktivitete të rregullta të përbashkëta, dhe në të njëjtën kohë pjesëmarrësit do të lirohen nga varësia e donatorëve të jashtëm dhe projektet dhe sponsorimet e tyre. Po ashtu, janë të nevojshme projekte më kualitative dhe më afatgjate për tu përballur me esencën e problemeve në sferën e arsimit, si dhe të ofrohen masa konkrete dhe aktive për zgjidhjen e tyre.



## Strategjia për zhvillimin e dialogut multikulturor

Procesi i zhvillimit të bashkëjetesë ndëretnike dhe demokracisë multikulturore vazhdoi me pjesëmarrjen e Komunës së Kërçovës në projektin “Përmirësimi i mirëkuptimit ndërkulturor në komunat multi-etnike në Maqedoni”, implementuar nga ADI, me mbështetje financiare të Ambasadës së Britanisë në Shkup. Pjesëmarrja në projekt rezultoi me miratimin e Strategjisë për zhvillimin e mirëkuptimit multikulturor (2014-2017) në vitin 2014. Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë ishte “përforcimi dhe promovimi i mirëkuptimit ndërkulturor në komunën e Kërçovës, përmes promovimit të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërkulturor mes qytetarëve të cilët u përkasin komuniteteve të ndryshme” (Komuna e Kërçovës, 2014, fq.12).

### Qëllimet specifike të Strategjisë kanë të bëjnë me:

1. Promovimin e interaksionit ndërkulturor përmes inkurajimit për të mësuar gjuhën e komunitetit;
2. Organizimi i ngjarjeve të rregullta të përbashkëta kulturore dhe aktivitete në drejtim të promovimit të mirëkuptimit ndërkulturor mes qytetarëve të komuniteteve të ndryshme etnike;
3. Përforcimin e komunikimit ndëretnik dhe ndërkulturor ndërmjet nxënësve të komuniteteve të ndryshme përmes aktiviteteve të integruara mësimore dhe jashtëmësimore;
4. Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta multi-etnike dhe multikulturore të rregullta sportive
5. Përmirësimin e kapaciteteve ekzistuese institucionale dhe zhvillimin e tyre të mëtutjeshëm, me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të komuniteteve të ndryshme etnike, me çka do të nxitet bashkëpunimi dhe interaksioni ndëretnik” (Komuna e Kërçovës, 2014, fq.12-13).

Periudha e implementimit të Strategjisë është tre vjet, nga viti 2015 deri në vitin 2018.

Komuna e Kërçovës ka përgjegjësi primare për koordinimin dhe monitorimin e implementimit të Strategjisë dhe Planit aksional. Komuna ka për obligim të dorëzojë raporte të rregullta për progresin e implementimit të Strategjisë dhe aktiviteteve të parapara. Raportet nga monitoringu do të dorëzohen në Këshillin e Komunës (Komuna e Kërçovës, 2014).

Aktivitetet të cilat janë planifikuar të realizohen në periudhën e paraparë kanë të bëjnë me:

- ☞ Organizimin e kurseve falas për të rritur dhe fëmijë dhe trajnimeve në gjuhët e komuniteteve etnike në komunë;
- ☞ Organizimi i aktiviteteve të rregullta (debate, kuize, mini kampanja) të cilat promovojnë mësimin e gjuhës së të tjerëve (Komuna e Kërçovës, 2014).
- ☞ Strategjia, gjithashtu, siguroi një sërë ngjarjesh të përbashkëta kulturore dhe sportive, të cilat do t'i bashkojnë qytetarët me prejardhje të ndryshme etnike;
- ☞ Organizimi i aktiviteteve të rregullta kulturore-folklorike të cilat e lehtësojnë bash-

këpunimin mes komuniteteve të ndryshme etnike;

- ☞ Organizimin i festivalit vjetor që e feston diversitetin;
- ☞ Krijimi dhe promovimi i gazetës lokale të bashkësive etnike në Kërçovë, me tema në fushën e kulturës dhe jetës komunale;
- ☞ Sigurimi i granteve të vogla për organizatat qytetare lokale për promovimin e aktiviteteve multikulturore në përbërje të përzier (Komuna e Kërçovës, 2014).
- ☞ Aktivitetet vijuese në sferën e arsimit, u plotësuan me disa iniciativa plotësuese në Planin aksional:
- ☞ Organizimi i ekskursioneve të përbashkëta;
- ☞ Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta mësimore;
- ☞ Organizimi i garave në lëndë të caktuara mësimore ndërmjet komuniteteve;
- ☞ Gara diturie për ekipe të përziera;
- ☞ Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta jashtëmësimore, me pjesëmarrje të prindërve;
- ☞ Promovimi medial i debateve lidhur me arsimin e integruar (Komuna e Kërçovës, 2014).

☞

Edhe krahas një përparimi të caktuar në zbatimin e përcaktimeve strategjike, analiza e e procesit të implementimit tregon se duhet të bëhen më shumë përpjekje për të siguruar ndikim pozitiv në marrëdhëniet ndëretnike në komunë. Përveç aktiviteteve në sferën e arsimit, të cilat zbatohen vazhdimisht, aktivitetet tjera janë më të rralla. Reformat e filluara në punën e KMNb Kërçovë, kanë kontribuar në disa përmirësime në punën e tyre, por janë të nevojshme përpjekje të mëtutjeshme, sidomos në aspekt të transparencës së aktiviteteve të veta në komunë.

### Konstatimet e aktorëve relevantë

Parimisht, të anketuarit dhe pjesëmarrësit në debat theksuan se marrëdhëniet ndëretnike në komunë janë stabile, pa incidente të mëdha viteve të fundit. Megjithatë, ka hapësirë për përmirësim, sidomos sa i përket mungesës së mirëbesimit midis pjesëtarëve të grupeve të ndryshme etnike. Gjegjësisht, qytetarët bashkëpunojnë dhe komunikojnë në vendin e punës dhe në segmente tjera të sferës publike, por komunikimi në sferën private është i kufizuar. Edhe njëherë, ky komunikim është i kufizuar në mënyrë plotësuese ndërmjet të rinjve, ndërsa palët e tanguara shprehën shqetësim sa i përket ndikimit negativ që kjo situatë mund të ketë në afat të gjatë. Në vend të kësaj, papritur, dallimet fetare konsiderohen që pengon shkallën e zhvillimit të marrëdhënieve më të afërta në sferën private.

Në lidhje me përpjekjet e autoriteteve lokale për promovimin e mirëkuptimit multikulturore, është cekur se pushteti komunal bën përpjekje për tu organizuar më shumë ngjarje të përbashkëta dhe mbështetje të projekteve, që kanë për qëllim përmirësimin e komunikimit interkulturore dhe bashkëjetesës ndëretnike ndërmjet qytetarëve. Njëri nga aktivitetet e fundit kishte të bënte me organizimin e manifestimit “Ditët e hapura për multikulturalizëm” në bashkëpunim me grupin joformal „VrediT da si od Kiçevo/Ia vlen të jesh prej Kërçove”. Defileja folklorike dhe promovimi i kuzhinës tradicionale të bashkësive të ndryshme etnike në Kërçovë, janë një pjesë e aktiviteteve. Gjithashtu, qeverisja komunale bën përpjekje për të siguruar mbështetje financiare për klubet sportive të të gjitha komuniteteve etnike.

KMNb Kërçovë përbëhet prej 6 anëtarësh, çdonjëri prej tyre përfaqëson njërin komunitet etnik që



jeton në këtë komunë. Kryetari i Komisionit është vllah - pjesëtar i komunitetit më të vogël në këtë komunë. Anëtarët e KMNB Kërçovë kanë marrë pjesë në trajnime të shumta të organizuara nga OSBE, ADI dhe Ambasada Britanike në Republikën e Maqedonisë. Të gjitha vendimet e Komisionit merren me konsensus, ndërsa aktivitetet bazohen në programet operative vjetore, të cilat janë parashtruar dhe janë miratuar nga Këshilli Komunal. Anëtarët e komisionit mbajnë mbledhje të rregullta (10-15 mbledhje në vit). Përfaqësues të OSBE-së kanë marrë pjesë në disa mbledhje. Përdërisa në të kaluarën, KMNB Kërçovë nuk ishte shumë aktiv, sot anëtarët e këtij organi janë të përfshirë në mënyrë aktive në planifikimin e buxhetit komunal. Një nga të arriturat e KMNB Kërçovë ka të bëjë me parashtrimin e rekomandimit (i cili është miratua) për lëshimin e dokumenteve për status martesor edhe në gjuhën e bashkësive etnike që jetojnë në këtë komunë. Rekomandimet tjera përfshijnë ndarjen e mjeteve të veçanta për nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve më të vogla etnike, si dhe futjen e gjuhës turke si gjuhë zyrtare në këtë komunë.

Sa i përket situatës në sistemin arsimor, të gjithë nxënësit ndjekin mësim në të njëjtat hapësira në shkollën e mesme komunale. Të gjitha shkollat komunale marrin pjesë në projektin për arsim të integruar, implementuar nga MASH-i dhe USAID-i. Disa nga shkollat, siç është shembulli me shkollën fillore "Sande Shterjoski", janë shpërblyer për angazhimin e tyre të jashtëzakonshëm në realizimin e konceptit për arsim të integruar.

Autoritetet komunale mbajnë bashkëpunimin me sektorin e shoqërisë civile, dhe bëjnë përpjekje për të siguruar mbështetje për organizimin e projekteve lidhur me multikulturalizmin. Ata, gjithashtu, sigurojnë mbështetje për realizimin e aktiviteteve dhe ngjarjeve për komunitetet etnike më të vogla në këtë komunë. Krahas faktit se ekzistojnë disa aktivitete për promovimin e multikulturalizmit në nivel komunal, të anketuarit kanë theksuar se janë të nevojshme përpjekje plotësuese për të siguruar përfshirje më të madhe të qytetarëve në hartimin dhe implementimin e këtyre aktiviteteve, gjë që mund të rezultojë me ndikim më të madh të iniciativave të ndërmarra. Një nga faktorët e jashtëm që përmendet si i rëndësishëm për mbajtjen e distancës sociale të qytetarët është ndërhyrja politike në çështje të cilat kanë të bëjnë me bashkëjetesën ndëretnike. Si rezultat i një ndërhyrjeje të tillë është progresi i ulët në rritjen e numrit të qytetarëve që komunikojnë në gjuhët e grupeve tjera etnike. Barrierat gjuhësore janë bërë shumë të rëndësishme sa i përket distancës sociale në rritje midis të rinjve në këtë komunë. Një aspekt tjetër që u përmend si i rëndësishëm është krijimi i mundësive për qytetarët që të diskutojnë dhe t'i tejkalojnë çështjet që lidhen më të kaluarën e largët të përbashkët (për shembull, shënimi i ngjarjeve historike që janë shkak për manifestim për njërin komunitet, ndërsa konsiderohen si ofenduese për anëtarët e bashkësisë tjetër etnike).



### 3.6 Komuna e Tetovës



Komuna e Tetovës gjendet në pjesën veriperëndimore të vendit, në rajonin e Pollogut. Komuna e Tetovës përbëhet prej vendbanimeve urbane dhe rurale. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2002, struktura etnike e popullatës është si në vijim : 70% shqiptarë, 22% maqedonas, 2.2% turq, 2.7% romë, 0.02% vllleh, 0.7% serbë, 0.2% boshnjakë dhe 0.75% të tjerë (Enti Shtetëror i Statistikave, 2005).

Ekzistojnë 20 vendbanime në këtë komunë, me 12 shkolla qendrore fillore, 9 shkolla periferike fillore, 1 shkollë e muzikës dhe 5 shkolla të mesme. Dy institucione të arsimit sipëror, po ashtu gjenden në Komunën e Tetovës – Universiteti Shtetëror i Tetovës dhe Universiteti i Evropës Juglindore. Orët në këto institucione mbahen në tri gjuhë - shqip, maqedonisht dhe anglisht.

Përpos faktit se komuna e Tetovës deri në vitin 2013 nuk kishte program të veçantë për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike, ajo kishte bashkëpunim me organizatat lokale joqeveritare, sektorin e arsimit; si dhe kishte formuar fond për mbështetjen e projekteve individuale të iniciuara nga organizata të ndryshme dhe donatorë.

Komisioni për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive i Komunës së Tetovës është formuar në vitin 2006. KMNB përbëhet prej 6 anëtarësh, prej të cilëve dy gra, të cilat gjithashtu ishin anëtare të jashtme. KMNB Tetovë mban takime të rregullta me qytetarët e komunës, me qëllim që të përmirësojë punën e vet në komunitet. Konkluzionet komunikohen nëpërmjet tabelës së shpalljeve, në media dhe në ueb-sajtin e Komunës. Gjatë mandatit, KMNB Tetovë ka intervenuar mbi çështje në lidhje me riemërtimin e rrugëve dhe vendosjen e partneritetit dhe bashkëpunimit me komuna tjera (Komuna e Tetovës , 2014).

Në Raportin e ADI-t të vitit 2013, janë identifikuar disa mangësi në funksionimin e KMNB Tetovë. Në masë të madhe funksionimi i KMNB-së mundëson situata për KMNB-në të transformohet në një hapësirë të debateve të pafundme për çështje të cilat nuk janë në mënyrë direkte të lidhura me mandatin e Komisionit, që çon deri në mospërfilljen e çështjeve të rëndësishme. Kjo, në njëfarë mënyre, e pengon Komisionin të veprojë si një mekanizëm për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes , dhe se si të vihet deri në zgjidhje të çështjeve me rëndësi kyçe (Naskova, Mehmeti & Imeri, 2013).

Raporti, gjithashtu, konkludon se Komisioni është i përbërë prej anëtarësh me interesa të ndryshëm dhe me shkallë të ndryshme të kompetencave. Po ashtu, ekziston edhe nevoja që të precizohen detyrat dhe aktivitetet e KMNB-së nëpërmjet dokumenteve strategjike dhe programore për rregullimin e punës së përditshme të KMNB-së. Gjithashtu ekziston nevoja edhe për trajnim të specializuar për anëtarët e Komisionit, që mund të realizohet edhe me një përfaqësim më të madh të sektorit civil (Naskova, Mehmeti & Imeri, 2013).

Në raport theksohet nevoja për organizimin e takimeve të rregullta me palët e interesuara (autoritetet lokale, OJQ-të lokale, sektori i biznesit, sektori i arsimit, mediat lokale, organizatat fetare etj.) me qëllim të krijimit të mundësive më të mira për bashkëpunim për çështjet që janë në mandat të KMNb-së . Takime të tilla u organizuan, dhe KMNb Tetovë vendosi linjë telefonike falas për kontakte me qytetarët . Megjithatë, interesi i qytetarëve ishte i vogël (Peçijareski, 2013).

Në komunën e Tetovës ka 12 shkolla fillore qendrore , 9 shkolla periferike fillore, 1 shkollë shtetërore të muzikës, 5 shkolla të mesme dhe 2 institucione të arsimit sipëror. Në pothuajse të institucionet arsimore mësimi zhvillohet në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke, duke ndjekur konceptin e arsimit të integruar, me kuadër arsimor të përkatësisë të ndryshme etnike (Komuna e Tetovës, 2014).

Duhet theksuar se në Komunën e Tetovës , sfera e arsimit konsiderohet si një nga faktorët kyç për përmirësimin dhe avancimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe mirëkuptimit ndërkulturor, si dhe për krijimin e atmosferës së tolerancës dhe bashkëpunimit në mes të bashkësive të ndryshme etnike. Disa projekte lidhur me arsimin e integruar janë implementuar në këtë komunë. Aktivitete të ndryshme zbatohen si rezultat i këtyre iniciativave, për shembull, ekspozitë e përbashkët e veshjeve tradicionale dhe ekskursionet dhe kremtime të përbashkëta. ShF “Istikball” dhe ShF “Liria” kanë marrë pjesë në projekte të tilla. Shkolla e mesme teknike në komunën e Tetovës mban bashkëpunime me shkollat e mesme të Strumicës, përsëri si pjesë e aktiviteteve të projektit. Shkolla fillore “Liria” është gjithashtu pjesë e modelit Nansen të Projektit për arsim të integruar. Si pjesë e aktiviteteve të projektit në periudhën tetor-nëntor 2015, prindërit e nxënësve të regjistruar në ShF “Liria” kanë marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta (Realizimi i programit për bashkëpunim me prindërit, 2015).

Si një shembull karakteristik është shkolla e mesme medicinale, që është shembull i përpjekjeve konsistente për implementimin e modelit të arsimit të integruar. Orët mbahen në tri gjuhë, me nxënës me prejardhje të ndryshme etnike dhe ata ndjekin mësimin në turne të përziera etnike. Të gjitha njoftimet shtrohen në tri gjuhë, ekziston Unioni i nxënësve, i cili kryetarin e ka shqiptar, zëvendëskryetari është maqedonas, dhe një turk si sekretar. Shkolla publikon buletin mujor në tri gjuhë. Shkolla, gjithashtu, organizon drekë multikulturore me kuzhinë tradicionale , ku nxënësit kanë mundësi të njihen me kuzhinën e bashkësive tjera. (Komuna e Tetovës, 2014).

Në sferën e kulturës, komuna organizon dhe inicion ngjarje të përbashkëta kulturore , si një nga mënyrë më efikase për tejkalimin e barrierave ndërkulturore, lehtësimin e njohjes së të tjerëve dhe zhvillimin e mirëkuptimit multikulturor ndërmjet komuniteteve të ndryshme. Ndërsa një varg ngjarjesh të tilla u mbështetën në kuadër të Verës kulturore të Tetovës në vitin 2013. Kremtime të përbashkëta të festave të ndryshme, për shembull festimi i Vitit të Ri organizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së përbashkët të artistëve dhe performuesve të grupeve të ndryshme etnike. Praktikat e këtylla pozitive mund të kontribuojnë në krijimin e një komuniteti autentik multikulturor, ku ekziston integrimi në vend të segregacionit (Komuna e Tetovës, 2014).

Organet komunale kanë vendosur bashkëpunim me sektorin civil për implementim të projekteve të ndryshme për promovimin e multikulturalizmit dhe tolerancës ndëretnike dhe bashkëpunimit (Komuna e Tetovës, 2014).

Megjithatë, raporti i ADI vë në dukje disa sfida të vazhdueshme për multikulturalizmin dhe mirëkuptimin ndërkulturor dhe bashkëjetesën në komunën e Tetovës. Në raport ceket nevoja për aftësim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshme për trajnime të specializuara të anëtarëve të organeve komunale, KMNb-së, kuadrit mësimdhënës, me qëllim të përgatitjes më të mirë të tyre për ndërhyrje me rastin e situatave konfliktuale, për identifikimin e tyre të hershëm, parashikime



dhe parandalime. Po ashtu, janë të nevojshme trajnime për favoret nga multikulturalizmi edhe për prindërit, me qëllim që t'i forcojnë kapacitetet e tyre për të vepruar për përmirësimin e bashkëjetesës ndërkulturore (Naskova,, Mehmeti, & Imeri, 2013).

Në raportin, gjithashtu, theksohet se potencialet për jetesë të përbashkët më të gjerë dhe më kualitative interkulturore, nuk janë plotësisht të shfrytëzuara. Në këtë kontekst, theksohet nevoja për një numër të madh të aktiviteteve të përbashkëta, në të cilat pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme do të zhvillojnë marrëdhënie më të afërta, aktivitete më të shpeshta shkollore mësimore dhe jashtëmësimore për nxënësit, ekskursione të përbashkëta, vizita të përbashkëta të objekteve kulturore dhe fetare, aktivitete për mësim të gjuhëve të komuniteteve tjera, etj. Raporti, po ashtu, e thekson për nevojën e zgjerimit dhe forcimit të bashkëpunimit me sektorin civil, që përveç disa shembujve pozitivë, jo tërësisht i shfrytëzon potencialet e iniciativave për zhvillim të multikulturalizmit. Përfundimisht, shembuj pozitiv në institucionet arsimore duhet të zhvillohen dhe të mbahen, dhe praktikata e tilla të barten në të gjitha shkollat e komunës për implementimin të konceptit të arsim të integruar, për zhvillimin e gjeneratave të të rinjve, të cilët janë të njoftuar me vlerat e jetës multikulturore, ku pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme jetojnë krahë për krah me njëri tjetrin, e jo njëri pranë tjetrit (Naskova, Mehmeti, & Imeri, 2013).

## Strategjia për zhvillimin e dialogut multikulturor

Procesi i zhvillimit të bashkëjetesës ndëretnike dhe demokracisë multikulturore vazhdon me pjesëmarrjen e Komunës së Tetovës në projektin “Përmirësimi i mirëkuptimit ndërkulturor në komunat multietnike në Maqedoni”, i implemtuar nga ADI, me mbështetje financiare të Ambasadës së Britanisë në Shkup. Pjesëmarrja në këtë projekt rezultoi me miratimin e Strategjisë për zhvillimin e mirëkuptimit multikulturor (2014-2017) në vitin 2014. Objektivi kryesor i Strategjisë është “përmirësimi i jetës autentike multietnike në komunën e Tetovës, përmes nxitjes së mirëkuptimit ndërkulturor ndërmjet qytetarëve të cilët u përkasin komuniteteve të ndryshme” (Komuna e Tetovës, 2014, fq. 13).

## Qëllimet specifike kanë të bëjnë me:

1. “Realizimin e aktiviteteve të rregullta, zgjedhore dhe të vazhdueshme bashkërisht të organizuara dhe të realizuara, me qëllim të mësimin të gjuhëve të komuniteteve ;
2. Krijimi i aktiviteteve të rregullta kulturore multietnike, të orientuara drejt nxitjes së komunikimit dhe mirëkuptimit ndërkulturor, të organizuara bashkërisht e që mundësojnë pjesëmarrje të konsiderueshme të qytetarëve;
3. Përmirësimi i integritetit ndëretnik në arsim, përmes rritjes së numrit aktiviteteve multi-etnike mësimore dhe jashtëmësimore;
4. Instalimi i aktiviteteve sportive të rregullta dhe të vazhdueshme të organizuara bashkërisht, të cilat sigurojnë pjesëmarrje të konsiderueshme të qytetarëve, e sidomos të të rinjve, mbi bazë multietnike;
5. Forcimin e institucioneve ekzistuese dhe krijimin e institucioneve të reja të cilat do të promovojnë vazhdimisht mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërkulturor” (Komuna e Tetovës , 2014, fq. 13).

Periudha për implementimin e Strategjisë është tre vjet , nga viti 2015 deri në vitin 2018.

Komuna e Tetovës së bashku me sektorin civil kanë përgjegjësi të mbikëqyrin procesin e imple-

mentimit të Strategjisë, si dhe efikasitetin e aktiviteteve të parapara, me qëllim të determinimit të progresit të implementimit të tij dhe të ndërhyrjeve në raste të harmonizimeve të domosdoshme. Për këtë qëllim, Komuna është përgjegjëse për sigurimin e planit për ndjekjen e implementimit të Strategjisë .

Aktivitetet të cilat janë parashikuara për tu realizuar në periudhën e paraparë kanë të bëjnë me:

- ☞ Kurse të rregullta falas të gjuhëve për fëmijë dhe të rinj (me theks të veçantë të gjuhët e komuniteteve jo shumicë për fëmijët maqedonas);
- ☞ Organizimi i debateve dhe takimeve për ngritjen e vetëdijes të prindërve maqedonas në nevojën e njohjes së gjuhës së komuniteteve tjera;
- ☞ Organizimi i kurseve falas të gjuhës angleze për të rritur (me theks të veçantë të gjuhët e komuniteteve jo shumicë për maqedonasit);
- ☞ Organizimi i punëtorive për përmirësimin e komunikimit shumëgjuhësor për fëmijët e komuniteteve të ndryshme etnike;
- ☞ Organizimi i orëve zgjedhore të gjuhëve të komuniteteve të ndryshme etnike në shkollat ku ato orë nuk ekzistojnë (Komuna e Tetovës , 2014).
- ☞ Strategjia gjithashtu, siguroi një sere ngjarjesh të përbashkëta kulturore dhe sportive, të cilat do t'i afrojnë qytetarët me prejardhje të ndryshme etnike:
- ☞ Organizimi i panairit të librit për autorë me përkatësi të ndryshme etnike, me ngjarje tjera multietnike;
- ☞ Organizimi i festivalit muzikor vjetor me performues të bashkësive të ndryshme etnike;
- ☞ Organizimi i punëtorive të rregullta për promovimin e mirëkuptimit ndërkulturor në mes të rinjve;
- ☞ Organizimi i festivalit të kuzhinës tradicional të komuniteteve;
- ☞ Organizimi i festivalit vjetor të filmit vjetor, në të cilin filmat lidhen me multikulturalizmin;
- ☞ Produksion i video materialeve (filma dokumentarë, reportazhe) me tema që lidhen me multikulturalizmin nga autorë të rinj lokal;
- ☞ Organizimi i ekspozitave të artistëve lokalë me përkatësi të ndryshme etnike;
- ☞ Organizimi i aktiviteteve për ruajtjen dhe avancimin e lokaliteteve ekzistuese kulturore-historike;
- ☞ Organizimi i turneve sportive me grupe të përziera ;
- ☞ Organizimi i cros-country tradicional, multietnik;
- ☞ Krijimi i ligave shkollore, me ekipeve të përziera ;
- ☞ Organizimi i aktiviteteve të rregullta ekologjike multietnike (Komuna e Tetovës, 2014).

Aktivitetet rrjedhëse në sferën e arsimit, u plotësuan me disa iniciativa shtesë në Planin aksional:

- ☞ Organizimi i orëve të përbashkëta në lëndë të caktuara (gjuhë angleze, informatikë, art)



nëpër shkolla;

- ☞ Organizimi i ekskursioneve të përbashkëta njëditore;
- ☞ Publikimi i një gazete shkollore multietnike, që është kontribut origjinal i nxënësve ;
- ☞ Organizimi i garave të rregullta të diturisë në mes shkollave në komunë ;
- ☞ Organizimi i manifestimit shkollor “Ditët e multikulturalizmit” me pjesëmarrje të përfaqësuesve të institucioneve arsimore, nxënësve dhe prindërve të tyre;
- ☞ Organizimi i klubeve të përbashkëta dhe aktiviteteve tjera jashtëmësimore në shkolla, në bazë të rregullt (Komuna e Tetovës , 2014).

Procesi i ndërtimit të vetëqeverisjes transparente lokale, me të cilën promovohet bashkëjetesa dhe kontributi për bashkëpunim ndërkulturor, duhet të arrihet nëpërmjet aktiviteteve në vijim:

- ☞ Ndryshimi i Statutit të Komunës për rregullim plotësues të funksionimit të KMNB-së;
- ☞ Forcimi i kapaciteteve të KMNB nëpërmjet trajnimeve, asistencës eksperte, mbështetjes financiare dhe përkrahjes plotësuese organizative (hapësira, mjete, etj.);
- ☞ Ngritja e një Komisionit multietnik për implementimin e Strategjisë për promovimin e mirëkuptimit multikulturor, i cili duhet të funksionojë si një trup i përbashkët koordinativ dhe të punojë nën mbikëqyrje të KMNB-së;
- ☞ Përfshirje aktive e organizatave qytetare në aktivitetet për implementimin e Strategjisë;
- ☞ Hapja e një biblioteke të re komunale, me leximore të përbashkët për organizimin e aktiviteteve të rregullta për literalizëm multikulturor;
- ☞ Formimi i një qendre rinore (Komuna e Tetovës, 2014).

Zbatimi i qëllimeve strategjike është në vijim, me dinamikë dhe efikasitet të ndryshëm. Pengesat kryesore për implementimin e aktiviteteve të parashikuara lidhen me mungesën e mjeteve financiare nga autoritetet komunale. KMNB Tetovë organizoi disa mbledhje dhe siguroi rekomandime për zhvillimin e Strategjisë për mirëkuptim multikulturor.

Mungesa e mjeteve komunale, gjithashtu reflektohet mbi mundësitë për pjesëmarrje në trajnime të anëtarëve të KMNB Tetovë dhe administratës komunale.

Të anketuarit vunë në dukje se janë organizuar disa trajnime, por ato janë sporadike dhe iniciativat e organizatave qytetare për këtë çështje janë të rralla. Intervistat me përfaqësuesit e sektorit civil tregojnë se ekzistojnë përpjeke të rralla sistematike për promovimin e multikulturalizmit në komunë.

### Konstatimet e aktorëve relevantë

Të anketuarit kanë vënë në dukje se marrëdhëniet ndërmjet pjesëtarëve të grupeve të ndryshme etnike janë stabile, pa konflikte më të mëdha. Në Tetovë ka një traditë të mirëkuptimit ndëretnik dhe bashkëjetesës, e cila vazhdon të mbahet. Ekziston, megjithatë, nevoja për nxitjen e këtyre vlerave të gjeneratave të reja, të cilët manifestojnë rritje të distancës sociale në vitet e para pas MKO. Komunikimi dhe bashkëpunimi në vendin e punës konsiderohen si shumë të kënaqshme nga të gjithë aktorët e sektorit të biznesit në të gjitha komunat e targetuara. Totava nuk është përjashtim, ndërsa disa nga të anketuarit janë të mendimit se shkalla e lartë e papunësisë është faktori që pengon në zhvillimin e mirëkuptimit multikulturor në tek qytetarët. Si edhe në rastin e komunave

tjera, brengosja ishte në lidhje me influencën e thellë të çështjeve politike mbi jetën e përditshme të qytetarëve, të cilët konsidroheshin se kanë reperkusione negative mbi mirëkuptimin multietnik dhe bashkëjetesën.

Nga ana e palëve të tanguara është theksuar se vendi i punës tregohet si bazë solide për ndërtimin e marrëdhënieve pozitive ndërmjet të pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme etnike. Krahas kësaj, sektori i biznesit konsiderohet si i rëndësishëm për zhvillimin e marrëdhënieve pozitive ndërmjet anëtarëve të komuniteteve të ndryshme, për shkak të mundësisë për krijimin e lidhjeve dhe bashkëpunimit në mes të njerëzve mbi bazën e interesit të përbashkët. Të anketuarit kanë shpalosur nevojën për bashkëpunim më aktiv në mes të sektorit të biznesit dhe institucioneve qeveritare në procesin e zhvillimit të klimës më të favorshme të biznesit në komunë.

Nga konstatime e palëve të interesuara relevante mund të konkludohet se në përgjithësi përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike konsiderohet si një obligim i përbashkët i të gjithë qytetarëve. Pavarësisht situatës stabile dhe mungesës së situatave më të mëdha konfliktuale, të anketuarit kanë vënë në dukje se multikulturalizmi ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm në Komunën e Tetovës. Vërejtjet kryesore kanë të bëjnë me mungesën e njohjes së gjuhës së bashkësive tjera etnike, si dhe mungesën e suksesit të iniciativave në këtë sferë të ndërmarra deri më tani. Disa të anketuar shprehën skepticizëm ndaj kapaciteteve të KMNb për të vepruar mbi çështje që kanë të bëjnë me bashkësitë etnike.

Në lidhje me sektorin e arsimit, koncepti i arsimit të integruar implementohet deri në një shkallë të caktuar. Gjashtë prej 12 shkollave fillore në komunë janë të vëzhguara për zbatimin e konceptit. Megjithatë, segregacioni është i vazhdueshëm jashtë hapësirave shkollore, dhe nxënësit janë në përputhje me modelin e segregacionit të prindërve dhe miqve të tyre. Të anketuarit kanë vënë në pah se një shkallë e mosbesimit dhe pasigurisë është prezent, veçanërisht tek popullata maqedonase. Nëpër shkollat, bashkëpunimi rrjedh nga nevoja, dhe përditërisht kuadri mësimdhënës është gjithnjë më i prirë kah takimet dhe aktivitetet e përbashkëta, nxënësit me përkatësi të ndryshme etnike shumë rrallë komunikojnë jashtë aktiviteteve të cilat janë të organizuara për këtë qëllim.

Një nga shembujt pozitiv është shkolla fillore "Migjeni", ku mësimi zhvillohet në tri gjuhë - maqedonisht, shqipe dhe turqisht, me turne etnikisht të përziera. Shkolla e prezantoi iniciativën e nxënësve-mediatorë, ku nxënësit me përkatësi të ndryshme etnike punojnë bashkë në zgjidhjen e çështjeve të mundshme ndëretnike. Shkolla gjithashtu është një ndër shembujt e rrallë ku nxënësit maqedonas mësojnë gjuhën shqipe, si lëndë zgjedhore. Shkolla merr pjesë në projektin e USAID-it për arsim të integruar, si dhe në aktivitetet për promovimin e multikulturalizmit me çka i përmbahet planit operativ të paraparë me projektin. Shkollat fillore "Migjeni" dhe "Liria" janë pjesë e rrjetit të shkollave për zbatim të Modelit Nansen për arsim të integruar. Aktivitetet kryesore në drejtim të afrimit të nxënësve të grupeve të ndryshme etnike, janë të lidhura me organizimin e ngjarjeve sportive, shënimin e përbashkët të festave të rëndësishme, ekskursione të përbashkëta, etj. Komuna bën përpjekje për të promovuar bashkëjetesën ndëretnike, nëpërmjet organizimit dhe mbështetjes financiare të ngjarjeve të ndryshme, manifestimeve kulturore, ngjarjeve sportive, garave, për çka, siç u cek, mungesës së interesimit nga ana e qytetarëve që të iniciojnë aktivitete të tilla. KMNb Tetovë merr pjesë me propozime për organizimin e ngjarjeve të ndryshme. Deri tash, komuna ka mbështetur organizimin e ngjarjeve kulturore, ndeshjeve futbolistike, garave të ditorisë, si dhe kurse nga gjuha shqipe. Në komunë është vendosur bashkëpunim i mirë me organizatat lokale qytetare, sigurim i mbështetjes për implementim të iniciativave për promovimin e multikulturalizmit. Mungesa e financave u cek si një pengesë për përfshirje më aktive të komunës në aktivitete të tilla. Të gjithë të anketuarit shprehën nevojën për një përfshirje më direkte tëp komunës nëpërmjet aktiviteteve në terren për përmirësimin e mirëkuptimit multikulturor dhe bashkëjetesës në komunë.



Palët e interesuara janë shumë të motivuar për të dhënë mendimin e tyre në lidhje me zhvillimet e fundit në komunë, respektivisht bojkotin e mësimit nga ana e nxënësve Maqedonas të shkollës së mesme “Kiril Pejçinoviç”. KMNB Tetovë mbajti takim për të biseduar mbi situatën aktuale dhe siguroi rekomandime të cilat iu dorëzuan Këshillit të Komunës. Anëtarët e KMNB-së u dakorduan se të gjithë nxënësit duhet të ndjekin mësimin së bashku, në hapësira të njëjta.

Megjithatë, disa pjesmarrës në këtë debat ngritën brengosjen për manipulime të mundshme politike të nxënësve. Disa prej tyre konsiderojnë se partitë politike kanë ndikim të dukshëm mbi të rinjtë në Tetovë, sidomos në kohë të krizës ekonomike, kur partitë politike zhvillohen në mbështetës duke përdorur retorikë nacionaliste. Pjesëmarrësit tjerë, theksuan faktin se pohimet e pjesëmarrësve nuk janë të pabazuara, dhe se ata kanë të drejtë për kushte adekuate për mbajtjen e mësimit sipas ligjit.

Palët e interesuara ranë dakord me qëndrimin se një nga gabimet kyçe që u lejua të ndodh pas konfliktit të vitit 2001 ishte segregacioni etnik në sistemin arsimor, që çoi deri në pasoja që shumë vështirë tejkalohen sot. Një numër i madh i qytetarëve të Tetovës nuk ndjehen të sigurt, ndërsa disa të anketuar shqiptarë mbajnë qëndrim se pakica maqedonase në Tetovë është në pozitë të vështirë, ngjashëm siç kanë qenë shqiptarët dy para dy dekadash. Shumë pasoja të konfliktit etnik janë akoma të freskëta dhe njerëzit nuk kanë besim tek komunitetet tjera.

Një mendim tjetër nga ana e palëve të tanguara është në lidhje me pohimin se romët janë viktimat permanente të diskriminimit, ndërsa në sferën e arsimit fëmijët romë janë në një pozitë posaçërisht të vështirë. Autoritetet komunale kanë mirëkuptim për grupet e cënueshme, dhe ata, në të kaluarën, siguruan mbështetje për tu plotësuar nevojat e tyre, nëpërmjet sigurimit të hapësirës për ngjarjet e tyre, për shembull. Megjithatë, mundësitë e komunës për të iniciuar aksione që do të ndikonin në zvogëlimin e distancës së rritur në mes të qytetarëve dhe këtyre grupeve, janë të limituara.

Shumë prej pjesëmarrësve shfaqën brengosje se procesi i integritetit ndëretnik nuk duhet të targetojë vetëm komunat multi-etnike që gjenden në pjesën perëndimore të vendi. Një pjesë e madhe e komunave në Maqedoninë lindore janë me karakter multi-etnik, dhe ato konsiderohen si “etnikisht të pastra” dhe “pa problem”, dhe me këtë më pak aktivitete zbatohen atje, në lidhje me bashkëjetesën multi-etnike.

Një tjetër mendim që u shpalos nga ana e palëve të tanguara është opinioni se integrimi i fëmijëve nga zonat dhe komunat rurale është gjithmonë një sfidë më e madhe. Komuna e Tearcës u veçua si një shembull pozitiv mes komunave rurale në implementimin e iniciativave për integrim ndëretnik. Ndërkaq, të gjitha përpjekjet për të siguruar afrimin e bashkësive etnike, doemos duhet të intensifikohen.



### 3.7 Komuna e Kumanovës



Komuna e Kumanovës gjendet në pjesën veriore të Republikës së Maqedonisë, me mbulim të territorit prej 1,212km<sup>2</sup>. Sipas regjistrimit të vitit 2002, komuna e Kumanovës ka 105.484 banorë, prej të cilëve 60.4% janë maqedonas, 25.9% janë shqiptarë, 8.6% janë serb, 4% romë, 0.3% turq dhe 0.8% të tjerë (Enti Shtetëror i statistikave, 2005).

Edhe krahas segregacionit etnik në rritje në vitet e fundit, komuna e Kumanovës ka traditë të respektimit të kulturave tjera. Megjithatë, distanca sociale dhe ndarjet në mesin e popullatës së re paraqet bazë për shqetësim, sidomos në aspektin e zhvillimit të mëturësishëm të marrëdhënieve ndëretnike në këtë komunë.

Këshilli i Komunës së Kumanovës përbëhet prej 33 anëtarëve. Në Kumanovë KMNB u formua në vitin 2013. Komisioni përbëhet prej dymbëdhjetë anëtarësh, dhe asnjëri nuk është anëtar i Këshillit Komunal. Komisioni i komunës së Kumanovës hartoi një Plan operativ vjetor.

Aktivitete kryesore të organeve të komunës për promovimin e mirëkuptimit dhe bashkëjetesës multikulturore kanë të bëjnë me mbështetjen dhe bashkëpunimin me sektorin e shoqërisë civile në implementimin e iniciativave me mbështetje të organizatave donatore. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, Këshilli i Komunës ka miratuar disa dokumente strategjike, të cilat parashohin aktivitete për zhvillim të multikulturalizmit në nivel komunal. Në vitin 2007, Këshilli i Komunës miratoi Strategjinë lokale për të rinjtë e komunës së Kumanovës (2008-2013), e cila parashihte aktivitete për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në shkolla. Përpjekjet vazhduan me miratimin e Strategjisë për të rinjtë (2014-2019), e miratuar në vitin 2013. Dokumentet strategjike janë me prioritet mbi nevojën për implementimin e projekteve që do të promovojnë mirëkuptimin multikulturore midis të rinjve në këtë komunë. Rezultatet e hulumtimit të zbatuar nga autoritetet komunale tregojnë se distanca në rritje sociale mes të rinjve me përkatësi të ndryshme etnike mbetet edhe më tutje si problem që nuk mund të zgjidhet përmes përpjekjeve periodike të organeve të komunës dhe sektorit civil (Komuna e Kumanovës, 2013).

Bashkëpunimi me qendrën rinore Multi-Kulti rezultoi me projekte të shumta që kontribuan në përmirësimin e komunikimit dhe promovimin e tolerancës dhe dialogut midis të rinjve të grupe të ndryshme etnike. Disa nga shembujt pozitiv janë organizimet e përbashkëta dhe shënimi i ngjarje të rëndësishme (festa). Këto aktivitete, në masë të madhe, ndikojnë në bashkëjetesën ndëretnike në komunën e Kumanovës (Pecijareski, 2013).

Mbështetja nga OSBE për projektin e multikulturalizmit në arsim u kontraktua me Memorandum bashkëpunimi mes Misionit të OSBE në Shkup dhe Komunës së Kumanovës në vitin 2010, ndërsa projekti u implementua nga Qendra për arsim jo-formal Trekëndëshi nga Shkupi. Si rezultat i bashkëpunimit me sektorin civil ishte miratimi i dokumentit strategjik për zhvillimin e arsimit në periudhën 2011-2016. Edhe krahas faktit se asnjë anëtarë i KMNB Kumanovë nuk ishte përfshirë në grupin punues të Strategjisë, megjithatë përmban dispozita që kanë të bëjnë me promovimin e konceptit për arsim të integruar në këtë komunë.

- ☞ Formimi i grupeve dygjuhësore në shkollat fillore;
- ☞ Futja e lëndëve zgjedhore për mësimin e gjuhëve të bashkësive tjera etnike;
- ☞ Aktivitete të përbashkëta mësimore dhe jashtëmësimore ndërmjet nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike;
- ☞ Formimi i tri qendrave rinore (Komuna e Kumanovës, 2010).

Plani aksional parasheh realizimin e aktiviteteve në 16 shkolla fillore dhe 4 shkolla të mesme që veprojnë në këtë komunë. Në Kumanovë, nga shtatori i vitit 2015 ka 9 grupe dygjuhësore në shkollat fillore dhe të mesme. Reformat, gjithashtu përfshijnë edhe futjen e gjuhës së bashkësive të ndryshme etnike si lëndë zgjedhore në disa shkolla fillore në gjithë komunën. Këto aktivitete janë plotësuar nga ana e programeve të përbashkëta mësimore dhe jashtëmësimore për nxënësit e bashkësive të ndryshme etnike të regjistruar në shkollat fillore dhe të mesme në këtë komunë. Kuadri mësimdhënës dhe administrativ i të gjitha shkollave fillore dhe të mesme në komunë, merr pjesë në trajnime që kanë të bëjnë me arsimin e integruar.

Kopshti i fëmijëve “Angell Shajçe” është një shembull pozitiv për arsimin e integruar në institucionet parashkollore. Ky kopsht i fëmijëve merr pjesë në projektin për arsim të integruar që nga mosha e hershme, që mbështete nga UNICEF dhe Ambasada Britanike.

### **Konstatimet e aktorëve relevantë**

Të gjithë të anketuarit u pajtuan se situata me marrëdhëniet ndëretnike është përmirësuar që nga konflikti në vitin 2001. Krahas kësaj, të gjithë të intervistuarit janë pajtuar se pasojat e ngjarjeve të 9 majit 2015 dërguan një mesazh se banorët e Kumanovës tashmë nuk mund të manipulohen nga elitat politike. Megjithatë, ka ekzistuar segregacion permanent, e cila me kalimin e viteve u bë e evidente në segregacion hapësinor të qytetarëve. Njerëzit zgjedhin të jetojnë në lagje etnikisht të “pastra”, gjë që më tutje zvogëlon kontaktet e tyre reciproke dhe mundësitë për bashkëpunim. Një sferë që paraqet përjashtim, është sfera e biznesit, ku ka komunikim dhe bashkëpunim praktik. Nga konstatimet e palëve të tanguara, ishte e qartë se ata janë të prirur për ta vlerësuar përkushtimin drejt multikulturalizmit të grupit të vet etnik, ndërsa përgjegjësinë për segregacionin e potencojnë te grupet tjera etnike.

Si edhe në rastin me komunat tjera që marrin pjesë në projekt, distanca sociale është sidomos e fuqishme midis të rinjve. Edhe krahas angazhimeve për përmirësimin e situatës me segregacionin në shkolla, shumica e shkollave në komunë punojnë në hapësira dhe turne etnikisht “të pastra”. Kjo e zvogëlon mundësinë e të rinjve për të njohur shokët e tyre nga komunitete etnike të ndryshme, ata mbeten të “kufizuar” në lagje dhe objekte të anëtarëve të grupit të vet etnik.

Të anketuarit dhe pjesëmarrësit në debat theksuan se situata me segregacionin etnik në sferën e arsimit është bërë alarmante. Segregacioni etnik është prezent në të gjitha shkollat e komunës. Madje edhe në shkollat që ku bëhen përpjekje për të siguruar kushte për turne me etni të përzier,



tanimë i kanë hequr këto parime.

Nje shembull pozitiv ishte përpjekja për integrimin e fëmijëve të moshës së hershme në kopshtin komunal të fëmijëve, që është pjesë e projektit Mozaik. Në shkollat fillore dhe të mesme, mundësia e vetme për të afruar nxënësit janë aktivitetet jashtëmësimore, të cilat janë shumë të kufizuara, ndërsa shqetësimi ishte në lidhje me mungesën e ndikimit pozitiv. Disa problem u ngritën në lidhje me mungesën e infrastrukturës adekuate në shkollat. Një nga shembujt e rrallë pozitiv të shkollave multietnike në këtë komunë është shkolla fillore “Toni Zordumis”, ku për dallim nga aktivitetet plotësuese, siç janë festimet dhe ekskurzionet, nxënësit nga grupe të ndryshme etnike ndjekin orë të përbashkëta në gjuhën angleze dhe arsimin teknik. Shkolla ka miratuar program për implementimin e aktiviteteve në sferën e arsimit të integruar, si pjesë e pjesëmarrjes në projektin për arsim të integruar, implementuar nga MASH.

Aktivitetet e përbashkëta jashtëmësimore organizohen herë pas here, por pjesëmarrja e nxënësve është vetëm formale, vetëm sa për të përbushur obligimet ligjore. Kjo u vërejt nga ana e pjesëmarrësve se përpjekjet për zbatimin e integritimit ndëretnik në sistemin shkollor është iniciuar pas konfliktit etnik të vitit 2001. Megjithatë, këto iniciativa zvogëlohen rreth vitit 2007, edhe krahas detyrimeve formale nga ana e autoriteteve lokale (përmes dokumenteve strategjike), situata me arsimin inkluziv në shkollat e komunës, vetëm tregon një trend të regresit viteve të fundit.

Segregacioni etnik është më i shprehur tek të rinjtë. Shumë nga të rinjtë madje as nuk shohin veten në mundësinë për përmirësimin e marrëdhënieve me moshatarët e vet të grupeve tjera etnike, sepse shumica e tyre përgatiten të kërkojnë perspektiva më të mira jashtë vendit. Shkalla e lartë e papunësisë, politizimi i shoqërisë, të gjitha këto ndikojnë në kultivimin e armiqësisë mes të rinjve në këtë komunë. Kontaktet janë të rralla dhe aktivitetet e përbashkëta jashtëmësimore implemen-tohen vetëm për t’iu përmbajtur obligimeve ligjore. Aktivitetet e përbashkëta janë reduktuar në ngjarjet sportive, ku të rinjve nuk iu sigurohen rrethana të përshtatshme për takim dhe komuni-kim me njëri tjetrin. Pjesëmarrësit në debat konkluduan se distanca sociale mes të rinjve, vështirë mund të tejkalohet vetëm përmes ngjarjeve sportive.

Sa i përket të drejtave të komuniteteve etnike më të vogla, shqetësimi është sa i përket situatës së romëve, të cilët shumë shpesh janë viktimat të diskriminimit, dhe nevojat e tyre zakonisht nuk përfillen. Nuk ekziston përfaqësimi i komunitetit rom në institucionet komunale, edhe krahas faktit se ka anëtarë të komunitetit rom që i plotësojnë të gjitha kërkesat për një pozicion në admin-istratën komunale.

KMNB Kumanovë ka qenë aktiv në disa projekte në të kaluarën, kryesisht me iniciativë të sektorit civil. Megjithatë, Komisioni nuk është aktiv për momentin, dhe nuk ka kontakt apo bashkëpunim me qytetarët apo sektorin lokal joqeveritar. Gjithashtu nuk ekziston harmonizim me obligim lig-jor për dorëzimin dhe rishikimin e rekomandimeve të parashtruara nga anëtarët e KMNB-së në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal.

KMNB Kumanovë miratoi një Plan dhe Program Operativ, por nuk i përmbush përpjekjet e këtilla. Çdo vit KMNB Kumanovë paraqet program vjetor operativ që miratohet nga Këshilli i Komunës. Kundrejt faktit që Këshilli Komunal rregullisht i miraton programet operative të dorëzuara nga KMNB, autoritetet komunale nuk ndanë mjete për realizimin e iniciativave të parapara. Shqetësim është se mjetet janë dedikuar vetëm për të përbushur nevojat e dy komuniteteve më të mëdha etnike -- maqedonase dhe shqiptarëve. Pavarësisht faktit se të gjitha komunitetet duhet të jenë të përfaqësuara në KMNB lokale, ky nuk është rasti me KMNB Komanovë. Komunitetet më të vogla etnike nuk kanë përfaqësuesit e tyre për të lobuar mbi çështjet në interes të tyre. Situata është përkeqësuar deri në atë shkallë që anëtarët aktual refuzojnë të marrin pjesë në mbledhjet e



Komisionit.

Pakënaqësia u shpreh në lidhje me punën e KMNB të Kumanovës. Kundrejt faktit që anëtarët e KMNB lokale nuk janë anëtarë të Këshillit të Komunës, procesi i zgjedhjes nuk është transparent, me ndikim të madh të partive politike. Kjo rezultoi në një situatë ku pjesa dërmuese e anëtarëve që zgjidhen në KMNB paraqesin interesat paritake, e jo interesin e grupit etnik të tyre.

Palët e interesuara pajtohen se partitë politike edhe sensacionalizmi medial kontribuojnë në acarimin e situatës. Disa nga pjesëmarrësit, gjithashtu, shtruan nevojën për përfshirje më të madhe të partive politike në iniciativa të këtij lloji. Veç kësaj, disa pjesëmarrës shtruan nevojën për pjesëmarrje më efektive të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal, përmes organizimit të debateve publike dhe tryezave të rrumbullakëta, që do të shërbejnë si platformë për bashkëpunim më të mirë mes autoriteteve komunale, shoqërisë civile dhe qytetarëve.

### 3.8 Komuna Mavrovë-Rostushë



Komuna Mavrovë-Rostushë gjendet në pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë. Është një komunë rurale me gjithsej 8.618 banorë, 50.5% prej të cilëve janë maqedonas, 17.2% janë shqiptarë, 31.1% janë turq dhe 1.2% tjerë (Enti Shtetëror i Statistikave, 2005).

Komuna Mavrov-Rostushë ka formuar Komsionin për Marëdhënie Ndërmjet Bashkësive. KMNB i Mavrovë-Rostushës përbëhet prej 7 anëtarësh. Sipas Statutit të Komunës, të gjitha bashkësitë etnike që jetojnë në komunë janë të përfaqësuar me nga një përfaqësues në Komision. Statuti i Komunës, gjithashtu, pengon që anëtarët e Këshillit të Komunës të zgjidhen njëkohësisht edhe si anëtarë të KMNB-së (Komuna Mavrovë-Rostushë, 2008). Studimet tjera lidhur me punën e KMNB-së tregojnë se në periudhën e kaluar janë diskutuar çështje lidhur me punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në administratën komunale, si dhe përfaqësim i drejtë i të gjitha bashkësive etnike në organet komunale (Qendra për Hulumtime Strategjike dhe Dokumentacione, 2008). Me qëllim të forcimit të kapaciteteve të Komisionit që merret me çështje që kanë të bëjnë me parandalimin e konflikteve, mediacionin, si dhe promovimin e mirëkuptimit multikulturor dhe bashkëjetesës, anëtarët e KMNB Mavrovë-Rostushë kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara kryesisht nga ana e organizatave lokale dhe rajonale.

Komuna bën përpjekje për organizimin e ngjarjeve me karakter multi-etnik, dhe ka një bashkëpunim të kënaqshëm me organizatat lokale joqeveritare. Ekzistojnë katër shkolla fillore dhe një e mesme në këtë komunë. Të gjitha shkollat në komunën e Mavrovë-Rostushës marrin pjesë në projektin për arsim të integruar, implementuar nga MASH dhe USAID.

#### Konstatimet e aktorëve relevantë

Pjesëmarrësit në debate theksuan shqetësimin sa i përket partizimit për çështje që ndikojnë në bashkëjetesën e përgjithshme ndëretnike në komunë. Ata theksojnë se marrëdhëniet ndëretnike në komunë janë stabile, pa probleme dhe tensione, por, gjithashtu, se distanca etnike ekziston. Në nivel të komunës, qytetarët marrin pjesë në kremtime të përbashkëta (të natyrës sekulare). Ajo që është e qartë nga intervistat me popullatën lokale është fakti se ekziston njëfarë komunikimi dhe bashkëpunimi pragmatik. Qytetarët bashkëpunojnë dhe komunikojnë në sferën publike, por mungesa e bashkëjetesës është e evidente nga segregacioni në sferën private: mungesa e kremtimeve të përbashkëta të ngjarjeve të rëndësishme (dasma, festa fetare, etj.), shoqërim i përbashkët, ndihmë njëri-tjetrit.

Përfaqësuesit e administratës komunale vunë në dukje se marrëdhëniet mes të punësuarve me prejardhje të ndryshme etnike janë të mira. Në komunë, ekzistojnë katër (4) shkolla fillore dhe një e mesme, ku nxënësit ndjekin mësimet në turne të përziera etnikisht.

Shumica e të anketuarve janë të mendimit se tensionet ndëretnike rriten gjatë zgjedhjeve. Partitë politike, të cilat janë të ndara sipas linjave etnike, përdorin retorikë nacionaliste për të tërhequr e mbështetës. Raportimi sensacional i mediave, gjithashtu, potencohet si faktor për përkeqësimin e marrëdhënieve ndëretnike në komunë.

Një faktor tjetër i cili konsiderohet se është i rëndësishëm për tu përmendur është imigrimi i madh ndër maqedonasit dhe shqiptarët në këtë komunë.

Ngjarjet dhe festat e përbashkëta janë të rralla, ndërsa pjesëmarrësit dhe të anketuarit, këtë ia përshkruajnë distancës hapësinore ndërmjet dy fshatrave. Megjithatë, ka klube sportive të përziera. Komuna deri më tani nuk ka miratuar asnjë dokument strategjik për integrimin ndëretnik dhe mirëkuptimin multikulturor. Në këtë kontekst, KMN B Mavrovë-Rostushë është aktiv vetëm deri në shkallën e angazhimit të sektorit joqeveritar në aktivitetet multikulturore në komunë. Në disa vitet e fundit, Komisioni ka bashkëpunuar në një projekt të implementuar nga ana e Lobit të Gruas Maqedonase. Deri më tani, asnjë anëtar i KMN B Mavrovë-Rostushë, e as administrata komunale, nuk kanë marrë pjesë në trajnime për mirëkuptimin multikulturor dhe integrimin ndëretnik. Vërejtjet kryesore në lidhje me marrëdhëniet multi-etnike në komunë janë të lidhura me popullatën myslimane, e cila në Mavrovë dhe Rostushë është etnikisht e ndryshme: shqiptarë, turq dhe maqedonas. Struktura etnike e popullatës ndryshon viteve të fundit, sepse anëtarët e komuniteteve më të vogla myslimane (maqedonas mysliman dhe shqiptarë) deklarojnë veten si pjesë e mazhorancës myslimane - turq.

Edhe krahas faktit se shkollat në komunë i përmbahen parimit për integrimin e nxënësve me prejardhje të ndryshme etnike në turne dhe objekte të njëjta, përfaqësues nga sfera arsimore theksojnë se situata është larg nga optimalja. Ata konsiderojnë se turnet e integruara kontribuojnë për tensione mes nxënësve. Kuadri mësimdhënës është multikulturor, ndërsa shkollat janë pjesë e projektit për arsim të integruar, implementuar nga ana e MASH-it.

Kuadri mësimdhënës dhe ai administrativ i shkollës kanë marrë pjesë në aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve në organizim të projektit. Aktivitete të përbashkëta jashtëmësimore organizohen, por, megjithatë, të intervistuarit bëjnë me dije se mund të ndodhin më shpesh. Aktivitetet jashtëmësimore në përgjithësi kanë të bëjnë me organizimin e ngjarjeve sportive. Pavarësisht faktit se shkollat kanë obligim për të vendosur bashkëpunim me shkollat nga komunat tjera, një bashkëpunim i tillë ani duhet të konstatohet, dhe ka të bëjë me mungesën e mjeteve financiare.

Implementimi i më shumë aktiviteteve të përbashkëta mësimore dhe jashtëmësimore u veçua si shumë i rëndësishëm, ngaqë tensionet etnike mes nxënësve janë evidente edhe rreth problemeve më të vogla. Për shembull, nxënësit janë të etshëm të mësojnë filozofinë islame, ndërsa ata kundërshtojnë mësimin e filozofisë krishtere. Shkollat miratuan Program për integrim ndëretnik, si pjesë e obligimeve në kuadër të projektit për arsim të integruar.

### 3.9 Komuna e Strugës



Komuna e Strugës gjendet në pjesën jugperëndimore të Republikës së Maqedonisë . Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2002, Komuna e Strugës kishte 36.892 banorë: 47.9% maqedonas, 41.5% shqiptarë, 5.4% turq, 1.7% vllleh dhe 3.2% të tjerë. Territori i komunës u zgjerua në vitin 2004, duke ia shtuar komunat e Dellogozhdës, Veleshtës, Labënishtit dhe Llukovës. Sipas përbërjes së re territoriale dhe demografike të komunës së Strugës, komuna ka 63.376 banorë, 32.1% prej të cilëve janë maqedonas, 56.8% janë shqiptarë, 5.7% janë turq , 1% janë vllleh dhe 4.3% të tjerë. Edhe krahas mungesës së situatave konfliktuoze në periudhën e shkuar, njohuritë e të anketuarve vënë në dukje se marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve të ndryshme janë stabile, por edhe se distanca në rritje sociale rezulton me ko-ekzistencë, në vend me bashkëjetesë. Mungesa e kontakteve sociale dhe bashkëpunimit ndërmjet të rinjve sidomos brengos, duke pasur parasysh ardhmërinë e jetesës multikulturore në komunë.

KMNB i Strugës përbëhet prej 6 anëtarësh, nga një përfaqësues prej secilit komunitet që jeton në komunë. KMNB i Komunës së Strugës është një nga të paktët që funksionon në bazë të Rregullores për punë dhe planeve operative. Në vitet paraprake, Komisioni i Strugës ka mbajtur takime të rregullta mujore , ku është diskutuar situata në komunë, pavarësisht nga ekzistimit i tensioneve etnike (Peçijareski, 2013). Si pjesë e aktiviteteve, KMNB i Strugës ka dorëzuar një iniciativë deri te Këshilli i Komunës dhe Kryetari për ngritjen e një radio stacioni shumëgjuhësor për emetim të programeve të specializuara për afrimin reciprok të bashkësive etnike , me përkrahjen e Komunës. Ky project, për fat të keq, nuk u realizua (Peçijareski, 2013).

Kryetari i KMNB Strugë ka realizuar mbi 50 takime me qytetarët për qetësimin e tensioneve etnike. Po ashtu, ka pasur takime speciale të KMNB Strugë me rekomandime konkrete të dorëzuara deri te Këshilli i Komunës dhe deri te Kryetari për tejkalimin e tensioneve etnike. Propozimi ka qenë në lidhje me organizimin e takimit të kryetarëve të Strugës dhe Vevçanit, për të diskutuar mbi çështjen e ruajtjes së paqes në mes të komuniteteve të ndryshme etnike. Ky propozim është pranuar dhe kryetarët kanë sjellë konkluzione dhe rekomandime të përbashkëta, të cilat kanë rezultuar me qetësim të tensioneve . (Peçijareski, 2013).

Megjithatë, puna e KMNB Strugë në njëfarë mënyre u përkeqësua disi në vitet e fundit . Njohuritë nga palët e interesuara relevante tregojnë se takimet janë të rralla, gati se inekzistente, ndërsa aktivitetet janë të limituara në minimum. Edhe krahas faktit se anëtarët e KMNB Strugë

dhe administrata komunale kanë marrë pjesë në trajnime për forcimin e kapaciteteve të tyre në sferën e marrëdhënieve ndëretnike, disa nga palët e tanguara shprehin skepticizëm lidhur me mungesën e dëshirës personale për zbatimin e këtyre shkathtësive në jetën e përditshme. Çështje tjera u ngritën në lidhje me pengesat politike në punën e KMNB Strugë, ku theksohet se anëtarët e komisionit shpesh përfaqësojnë interesat partiake, në vend të interesave të grupeve të tyre etnike. Bashkëpunimi i organeve komunale me sektorin e shoqërisë civile, veçanërisht me Fondacionin Shoqëri e Hapur në Republikën e Maqedonisë, rezultoi në miratimin e Strategjisë për të rinjtë 2015/2020 në vitin 2015. Krahas përkushtimit të komunës për të shtuar përkrahjen për implementimin e projekteve që promovojnë multikulturalizmin, Strategjia nuk përmban asnjëfarë dispozite tjetër për mbështetje të multikulturalizmit në mes të rinjve në komunë (Komuna e Strugës, 2015). Një tjetër rezultat i bashkëpunimit me Fondacionin Shoqëri e Hapur në Maqedoni është hartimi dhe miratimi i Strategjisë për zhvillimin e arsimit në komunën e Strugës 2015-2020. Strategjia vendos një aksent të rëndësishëm mbi zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit mësimdhënës dhe administrativ në shkollat e komunës, përfshirë edhe zhvillimin e kompetencave të tyre në sferën e multikulturalizmit dhe lehtësimin e mirëkuptimit multikulturor dhe bashkëjetesës (Komuna e Strugës, 2015). Si rezultat i projektit të implementuar nga UNICEF, u hap një Qendra rinore në komunën e Strugës.

Janë tetëmbëdhjetë shkolla fillore dhe dy shkolla të mesme që veprojnë në komunën e Strugës. Shkollat marrin pjesë në projektin e Qeverisë për arsim të integruar. Megjithatë, për shkak të një numri të madh të arsyeve, integrimi në këto shkolla është i kufizuar. Në shumë shkolla, një numër i madh i nxënësve mësojnë në turne të ndryshme dhe shumë shpesh këto turne organizohen sipas linjave etnike. Disa të anketuar, gjithashtu, kanë ngritën çështjen e problemeve me mësimin për nxënësit e komunitete më të vogla etnike të cilët ballafaqohen me mungesë të materialeve mësimore dhe objekteve, por autoritetet nuk u kushtojnë vëmendje këtyre problemeve. Ekzistojnë disa aktivitete jashtëmësimore të përbashkëta, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me pjesëmarrje në gara dhe kremtime të përbashkëta. Disa nga të anketuarit kanë bërë me dije se nuk ka aktivitete të përbashkëta mësimore. Në këtë kontekst, shqetësimi ishte në lidhje me të drejtat e bashkësive më të vogla etnike, si dhe se nxënësit e këtyre grupeve etnike janë viktimë të diskriminimit në sferën e arsimit, ngase ka mungesë të infrastrukturës themelore për arsimimin e tyre adekuat.

Shkolla fillore “Vëllezërit Milladinovci”, si dhe shkolla tjera në komunë, janë pjesë e projektit për arsim të integruar i implementuar nga MASH dhe USAID. Megjithatë, implementimi i aktiviteteve të projektit është i limituar në aktivitete jashtëmësimore siç janë ngjarjet sportive, manifestimet kulturore dhe ekskursionet e përbashkëta dhe kremtet. Shkolla siguron mësim në tri gjuhë – maqedonisht, shqip dhe turqisht, me nxënës që ndjekin mësimin në turne etnikisht të përziera. Shkolla merr pjesë në një projekt për mirëkuptim multikulturor i implementuar nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN).



#### 4. Konkluzione dhe rekomandime



Nga analiza e gjendjes me mirëkuptimin multi-etnik dhe bashkëjetesën në nëntë komunat e targetuara dalin konkluzionet në vijim:

1. Në përgjithësi, marrëdhëniet ndëretnike në komunat e targetuara perceptohen si stabile. Edhe krahas faktit që shumica e të intervistuarve janë të prirë që t'i paraqesin këto marrëdhënie si pozitive, debatet mundësuan shpalosje të tensioneve dhe pakënaqësive të reja, që u tregua si një pjesë e rëndësishme e vlerësimit të përgjithshëm të situatës në komunat e targetuara. Veç kësaj, ekziston një tendencë evidente midis palëve të tanguara (pavarësisht përkatësisë së tyre etnike) të theksohet kontributi i grupit të tyre etnik për ruajtjen e marrëdhënieve paqedashëse në komunë, ndërsa përgjegjësia për segregacionin bartet te grupet tjera etnike.
2. Pasqyra e gjendjes në nëntë komunat tregon se ata ballafaqohen me probleme të ngjashme, që janë të shprehura në shkallë të ndryshme. Një nga problemet kyçe në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike është distance më e madhe sociale dhe segregacioni edhe te të rriturit edhe te të rinjtë. Edhe krahas pretendimeve për bashkëpunim dhe komunikim, ishte evidente se komunikimi ekzistues bazohet në pragmatizëm, ndërsa kontaktet në sferën private zakonisht anashkalohen. Në disa komuna, distance në rritje sociale ka ndikim në segregacionin ekzistues të popullsisë, respektivisht të jetuarit në lagje "të pastra". Kjo situatë, ndërkaq, mundet më tutje ta pengojë mundësinë për zhvillim të mirëkuptimit multikulturor dhe bashkëjetesën ndërmjet qytetarëve.
3. Një konstatim i papritur nga palët e tanguara relevante është pretendimi se ata i përjetojnë dallimet fetare, si bazë për kufizimin e komunikimit të tyre me qytetarët e religjioneve tjera në sferën private. Ky pretendim vazhdimisht haset në gati se të gjitha komunat e synuara. Përpjekje të veçanta duhet bërë për tu siguruar se qytetarët (edhe të moshuarit edhe të rinjtë) janë të njoftuar me postulatet themelore të religjioneve të ndryshme që praktikohen në komunë, si dhe aspektet e tolerancës dhe bashkëjetesës që janë pjesë e mësimave fetare.
4. Komunat Brvenicë, Vrapçisht, Gostivar, Jegunovcë, Kërçovë dhe Tetovës janë në proces të implementimit të strategjive të miratuara për përmirësimin e bashkëjetesës multi-etnike. Zbatimi i këtyre strategjive, megjithatë është me dinamikë dhe efikasitet të llojllojshëm. Një pjesë e konsiderueshme e komunave në të cilat janë miratuar dokumentet

strategjike për mirëkuptim multikulturor, e limitojnë angazhimin e tyre kryekëput në aktivitete në sferën e arsimit (ku ekziston sinergji me iniciativa të tjera). Një nga arsyet kryesore për këtë janë mjetet e kufizuara të disponueshme financiare të autoriteteve komunale. Kjo sidomos ka të bëjë me organizimin e aktiviteteve, siç janë kremtimet e përbashkëta, manifestimet kulturore, festivalet, si dhe sigurimi i mbështetjes së organizatave lokale të shoqërisë civile për zbatimin e iniciativave për promovim të multikulturalizmit në komunat. Duhet të bëhen përpjekje të mëtutjeshme, për tu siguruar se autoritetet lokale u përmbahen përcaktimeve strategjike.

5. Një aspekt veçanërisht është i mbushur me pengesa në procesin e implementimit – tejkalimi i barrierave gjuhësore mes qytetarëve me prejardhje etnike të ndryshme. Edhe pse dokumentet strategjike parashohin mbajtjen e kurseve gjuhësore (për të rritur) dhe lëndë zgjedhore në shkollë (për fëmijë) për mësimin e gjuhëve të komuniteteve tjera etnike, këto aktivitete implementohen vetëm në një pjesë të vogël të komunave të targetuara. Kjo çështje është me interes tejet të rëndësishëm, duke marrë parasysh se te një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve janë cekur barrierat gjuhësore si një nga faktorët më të rëndësishëm për mbajtjen e distancës sociale ndërmjet grupeve të ndryshme etnike. Duhet të bëhen përpjekje të veçanta (përmes bashkëpunimit me organet e autoriteteve lokale, sektorin e arsimit, qytetarët, sektorin e shoqërisë civile) të krijohen kushte për implementimin e këtij obligimi.
6. Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive veprojnë në përgjithësi në kuadër të mandatit të paraparë juridik. Megjithatë, analizat e aktiviteteve të tyre, si dhe konstatimet nga palët e interesuara relevante tregojnë se këto organe nuk shfrytëzojnë kapacitete e tyre të plota për intervenim në sferën e marrëdhënieve ndëretnike. Ishte evidente se palët e tanguara dinë shumë pak, ose nuk kanë aspak njohuri për ekzistimin dhe punën e këtyre organizmave. Ka nevojë për një përfshirje më të madhe në iniciimin dhe implementimin e aktiviteteve për zhvillim të multikulturalizmit, si dhe takime më të shpeshta të drejtpërdrejta me qytetarët. Në këtë kontekst, duhet të ceket se KMNB-të në përgjithësi ballafaqohen me vështirësi të konsiderueshme gjatë punës: mungesë e buxheteve operative dhe mbështetjes administrative për mbajtjen e aktiviteteve të rregullta të tyre.
7. Në sferën e arsimit, përcaktimet strategjike janë në fazë të implementimit. Kjo ka të bëjë me faktin se pjesa dërmuese e përcaktimeve strategjike në fushën e arsimit janë harmonizuar me aktivitete dhe projekte paralele. Aktivitetet e parapara realizohen pa probleme të mëdha në shkollat e komunave të targetuara. Ndërkaq, problemi i distancës sociale u cek me shqetësim nga ana e të anketuarve. Në shumë shkolla në komunat e targetuara nxënësit ndjekin mësimin në mjedise dhe turne të ndryshme, kështu që, lidhjet e tyre reciproke janë praktikisht inekzistente. Gjithashtu, të anketuarit informojnë se aktivitete të përbashkëta mes nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike janë raritet, dhe ne shumicën e rasteve pjesëmarrja e nxënësve është vetëm formale.
8. Përfaqësuesit nga sektori i biznesit theksojnë se qytetarët e grupeve të ndryshme etnike shpesh bashkëpunojnë, dhe se kjo është një sferë ku dallimet kulturore kanë më së paku rëndësi. Shumë të anketuar e kanë theksuar gatishmërinë e tyre për të përkrahur aktivitete për zhvillimin e bashkëjetesës multikulturore. Duhet të bëhen përpjekje të mëtutjeshme dhe të shfrytëzohen për kontributin e biznes-sektorit për përmirësim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve ndëretnike në komunat e targetuara.
9. Në përgjithësi, marrëdhëniet ndëretnike në komunat e targetuara janë vlerësuar si stabile, pa konflikte të mëdha. I tillë ishte rasti në komunën e Kumanovës, Mavrovë-Rostushës dhe të Strugës. Të gjithë të anketuarit bëjnë me dije për ekzistimin e traditës së respektimit dhe bashkëpunimit mes bashkësive etnike, të cilat duhet të zhvillohen



më tutje. Prapëseprapë, shqetësim u shpreh mbi distancën sociale në rritje dhe ndarjes mes të rinjve, edhe krahas përpjekjeve për afrimin e tyre. Ndonëse në komunat e Kumanovës, Mavrovë-Rostushës dhe Strugës nuk ka pasur përpjekje sistematike për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike, Kumanova dhe Struga kanë bashkëpunuar me sektorin e shoqërisë civile për iniciativa të tilla. Rezultatet nga ky bashkëpunim janë disa dokumente strategjike në sfera tjera, të cilat prapëseprapë përmbajnë përcaktime për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike.

10. Analiza e bashkëjetesës ndëretnike dhe promovimi i saj në nëntë komunat e targetuara tregon se komunat rurale janë në pozitë më pak të favorshme për realizimin e qëllimeve strategjike. Segregacioni bashkësive lokale fizikisht të largëta dhe të segreguara etnikisht, vështirëson mundësinë për shoqërim të qytetarëve të grupeve të ndryshme etnike. Organizimi i ngjarjeve të përbashkëta është më i vështirë, sidomos duke marrë parasysh mjetet e pamjaftueshme financiare për realizimin e tyre. Në raste të caktuara, intervistat treguan mungesë të vjetëdijes për karakterin multikulturor të komunës, kur disa nga të anketuarit kanë vënë në dukje se fshati i tyre është etnikisht i “pastër”, nuk ekziston nevoja për aktivitete dhe promovim të multikulturalizmit. Mbështetje shtesë (financiare, logjistike) duhet të sigurohet për këto komuna, me qëllim që të përmbushin përcaktimet e tyre strategjike.
11. Nga intervistat dhe debatet publike, ishte e qartë se në shumë raste zhvillimi i multikulturalizmit konsiderohet si çështje që i tangon marrëdhënet ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve më të mëdha etnike - shqiptarët dhe maqedonasit. Debatet publike treguan se pjesëtarët e komuniteteve etnike më të vogla shpesh anashkalohen në procesin e vendimmrjes dhe se vazhdimisht i nënshtrohen praktikave të diskriminimit. Duhet të bëhen më shumë përpjekje për të siguruar përfshirjen e grupeve etnike më të vogla në të gjitha aspektet e hartimit dhe implementimit të iniciativave në nivel lokal.



## Bibliografia



BONA MENTE: Mbështetje Komisioneve për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive. (2011). Policy Brief Komisionet për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive Shoqata Instituti për Zhvillim të Komunitetit.

Georgieva, L., Velkovski, Z. dhe Damovska, L. (2014). Roli i arsimit sipëror në nxitjen e dialogot ndërkulturor dhe mirëkuptimit në shoqërinë multietnike – rasti i Republikës së Maqedonisë. Gazeta ndërkombëtare për arsim dhe shkencë, 125-136.

Qendra Maqedonase për arsim civil. (2011). Fuqizimi i bashkëpunimit multietnik në komunat: Raport për studimin e nivelit fillestar. Shkup.

Enti Shtetëror i Statistikave. (2005). Regjistrimi i Popullsisë, amvisërive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë 2002. Shkup: Enti Shtetëror i Statistikave.

Bakiu, B., Dimitrovska, M. dhe Brava, A. (2016). Si deri te arsimi vërtetë i integruar në Republikën e Maqedonisë? Shkup: EPI.

(2002). Ligji për vetëqeverisje lokale. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 5 dt. 29.01.2002.

Kërteska-Papiq, B., Bilall, S., Emin, O., Suzana, M.-S., Ačkovska-Leshkovska, E. dhe Stojkoski, S. (2015). Koncepti për arsim të integruar.

Bashkëpunimi ndëretnik I Shkollave të mesme të Vrapçishtit dhe Kočanës. (16 Mars, 2016). E kontrolluar më 23 shtator 2016, nga A1on: <http://a1on.mk/wordpress/archives/591689>

Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2014). Plani strategjik Ministria e Arsimit dhe Shkencës 2015-2017. Shkup: Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë. (2010). Hapat drejt arsimit të integruar në sistemin arsimor të Republikës së Maqedonisë. Shkup: Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë.

Naskova, Z., Mehmeti, M. dhe Imeri, Sh. (2013). Politikat dhe praktikat ndërkulturore në komunat Gostivar, Tetovë, Kërçovë, Bërvenicë, Vrapçisht dhe Jegunovc. ADI.

Komuna e Bërvenicës. (2014). Strategjia për zhvillim të dialogut multikulturor në komunën e Bërvenicës.

Komuna e Vrapçishtit. (2014). Plani strategjik për përmirësimin e mirëkuptimit ndërkulturor në Komunën e Vrapçishtit.

Komuna e Gostivarit. (2014). Strategjia për zhvillim të dialogut multikulturor në komunën e Gostivarit.

Komuna e Jegunovcës. (2014). Strategjia për zhvillim të dialogut multikulturor në komunën e Jegunovcës.

Komuna e Kërçovës. (2014). Strategjia për zhvillim të dialogut multikulturor në komunën e Kërçovës.

Komuna e Kumanovës. (2010). Strategjia për zhvillim të arsimit në komunën e Kumanovës (2011-



2016).

Komuna e Kumanovës. (2013). Strategjia për të rinjtë 2014-2019.

Komuna e Mavrovë-Rostushës. (2008). Statuti i Komunës Mavrovë-Rostushë.

Komuna e Strugës. (2015). Strategjia për të rinjtë 2015-2020.

Komuna e Strugës. (2015). Strategjia për zhvillim të arsimit në komunën e Strugës 2015-2020.

Komuna e Tetovës. (2014). Plan i strategjik për përmirësimin e mirëkuptimit ndërkulturor në Komunën e Tetovës.

Peçijareski, M. (2013). Integrimi social dhe menaxhimi i dallimeve etnike në Republikën e Maqedonisë: politikat dhe praktikat publike në nivel lokal. Shkup: Instituti për Demokraci Sociale "Progres".

Realizimi i programit për bashkëpunim me prindërit. (2015). Kontrolluar më 10 tetor 2016, nga Modeli Nansen për Arsim të Integruar: <http://nmie.org/index.php/mk/pocetna/20-news-mk/1295-implementation-of-the-program-for-cooperation-with-parents>

Sekretariati për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. (2015). Pasqyrë e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit për kohezion social.

Qendra për Hulumtime Strategjike dhe Dokumentacion. (2008). Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive në komunat në Maqedoni Raport nga hulumtimi.



### *Aneksi 1. Lista e të anketuarve të intervistuar*

| Komuna e Bërvenicës  |                                                                                                            |                    |
|----------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| Emri i të anketuarit | Institucioni /Sektori                                                                                      | Data e intervistës |
| Izair Iljazi         | Viena Park (sektori i biznesit)                                                                            | 07.09.2016         |
| Jusuf Shaini         | Udhëheqës i Departamentit për mjedis jetësor, planifikim dhe zhvillim ekonomik lokal (administrata lokale) | 07.09.2016         |
| Hakim Ramadani       | Udhëheqës i Departamentit për prokurime publike (administrata lokale)                                      | 07.09.2016         |
| Ajdin Abdullahi      | Drejtor i shkollës fillore „7 Marsi“ (arsim)                                                               | 07.09.2016         |



| Komuna e Vrapçishtit    |                                                                               |                    |
|-------------------------|-------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| Emri i të anketuarit    | Institucioni /Sektori                                                         | Data e intervistës |
| Abdilbari Ebibi         | Udhëheqës i Departamentit për uhvillim ekonomik lokal (administrata komunale) | 03.09.2016         |
| Neset Dauti             | Udhëheqës i Departamentit për arsim (administrata komunale)                   | 03.09.2016         |
| Ljubica Petroski        | Psikologe në shkollën fillore „Vrapçisht “ (arsim)                            | 03.09.2016         |
| Nurdan Fejzullai Beqiri | Mësimdhënëse në shkollën fillore „Vrapçisht“ (arsim)                          | 03.09.2016         |



| Komuna e Gostivarit   |                                                                                  |                    |
|-----------------------|----------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| Emri i të anketuarit  | Institucioni/Sektori                                                             | Data e intervistës |
| Njomza Selimi         | Udhëheqës i Departamentit Juridik (administrata komunale)                        | 23.09.2016         |
| Nafije Zendeli Ziberi | Udhëheqës i Departamentit për arsim, sport dhe kulturë ( administrata komunale ) | 23.09.2016         |
| Bejtulla Zaimi        | Drejtor i shkollës fillore „Ismail Qemali“                                       | 23.09.2016         |
| Sasho Shareski        | Drejtor i shkollës fillore „Goce Delçev“                                         | 23.09.2016         |
| Muhamed Toçi          | OJQ Meseçina (sektori i shoqërisë civile)                                        | 23.09.2016         |
| Muzafer Tairi         | Progres Pazari (sektori i biznesit)                                              | 23.09.2016         |



| Komuna e Jegunovcës  |                                                                                 |                    |
|----------------------|---------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| Emri i të anketuarit | Institucioni/Sektori                                                            | Data e Intervistës |
| Petre Jankovski      | Themelues i „Profinish“ (sektori biznesit)                                      | 14.09.2016         |
| Darko Spasovski      | Sekretar i Komunës së Jegunovcës (administrata komunale)                        | 14.09.2016         |
| Voislav Antovski     | Referent i ri për zhvillim ekonomik lokal dhe urbanizëm (administrata komunale) | 14.09.2016         |
| Branko Markoviq      | Psikologe në shkollën fillore „Simçe Nastovski“ (arsim)                         | 14.09.2016         |
| Selviqe Selmani      | Mësimdhënëse në shkollën fillore „Simçe Nastovski“ (arsim)                      | 14.09.2016         |

| Komuna e Kërçovës    |                                                             |                    |
|----------------------|-------------------------------------------------------------|--------------------|
| Emri i të anketuarit | Institucioni/Sektori                                        | Data e intervistës |
| Nikolla Allampioski  | Inxhinier „Lindi ltd.“ (sektori i biznesit)                 | 22.09.2016         |
| Dejan Ilioski        | Nëpunës për zhvillim ekonomik lokal (administrata komunale) | 22.09.2016         |
| Ibrahim Koça         | Anëtar i KMNB - Kërçovë                                     | 22.09.2016         |
| Muamed Alioski       | OJQ Meseçina (sektori i shoqërisë civile)                   | 22.09.2016         |
| Rahim Pinjoli        | Drejtor i shkollës fillore „Sande Shterjoski“ (arsim)       | 22.09.2016         |
| Aneta Bozhinovska    | Pedagoge në shkollën fillore „Sande Shterjoski“ (arsim)     | 22.09.2016         |



| Komuna e Tetovës      |                                                                         |                    |
|-----------------------|-------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| Emri i të anketuarit  | Institucioni/Sektori                                                    | Data e intervistës |
| Arton Nuredini        | Agjencia turistike „Arsimi Kompani“ (sektori i biznesit)                | 14.09.2016         |
| Enver Beqiri          | Udhëheqës i Departamentit për kulturë dhe sport (administrata komunale) | 07.09.2016         |
| Sllavica Serafimovska | Udhëheqës i Departamentit juridik (administrata komunale)               | 07.09.2016         |
| Adem Idriizi          | OJQ Hendimak (sektori i shoqërisë civile)                               | 07.09.2016         |
| Harun Rexhepi         | Drejtor i shkollës fillore „Migjeni“ (arsim)                            | 07.09.2016         |
| Shpresa Iseini        | Drejtor i shkolles fillore „Liria“ (arsim)                              | 14.09.2016         |



| Komuna e Kumanovës   |                                                                           |                    |
|----------------------|---------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| Emri i të anketuarit | Institucioni/Sektori                                                      | Data e intervistës |
| Pandora Misevska     | Menaxhere në „Studio MTK“ (sektori i biznesit)                            | 20.09.2016         |
| Coki Ristoski        | Udhëheqës i Departamentit për kulturë dhe sport (administrata komunale)   | 20.09.2016         |
| Afrije Sulejmani     | Nëpunëse (administrata komunale)                                          | 20.09.2016         |
| Arben Xhemaili       | Asociacioni për kulturë „Vizioni-M“ (sektori i shoqërisë civile)          | 20.09.2016         |
| Marjan Mlladenovski  | Profesor në Fakultetin për biznes dhe administratë „Euro College“ (arsim) | 20.09.2016         |
| Vesna Dimitrievska   | Psikologe në shkollën fillor „Toni Zordumis“ (arsim)                      | 20.09.2016         |



| Komuna Mavrovë-Rostushë |                                                                       |                    |
|-------------------------|-----------------------------------------------------------------------|--------------------|
| Emri i të anketuarit    | Institucioni/Sektori                                                  | Data e intervistës |
| Ajbean Ajdini           | Udhëheqës i Departamentit Juridik (administrata komunale)             | 04.10.2016         |
| Didi Xhaferi            | Drejtor i drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim (administrata komunale) | 04.10.2016         |
| Elvira Ejupi            | Zhvillim ekonomik lokal (administrata komunale)                       | 04.10.2016         |
| Radmilla Zdravkovikj    | Pedagoge në shkollën e mesme „Mavrovë-Rostushë“ (arsim)               | 04.10.2016         |
| Jasmina Nankovska       | Psikologe në shkollën e mesme „Mavrovë-Rostushë“ (arsim)              | 04.10.2016         |
| Femija Sulejmani        | Sociologe në shkollën fillore „Gjorgji Pulevski“ (arsim)              | 04.10.2016         |
| Xhuljeta Saliu          | Psikologe në shkollën fillore „Gjorgji Pulevski“ (arsim)              | 04.10.2016         |



| Komuna e Strugës     |                                                                               |                    |
|----------------------|-------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| Emri i të anketuarit | Institucioni/Sektori                                                          | Data e intervistës |
| Orhan Cane           | Departamenti për zhvillim ekonomik lokal (administrata komunale)              | 16.09.2016         |
| Vladislav Zhupan     | Udhëheqës i Departamentit për zhvillim ekonomik lokal (administrata komunale) | 16.09.2016         |
| Stefan Maleski       | Edukator në OJQ „Poraka Nova“ (sektori i shoqërisë civile)                    | 16.09.2016         |
| Vello Filloski       | Ndihmës drejtor në shkollën fillore „Braça Milladinovci“ (arsim)              | 16.09.2016         |
| Loreta Matovska      | Pedagoge në shkollën fillore „Braça Milladinovci“ (arsim)                     | 16.09.2016         |

*Aneksi 2. Debatet e organizuara*

| Komuna           | Data       |
|------------------|------------|
| Bërvenicë        | 28.09.2016 |
| Jegunovcë        | 29.09.2016 |
| Tetovë           | 29.09.2016 |
| Kumanovë         | 30.09.2016 |
| Mavrovë-Rostushë | 04.10.2016 |
| Gostivar         | 06.10.2016 |
| Kërçovë          | 12.10.2016 |
| Vrapçisht        | 13.10.2016 |
| Strugë           | 14.10.2016 |

